



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Auditim Përputhshmërie

Tiranë, Korrik 2023

Nr.	<u>PËRMBAJTJE</u>	<u>Faqe</u>
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3 – 16
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-14
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	14-16
II	HYRJA	16-20
1	Objekti i auditimit	16
2	Qëllimi i auditimit	16-17
3	Identifikimi çështjes	17
4	Përgjegjësitë e strukturave përgjegjëse.	17
5	Përgjegjësitë e audituesve	18
6	Kriteret e vlerësimit	18
7	Standardet e auditimit	18-19
8	Metodat e auditimit	19
9	Dokumentimi i auditimit	19-20
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	20 – 89
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	20
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	20-89
2.1	Mbi programimin e të ardhurave tatimore dhe kontributive, realizimin e tyre, ndarë sipas strukturës përkatëse për periudhën objekt auditimi	20-25
2.2	Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor. -Sektori i Kontrollit në vënd -Sektori i Kontrollit nga zyra dhe Monitorimit	25-73
2.3	Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, të veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve	73-77
2.4	Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në ekzekutimin e buxhetit vjetor, për periudhën nën auditim	78-89
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	89-103
V	ANEKSE	104-118

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Informacioni i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr.15/1 prot., datë 09.01.2023 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në përfundim të auditimit, K.L.SH hartoi Projekt Raportin e Auditimit, bazuar në Letrat e punës, Akt Konstatimet, vërejtjet e bëra nga subjekti “Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës”, etj., sipas drejtimeve të auditimit të përcaktuara në Programin e Auditimit. Mbi këtë bazë është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit.

I.2 Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportit Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi me përzgjedhje i 40 raporteve të kontrollit tatimor, në 11 subjekte nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur procedurat e kontrollit, mbi analizimin e situatës financiare dhe deklaramente të subjektit, sipas përcaktimeve në <i>Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr.192 datë 12.08.2020</i> më konkretisht:</p> <p>1. Për subjektin “E.G” për vitin 2019 rezulton se, sasia në dalje nga magazina e lëndës polietilen prej 243,522 kg nuk rakordon me sasinë e shitur të polietilenit prej 238,523 kg, me një diferencë prej 4,999 kg polietilen të pa deklaruar në shitje me një çmim mesatar shitjeje prej 198.13 lekë/kg. Nga ana e inspektorit të kontrollit, nuk është analizuar dhe trajtuar kjo diferencë, por ka dalë në përfundimin se nga lëvizja materiale e lëndës së parë polietilen nuk ka diferenca materiale.</p> <p>Diferencat e mësipërme në shumën prej 990,452 lekë (4,999 kg * 198.13 lekë/kg), të trajtuara nga grupi i auditimit sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, neni 124, rezultojnë:</p> <p><i>Detyrimi për TVSH-në</i> $990,452 * 20\% = 198,092 \text{ lekë}$ <i>Gjobë</i> $100\% 198,092 = 198,092 \text{ lekë}$ <i>Detyrimi për Tatim Fitimin</i> $990,452 * 15\% = 148,568 \text{ lekë}$ <i>Gjobë</i> $100\% 148,568 = 148,568 \text{ lekë}$.</p> <p><i>Për këtë rast, efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit vlerësohet se është në shumën 693,320 lekë.</i></p> <p>Nga analiza e kryer nga ana e inspektorit të kontrollit, shitjet e realizuara sipas klientëve dhe llojit të produktit për vitin 2017 rezulton se sasia në dalje nga magazina e lëndës polietilen prej 96,528 kg nuk rakordon me sasinë e shitur të polietilenit prej 99,732 kg, me një diferencë prej 3,204 kg polietilen të deklaruar në shitje, por të pa deklaruar si dalje nga magazina me një çmim mesatar shitjeje prej 188.22 lekë/kg. Nga ana e inspektorit të kontrollit, nuk është analizuar dhe trajtuar kjo diferencë, por është dalë në përfundimin se nga lëvizja materiale e lëndës së parë polietilen nuk ka diferenca materiale.</p> <p>Diferencat e mësipërme në shumën prej 603,062 lekë (3,204 kg * 188.22 lekë/kg), të trajtuara nga grupi i auditimit sipas</p>	25-73	E lartë	Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, referuar dosjeve përkatëse të kontrollit, për të cilat janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën gjithsej prej 38,352,079 lekë, nga të cilët detyrime tatimore 31,279,046 lekë dhe 7,073,033 lekë gjobë tatimore për plotësim të pasaktë të deklaratës tatimore.

<p>përcaktimeve të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, neni 124 rezultojnë: Detyrimi për TVSH-në $603,602 * 20\% = 120,612$ lekë Gjobë 100% $120,612 = 120,612$ lekë. Detyrimi për Tatim Fitimin $603,602 * 15\% = 90,540$ lekë Gjobë 100% $90,540 = 90,540$ lekë. Për këtë rast efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 422,304 lekë. Nga verifikimi i llogarisë shpenzime amortizimi për periudhën 2017 rezulton se subjekti ka amortizuar aktivet materiale nën normën e lejuar për efekte fiskale në kundërshtim ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ” Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 22, pika 3, pika 5. Për vitin 2017, rezulton se subjekti nuk ka pasqyruar shpenzimet për amortizimin e aktiveve materiale në shumën 1,520,272 lekë, e cila duke u indeksuar me normën e fitimit 1.2% të shoqërisë për periudhën 2017 shkon në vlerën 1,538,515 lekë. Në zbatim të ligjit 9920 datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, germa “b”, neni 72, germa “a” dhe neni 115, pika 1, janë llogaritur detyrimet përkatëse, të cilat rezultojnë: Tatim Fitimi 1,538,515 x 15 % = 230,777 lekë Gjobe TF..... 230,777 lekë x 0.06% x 365 dite = 50,540 lekë TVSH 1,538,515 x 20 % = 307,703 lekë Gjobe TVSH 307,703 lekë x 0.06% x 365 dite = 67,387 lekë Shuma..... = 656,407 lekë Pra, paraprakisht vlerësohen të ardhura të munguara gjithsej 1,772,031 lekë, nga të cilat detyrime tatimore 1,096,292 lekë dhe 675,739 lekë gjobë tatimore. 2. Nga verifikimi i dosjes së kontrollit të subjektit “B...” SHPK rezulton se grupi i auditimit pasi analizoi dokumentacionin e paraqitur sqaron se leja e ndërtimit e paraqitur e lëshuar nga Bashkia Durrës me nr. 575 datë 23.07.2019 është në emër të një individi dhe jo në emër të shoqërisë “B...” e cila ka kërkuar rimbursimin. Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 20 “Rregulla të përgjithshme”, pikës 4. Referuar bazës ligjore të sipërcituar nga ana e grupit të auditimit gjatë shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se në lejen e ndërtimit të miratuar nga ana e Bashkisë Durrës, është përcaktuar se leja e ndërtimit i referohet zhvilluesit të objektit si person i cili ka aplikuar me kartë identiteti, fakt i cili tregon në mënyrë të qartë se kemi të bëjmë me një individ i cili ka përfituar lejen e ndërtimit dhe jo me një subjekt të tatueshëm. Sqarojmë se individi dhe subjekti i tatueshëm “B...” janë dy entitete juridikisht të ndryshme, dhe për rrjedhojë me të drejta dhe detyrime tatimore të ndryshme nga njëra tjetra. Në këtë kuptim individi nuk mund të jetë në asnjë moment person i tatueshëm për efekt të TVSH-së dhe ti</p>			
---	--	--	--

<p>lind e drejta e rimbursimit të saj. Nga ana e inspektorit nuk është vepruar në përputhje me legjislacionin tatimor duke mos analizuar në asnjë rast në raportin e kontrollit dhe duke mos cituar lejen e ndërtimit. Gjithashtu nuk është verifikuar që në fazën e parë të kontrollit të dhënat e lejes së ndërtimit dhe ekzistenca e kushtit nëse kemi të bëjmë me një person të tatueshëm ose jo.</p> <p>Gjithashtu nuk ka një analizë të detajuar të situacioneve pjesore dhe përfundimtare për punimet e ndërtimit, si dhe nuk është verifikuar leja e ndërtimit, preventivi i punimeve për të faktuar kreditimin e TVSH -së së lindur nga blerjet e materialeve me qëllim realizimin e rikonstruksionit të godinës.</p> <p>Si përfundim, për rimbursimin në vlerën 10,748,989 lekë të konfirmuar nga inspektori në raportin e kontrollit, bazuar në informacionet e paraqitura në dosjen e kontrollit, subjektit i lindin detyrime në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 115, pika 3, nga grupi i auditimit janë llogaritur detyrimet përkatëse;</p> <p>Shuma e kërkuar për rimbursim: 10,748,989 lekë Penalitet 20%: 2,149,797 lekë Total Detyrimi: 12,898,786 lekë</p> <p>Pra, vlerësohen paraprakisht 10,748,989 lekë detyrime tatimore dhe 2,149,797 lekë gjobë tatimore.</p> <p>3. Nga auditimi i raportit të kontrollit të subjektit “K. M” SHPK, kosto e blerjes së mallrave është 5,469,650 lekë, ndërkohë vlera e shitjes është 3,664,000 lekë. Në zbatim të ligjit 9920 datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, germa “b”, neni 72, germa “a” dhe neni 115, pika 1, janë llogaritur detyrimet përkatëse, të cilat rezultojnë si më poshtë:</p> <p>Kosto 5,469,650 lekë * 10% (vlerë të shtuar) = 6,016,615 lekë Diferenca 6,016,615 lekë - 3,664,000 lekë = 2,352,615 lekë Detyrimi për TVSH-në 2,352,615 * 20% = 470,523 lekë Gjobë 470,523 x 0.06% x 365 ditë = 103,044 lekë. Detyrimi për Tatim Fitimin 2,352,615 * 15% = 352,892 lekë Gjobë 148,568 * 0.06% x 365 ditë = 77,283 lekë.</p> <p>Pra, vlerësohen paraprakisht të ardhura të munguara gjithsej 1,003,742 lekë, nga të cilat 823,415 lekë detyrime tatimore dhe 180,327 lekë gjobë tatimore.</p> <p>4. Nga auditimi rezulton se për subjektin “D...” SHPK Subjekti ka deklaruar shpenzime të cilat duhet të klasifikohen si shpenzime të pazbritshme pasi nuk i shërbejnë aktivitetit dhe rezultojnë shpenzime të panjohura për blerjen e autoveturës bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar”, neni 21</p> <p>Detyrimi për Tatim Fitimin 2,750,559 * 15% = 412,583 lekë Gjobë 412,583 * 0.06% x 365 ditë = 90,355 lekë.</p> <p>Konstatohet se në zërin n). shpenzimet për paga shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, nuk janë kaluar nëpërmjet sistemit bankar.</p> <p>Shpenzime për paga shpërblime për vitin 2020 janë në shumën 2,087,208 lekë.</p> <p>Shpenzime për paga shpërblime për vitin 2021 janë në shumën</p>			
--	--	--	--

<p>3,247,509 lekë.</p> <p>Total shpenzime për pagat janë në shumën 5,334,717 lekë. Detyrimi për Tatim Fitimin $5,334,717 * 15\% = 800,207$ lekë Gjobë $412,583 * 0.06\% * 365$ ditë = 172,844 lekë.</p> <p>Pra, vlerësohen paraprakisht 1,475 mijë lekë detyrime tatimore, nga të cilat 1,213 mijë lekë për Tatim Fitimin dhe 264 mijë lekë gjobë tatimore.</p> <p>5. Nga auditimi i raportit të kontrollit, të subjektit “A..” SHPK konstatohet se në zërin "Konsum për vete" të vitit 2019 janë regjistruar bileta udhëtimi në vlerën 1,107,833 lekë, si dhe janë përfshirë shpenzimet e bëra për udhëtime për qëllime të biznesit, për të hapur treg të ri dhe për takime me furnitorë për furnizime. Në këtë zë është përfshirë edhe udhëtimi për pjesëmarrje në panairin e organizuar nga Hertz International Gjermani. Furnitori i këtij shërbimi është Shoqëria Landways International.</p> <p>Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, neni 21 dhe sipas përlllogaritjeve rezulton: Detyrimi për Tatim Fitimin $784,065 * 15\% = 117,609$ lekë Gjobë $117,609 * 0.06\% * 365$ ditë = 25,756 lekë.</p> <p>Pra, vlerësohen paraprakisht gjithsej 143,365 lekë detyrime tatimore, nga të cilët 117,609 lekë detyrime tatimore për Tatim Fitimin dhe 25,756 lekë gjobë tatimore.</p> <p>6. Nga auditimi i praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik) të subjektit “V.T..” SHPK konstatohet se: - Nuk janë analizuar normativat e harxhimit të karburantit sipas km të përshkruara dhe normativave për 100/km ato analizohen me kontrollin për tatimin mbi fitimin. Nuk është kryer analiza e harxhimit të karburantit dhe bilanci material për naftën e përdorur për të gjithë periudhën e kontrollit sipas km të përshkruara dhe normativave për 100/km sipas kartës teknologjike të mjeteve të kompanisë, harxhimi i karburantit në raport të rrugëve të kryera nga ana e subjektit për periudhën e kontrolluar. Subjekti ka kryer blerje të cilat nuk i shërbejnë aktivitetit për të cilat nuk duhet të kreditohej TVSH në vlerën 435,545 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar”, neni 21, pasi ky mjet nuk i shërben aktivitetit direkt por është për përdorim vetjak për nevojat e përfaqësuesit ligjor të subjektit dhe si i tillë nuk duhej kredituar TVSH-ja. Për veprimet e mësipërme në bazë të ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008, neni 115, për këtë diferencë që për vitin 2021 është 2,173,723 lekë penalitetet si më poshtë: TVSH : 435,545 lekë Gjobë TVSH (20%): 87,109 lekë Total Detyrimi për 2021: 522,654 lekë</p> <p>Pra, vlerësohen paraprakisht 522,654 lekë detyrime tatimore, nga të cilat 435,545 lekë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe 87,109 lekë gjobë tatimore.</p> <p>7. Nga auditimi i praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik) të subjektit “G.K.” SHPK, konstatohet se nga kontrolli mbi tatim fitimin për vitin 2021, shpenzimet për qira janë deklaruar 280,000 lekë nga 770,000 lekë që është vlera e kontratës. Për këtë diferencë për vitin 2021 prej 490,000 lekë llogariten penalitetet si më poshtë:</p>			
---	--	--	--

<p>TF 15%: 73,500 lekë Gjobë TF (21.9%): 15,876 lekë Total Detyrimi për 2021: 89,376 lekë</p> <p>Për vitin 2019 Kreditorë të tjerë në vlerën 3,400,000 lekë përfshijnë vlerën e kontributit të ortakut me vendim asambleje për likuiditetet në arkë, për pagesa dhe shpenzime rritjen e fondit të kompanisë.</p> <p>Për vitin 2020 kreditorë të tjerë janë në vlerë 5,550,000 lekë, ku nuk janë analizuar dhe nuk është përgatitur informacioni <u>RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë)</u> në lidhje me shumat të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “, neni 5, pika 1 dhe 2.</p> <p>Pra, vlerësohen paraprakisht gjithsej 89,376 lekë detyrime, nga të cilët 73,500 lekë detyrime tatimore për Tatim Fitimin dhe 15,876 lekë gjobë tatimore.</p> <p>8. Nga auditimi të subjektit ”A..” SHPK, për vitin 2020 në zërin blerje nga furnitorë vendas për investime është njohur si shpenzim për blerje e një autoveture Toyota në vlerën e tatueshme 4,341,800 lekë dhe TVSH në vlerën 868,360 lekë, e cila nuk i shërben aktivitetit të subjektit.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 21, pasi ky mjet nuk i shërben aktivitetit direkt, por është për përdorim vetjak për nevojat e përfaqësuesit ligjor të subjektit dhe si i tillë nuk duhej kredituar TVSH-ja.</p> <p>Për veprimet e mësipërme në bazë të ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008, neni 115, për vitin 2020: për 4,341,800 lekë penalitetet si më poshtë:</p> <p>TF 15%: 651,270 lekë Gjobë TF (21.9%): 142,628 lekë TVSH : 868,360 lekë Gjobë TVSH (20%): 190,170 lekë Total Detyrimi për 2020: 1,852,428 lekë</p> <p>Pra, vlerësohen paraprakisht gjithsej 1,852,428 lekë detyrime, nga të cilët 1,519,630 lekë detyrime tatimore dhe 332,798 lekë gjobë tatimore.</p> <p>9. Nga verifikimi i dosjes së kontrollit të subjektit “T. I.” SHPK, rezulton se subjekti operon në fushën e përpunimit të materialeve plastike në formë primare, ku kryen importe të lëndës së parë nga jashtë (e tipit lëndë e parë plastike PE dhe lëndë e parë plastike PVC). Nga të dhënat e paraqitura në RPK të mbajtur nga Inspektori i Kontrollit citohet se për prodhimin e gatshëm përdoret lënda e parë e marrë nga magazina e cila futet në proces si dhe shoqëria ka hartuar skedën teknologjike sipas të cilës humbjet teknologjike llogariten 7%, por kartelat teknologjike janë të pa depozituara në organet tatimore, për rrjedhojë nisur nga fakti që mungojnë kartat teknologjike humbjet e deklaruara nga subjekti janë të pa dokumentuara.</p> <p>Në faqen nr. 13 të RPK, është analizuar nga ana e Inspektorit bilanci material i shoqërisë për vitin 2020, 2021 dhe periudhën janar- mars 2022, për lëndët e para PE/kg, PVC/kg, Karbonat/kg, ngjyrues dhe stabilizant.</p> <p>Nga verifikimi i bilancit material për vitin 2021 rezulton se për lëndën e parë PE/kg gjendja në fund të inventarit paraqitet në vlerën 50,326,323 lekë me kosto/njësi 84 lekë/kg dhe sasi</p>			
---	--	--	--

<p>602,278 kg.</p> <p>Nga të dhënat e paraqitura rezultojn se për vitin 2021 edhe pse sasia e gjendjes së lëndës së parë PE është dyfishuar në raport me vitin 2020 ka një ulje drastike të kostos për njësi prej 84 lekë/kg, për rrjedhojë ka një situatë të nënvlerësimit të gjendjes kontabël të inventarëve të shoqërisë e cila analizohet duke ju referuar për analogji edhe vitit 2020.</p> <p>Në gjendjen në fund të paraqitur në vitin 2020 kosto për njësi e lëndës së parë PE është 109 lekë/kg e cila vjen si rezultat i metodës FIFO, ku regjistrohet kosto për njësi sipas hyrjes së vitit në këtë rast në vlerën 109 lekë/kg.</p> <p>Nga analiza e kryer nga ana e Grupit të Auditimit për vitin 2021, në RPK nuk është analizuar nga ana e inspektorit gjendja në fund e lëndës së parë PE, si dhe regjistrimi i kostos për njësi që është bërë nga ana e shoqërisë. Për rrjedhojë nuk është përdorur pesha specifike midis sasive dhe kosto/njësi në çelje të vitit si dhe kosto/njësi e hyrjeve të vitit, duke kryer regjistrimin e saktë kontabël të kosto/njësi në fund të vitit, si më poshtë:</p> <p>Pesha specifike sasi/kosto për njësi për hyrjet e vitit: sasi hyrje 2,160,215 kg / (sasi çelje 398,524 kg + sasi hyrje 2,160,215 kg) = 0.844 %;</p> <p>Pesha specifike sasi/ kosto për njësi për çeljet e vitit: 1 - 0.844 = 0.155;</p> <p>Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për hyrjet e vitit: 0.844% * 158 lekë/kg = 133.3915 lekë/kg;</p> <p>Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për çeljet e vitit: 0.156% * 109 lekë/kg = 16.97677 lekë/kg;</p> <p>Shuma e të dyjave do të duhej të ishte regjistrimi i kosto/njësi në fund të vitit ushtrimor: (133.39 lekë/kg + 16.98 lekë/kg) = 150.37 lekë/kg .</p> <p>Për sa më sipër nga ana e subjektit, si dhe në RPK kosto/njësi në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 84 lekë/kg e pa analizuar dhe e pa argumentuar, për rrjedhojë kemi ka një diferencë të kosto/njësi në vlerën (150.37 lekë/kg – 84 lekë/kg) = 66.3 lekë/kg</p> <p>Nga analiza e kryer më sipër rezultojn një nënvlerësim të inventarit kontabël në fund të vitit 2021 për lëndën e parë plastike PE me diferencë në çmim prej 66.3 lekë/kg, detyrimet si më poshtë:</p> <p><i>Sipas RPK, gjendja në 31.12.2021 për lëndë e parë PE/kg Sasi 602,278 kg * 84 lekë/kg = 50,326,323 lekë, vlera kontabël</i></p> <p><i>Sipas Grupit të Auditimit, sasi 602,278 kg * 150.37 lekë/kg = 90,563,484 lekë, vlera kontabël e korrektuar.</i></p> <p>Nga diferenca e konstatuar si pasojë e nënvlerësimit të inventarëve të shoqërisë është kryer nga Grupi i Auditimit rikarakterizimi i situatës, bazuar në Ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”, germa (b), si dhe bazuar në nenin 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit” është kryer rivlerësimi sipas të cilit janë përlllogarit detyrimet dhe gjobat e mësipërme në zbatim të nenit 115 “<i>Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore</i>”.</p> <p>Diferenca si pasojë e nënvlerësimit të inventarit rezultojn në shumën (90,563,484 lekë – 50,326,323 lekë) = 40,237,161 lekë</p> <p>Për këtë diferencë për vitin 2021 prej 40,237,161 lekë edhe penalitetet si më poshtë:</p>			
---	--	--	--

<p>TF 15%: 6,035,574 lekë Gjobë TF (21.9%): 1,321,791 lekë TVSH 20%: 8,047,432 lekë Gjobë TVSH (21.9%): 1,762,388 lekë Total Detyrimi për 2021: 17,167,185 lekë Pra, vlerësohen paraprakisht 17,167,185 lekë gjithsej detyrime nga të cilët 14,083,006 lekë detyrime tatimore dhe 3,084,179 lekë gjobë tatimore.</p> <p>10. Nga verifikimi i dosjes së kontrollit të subjektit “A. I.” SHPK, rezulton se artikulli “<i>Transformator tensioni</i>” me vlerë kontabël prej 14,152,754 lekë përbën peshën kryesore të inventarit kontabël të shoqërisë konkretisht në masën 71%. Për rrjedhojë u krye një analizë e thelluar e bilancit material në lidhje me kartelën inventarit “<i>Transformator tensioni</i>”.</p> <p>Nga auditimi rezulton se për këtë artikull është kryer dalje gjatë vitit ushtrimor 2016 nga ana e shoqërisë për 196 copë me çmim 154,935 lekë dhe vlerë kontabël 30,367,276 lekë. Çmimi i aplikuar në dalje paraqitur në bilancin material është dukshëm më i ulët se kosto/njësi paraqitur të hyrjet e vitit prej 167,380 lekë si dhe kosto/njësi paraqitur të çeljet e vitit prej 156,823 lekë.</p> <p>Nga ana e inspektorit në RPK nuk është kryer një analizë e thelluar dhe e qartë mbi aplikimin e shoqërisë të çmimit për daljet e vitit të paraqitur në bilancin material të shoqërisë, ku rezulton më i ulët për artikullin kryesor të inventarit kontabël. Për rrjedhojë nga ana e inspektorit duhej të ishte kryer një test analitik mbi çmimet e aplikuara nga shoqëria nëse janë paraqitur saktë dhe të mos jenë nën kosto.</p> <p>Nga ana e Grupit të Auditimit është përdorur metoda FIFO, për të përlllogaritur çmimin që duhej të aplikohet nga subjekti për artikullin “<i>Transformator tensioni</i>”, konkretisht si më poshtë: Diferenca në çmim: Kosto/njësi hyrjet e vitit 167,380 lekë – çmim dalje në Bilanc Material 154,935 lekë = 12,445 lekë; Marzhi i fitimit për vitin 2016: 23%; Çmimi i rivlerësuar: (12,445 lekë * 23%) = 15,307 lekë; Diferenca në vlerë: (196 copë * 15,307 lekë/copë) = 3,000,241 lekë.</p> <p>Inspektori i kontrollit nuk ka bërë rivlerësimin e të ardhurave në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71.</p> <p>Për diferencën e konstatuar për vitin 2016 prej 3,000,241 lekë penalitetet si më poshtë:</p> <p>TF 15%: 450,036 lekë Gjobë TF (0.06%/365): 98,558 lekë TVSH 20%: 600,048 lekë Gjobë TVSH (0.06%/365): 131,411 lekë Total Detyrimi për 2016: 1,280,053 lekë</p> <p>Në RPK të mbajtur nga ana e Inspektorit është hartuar bilanci material i vitit ushtrimor 2017, ku janë cilësuar artikujt e shoqërisë, gjendje në fillim, hyrjet e vitit, daljet e vitit si dhe gjendja në fund të periudhës me sasitë, kosto/njësi dhe vlerat kontabël.</p> <p>Nga të dhënat e paraqitura rezulton se artikulli “<i>Transformator tensioni</i>” me vlerë kontabël prej 11,309,207 lekë përbën peshën kryesore të inventarit kontabël të shoqërisë konkretisht në masën 40%. Për rrjedhojë u krye një analizë e thelluar e bilancit</p>			
--	--	--	--

<p>material në lidhje me kartelën inventarit “<i>Transformator tensioni</i>”.</p> <p>Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për vitin 2017 rezulton se kosto/njësi prej 124,277 lekë është dukshëm më e ulët se kosto/njësi në çelje prej 196,566 lekë si dhe kosto/njësi në hyrjet e vitit prej 142/752 lekë, për rrjedhojë kemi ka një situatë të nënvlerësimit të gjendjes kontabël të inventarëve të shoqërisë.</p> <p>Nga analiza e kryer nga ana e Grupit të Auditimit për vitin 2017, në RPK nuk është analizuar nga ana e inspektorit gjendja në fund e artikullit “<i>Transformator tensioni</i>” si dhe regjistrimi i koston për njësi që është bërë nga ana e shoqërisë. Për rrjedhojë nuk është përdorur pesha specifike midis sasive dhe kosto/njësi në çelje të vitit si dhe kosto/njësi e hyrjeve të vitit, duke kryer regjistrimin e saktë kontabël të kosto/njësi në fund të vitit, konkretisht si më poshtë:</p> <p>Pesha specifike sasi/kosto për njësi për hyrjet e vitit: sasi hyrje 302 / (sasi çelje 72 + sasi hyrje 302) = 0.81%;</p> <p>Pesha specifike sasi/ kosto për njësi për çeljet e vitit: 1 – 0.81 = 0.19 %;</p> <p>Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për hyrjet e vitit: 0.81 * 142,752 lekë/copë = 115,270 lekë/copë;</p> <p>Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për çeljet e vitit: 0.19 * 196,566 lekë/copë = 37,842 lekë/copë;</p> <p>Shuma e të dyjave do të duhej të ishte regjistrimi i kosto/njësi në fund të vitit ushtrimor: (115,270 lekë/copë + 37,842 lekë/copë) = 153,112 lekë/copë.</p> <p>Për sa më sipër nga ana e subjektit si dhe në RPK kosto/njësi në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 124,277 lekë/copë e pa analizuar dhe e pa argumentuar, për rrjedhojë kemi një diferencë të kosto/njësi në vlerën (153,112 lekë/copë – 124,277 lekë/copë) = 28,835 lekë/copë.</p> <p>Nga analiza e kryer më sipër rezulton se ka një nënvlerësim të inventarit kontabël në fund të vitit 2017 për artikullin “<i>Transformator tensioni</i>” me diferencë në çmim prej 28,835 lekë/copë, ku edhe detyrimet si më poshtë:</p> <p><i>Sipas RPK, gjendja në 31.12.2017 për artikullin Transformator Tensioni</i> Sasi 91 copë * 124,277 lekë/copë = 11,309,207 lekë, vlera kontabël</p> <p><i>Sipas Grupit të Auditimit</i> Sasi 91 copë * 28,835 lekë/copë = 2,623,978 lekë, vlera kontabël e korrektuar</p> <p>Nga diferenca e konstatuar si pasojë e nënvlerësimit të inventarëve të shoqërisë është kryer nga Grupi i Auditimit rikarakterizimi i situatës, bazuar në Ligjin 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, germa (b) si dhe bazuar në nenin 72 është kryer rivlerësimi sipas të cilit janë përlllogarit detyrimet dhe gjobat e mëposhtme në zbatim të nenit 115 pika 1.</p> <p>Diferenca si pasojë e nënvlerësimit të inventarit rezulton në shumën (90,563,484 lekë – 50,326,323 lekë) = 2,623,978 lekë</p> <p>Për diferencën e konstatuar për vitin 2017 në shumën prej 2,623,978 lekë penalitetet si më poshtë:</p> <p>TF 15%: 393,597 lekë</p> <p>Gjobë TF (21.9%): 86,198 lekë</p> <p>TVSH 20%: 524,796 lekë</p> <p>Gjobë TVSH (21.9%): 114,930 lekë</p>			
---	--	--	--

<p>Total Detyrimi për 2017: 1,119,521 lekë</p> <p>Pra, vlerësohen paraprakisht gjithsej 2,399,574 lekë, nga të cilët 1,968,477 lekë detyrime tatimore dhe 431,097 lekë gjobë tatimore.</p> <p>11. Nga verifikimi i dosjes së kontrollit të Personit fizik “M.K” operon në fushën e Hotelerisë dhe Strukturave të ngjashme, ku ka kërkuar rimbursimin e TVSH-së për periudhën 05/2019 – 12/2020 në vlerën 14,059,317 lekë. Nga ana e Grupit të Auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts në lidhje me personin fizik “M.K” ku ka rezultuar se: 1. Leje ndërtimi me nr. 1233, datë 19.06.2019 për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, nga ana e Bashkisë Kavajë, i është dhënë kjo leje ndërtimi për zhvilluesin M.K me NID/F...H, të cilit i lejohet ndërtimi i objektit për ndryshim projekti gjatë ndërtimit në objektin Hotel 5 kate + papafingo + bodrum sipas kushteve: Sipërfaqe e parcelës e zënë nga parkimi: 249.8 m² Sipërfaqe totale e ndërtimit: 2317.7 m² Afati i lejes është i vlefshëm për një periudhë 25 mujore nga data e fillimit të punimeve referuar grafikut të punimeve</p> <p>2. Leje ndërtimi me nr. 1978, datë 12.10.2020 për objektin pishinë në funksion të hotelit, nga ana e Bashkisë Kavajë, i është dhënë kjo leje ndërtimi për zhvilluesin M.K me NID/F...H, të cilit i lejohet ndërtimi i pishinë në funksion të hotelit sipas kushteve: Sipërfaqe e truallit: 500 m² Sipërfaqe e ndërtimit gjurma: 250 m² Afati i lejes është i vlefshëm për një periudhë 12 mujore nga data e fillimit të punimeve referuar grafikut të punimeve</p> <p>Nga të dhënat e cituara më sipër rezulton se nga lejet e ndërtimit të dhëna nga Bashkia Kavajë janë miratuar punimet për zhvilluesin M.K si individ me NID, dhe jo si person fizik me NIPT, për rrjedhojë zhvilluesit M.K nuk i lind e drejta e kreditimit të TVSH-së për shkak se nuk jemi në kushtet e një personi të tatueshëm. Nga lejet e ndërtimit të miratuara nga ana e Bashkisë Kavajë për të qenë në kushtet e një personi të tatueshëm duhej të ishin në favor të zhvilluesit të paraqitur me NIPT dhe i regjistruar në organet tatimore.</p> <p>Në RPK, e mbajtur nga Inspektori nuk janë analizuar lejet e ndërtimit si dhe të ishin verifikuar zhvilluesi i miratuar në këto leje ndërtimi nëse është person i tatueshëm dhe më pas të procedohej me kërkesën për rimbursim të paraqitur nga zhvilluesi M.K.</p> <p>Kreditimi i TVSH i saktësuar nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është në përputhje me Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 20 “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes”, pika 3 “Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim”, ku citohet se: <i>-pika 4.</i></p> <p>Për rrjedhojë e gjithë shuma e kërkuar prej 14,059,317 lekë për rimbursim nuk duhej proceduar nga Inspektori në RPK, subjektit i lindin detyrime në zbatim të <i>pikës 3, të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar</i>, janë llogaritur detyrimet përkatëse.</p> <p>Shuma e kërkuar për rimbursim: 14,059,317 lekë</p>			
---	--	--	--

	<p>TVSH 20%: 2,811,863 lekë</p> <p>Total Detyrimi: 16,871,180 lekë</p> <p>Pra, vlerësohen paraprakisht 14,059 mijë lekë detyrime tatimore dhe 2,812 mijë lekë gjobë tatimore.</p>			
2	<p>Nga auditimi i DRT. Durrës u konstatua se Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e qarkullimit sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat e TTHF dhe TF për tatimpaguesit, nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e procedurale, të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:</p> <p>a) Për subjekte biznesi i vogël pa TVSH u konstatuan se: - për vitin 2021 për 147 subjekte me qarkullim sipas kasës me vlerë 226,919,895 lekë më tepër sesa të ardhurat e deklaruara në TTHF dhe</p> <p>b) Për bizneset e vogla me TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TVSH-s, ku u konstatua se: - Për vitin 2021, për 18 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklaratat në FDP në vlerën 20,496,001 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 8,198,400 lekë.</p> <p>c) Për BM u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës, ku u konstatuan se, - Për vitin 2021, 9 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklaratat në FDP në vlerën 88,619,795 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 62,033,856 lekë.</p> <p>Nga sa më sipër, vlerësohen paraprakisht të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit gjithsej në shumën 70,232,256 lekë.</p>	25-73	E lartë	<p>DRT Durrës, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara në Tatimin mbi Fitimin, Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 35,116,128 lekë detyrime tatimore dhe 35,116,128 lekë gjobë tatimore për kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore.</p>

I.3 KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i përputhshmërisë.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Drejtoria Rajonale Tatimore, Durrës për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, nëpërmjet vlerësimit të përputhshmërisë së aktivitetit të DRT Durrës me ligjet dhe rregulloret, raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

Opinion i modifikuar:

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vendosur në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar”, e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin e modifikuar:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 100; ISSAI 400-499; ISSAI 4000-4899).

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinionin.

Opinionin e auditimit mbështetet me prova që justifikojnë përfundimet e arritura, si dhe me siguri të arsyeshme shprehemi që opinionin dhe gjetjet janë shprehur saktë në raport dhe pa lënë vend për keqkuptime.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, ka rezultuar se, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, nuk ka vepruar në përputhje të plotë me kriteret e vlerësimit që burojnë nga kuadri legjislativ dhe rregullativ në fuqi lidhur me aktivitetin e subjektit nën auditim. Nga auditimi janë konstatuar paraprakisht efekte negative në të ardhurat tatimore në buxhetin e shtetit gjithsej **133,341.8 mijë** lekë, nga të cilat në vlerën 81.254.7 mijë lekë detyrime tatimore si dhe 52.087.1 mijë lekë gjobë tatimore analizuar (39 % e totalit) si më poshtë:

- Nga auditimi me përzgjedhje i 40 raporteve të kontrollit tatimor, në 11 subjekte nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur procedurat e kontrollit, mbi analizimin e situatës financiare dhe deklarimeve të subjektit, ku janë konstatuar paraprakisht mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore në vlerën prej 46,139 mijë lekë detyrime tatimore si dhe 10,058 mijë lekë gjobë tatimore për plotësim të pasaktë të deklaratës tatimore detajuar si në vijim:

- Për 4 subjekte të audituara kanë rezultuar mangësi në vlerësimin e inventarit fizik ku përfshihen shitje mallrash nën kosto, të cilat vlerësohen paraprakisht në 17,971 mijë lekë detyrime tatimore dhe 4,371 mijë lekë gjobë tatimore;
- Për 5 subjekte të audituara kanë rezultuar mangësi në identifikimin e shpenzimeve të panjohura në përputhje me legjislacionin tatimor nga ana e inspektorëve të kontrollit, të cilat vlerësohen paraprakisht në 3,359 mijë lekë detyrime tatimore dhe 725 mijë lekë gjobë tatimore;
- Për 2 subjekte të audituar kanë rezultuar mangësi në identifikimin e kriterëve ligjorë për përfitimin e rimbursimit të TVSH-së, të cilat vlerësohen paraprakisht në 24,808 mijë lekë detyrime tatimore dhe 4,962 mijë lekë gjobë tatimore.

- Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e qarkullimit sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat e Tatim Fitimit të Thjeshtuar dhe Tatim Fitimit për tatimpaguesit, nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për 325 tatimpagues, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e procedurale duke shkaktuar efekte negative në të ardhurat tatimore në vlerën 35,116 mijë lekë detyrim tatimor dhe 42,029 mijë lekë gjobë tatimore për kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore:

- Nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor në vend, në kontrollet e ushtruara (3 raste), nuk janë analizuar në mënyrën e duhur llogaritë "Detyrime afat shkurtër" (detyrime ndaj ortakut) dhe "Detyrime afatgjatë" (hua), veprime në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, kërkesat e Programit të kontrollit tatimor, si dhe me Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF nr. 16, datë 16.02.2009 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave", neni 5 "Raportimi i aktivitetit të dyshimtë (RAD)", pika 1 dhe 2.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të DRT. Durrës:

Strukturat drejtuese të DRT Durrës, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësive publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara ligjore, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr.15/1 prot., datë 09.01.2023 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 11.01.2023 deri në datë 31.03.2023 në subjektin DRT. Durrës për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2021 deri në 31.12.2022, u krye auditimi “Mbi auditimin e përputhshmërisë” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- A.P, Përgjegjës Grupi
- A.H, Auditues
- G.T, Auditues
- A B, Auditues
- F.D, Auditues

1. Objekti i auditimit: Auditim përputhshmërie në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës.

2. Qëllimi i auditimit: Në qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse aktiviteti i zhvilluar për periudhën objekt auditimi përputhet me kriteret përkatëse të kuadrit ligjor, nënligjor e rregullator të fushës.

Objektivi i Auditimit është arritja e një konkluzioni dhe dhënia e opinionit nëse aktiviteti i zhvilluar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës është në përputhje ose jo me dispozitat ligjore, nënligjore dhe rregullatore përkatëse.

Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë:

Dhënia e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemit të inspektimit dhe kontrollit tatimor të subjekteve, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve të komponentëve të mëposhtëm:

- Evidentimi i shmangieve të veprimtarisë së DRT Durrës me kriteret e vlerësimit në bazë të kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për periudhën objekt i auditimit;
- Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e proceseve sipas legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara nga DPT.;
- Vlerësimi i veprimeve, zbulimi i mospërputhjeve me pasojë të ardhura të pa llogaritura, mungesë të ardhurash dhe ato të evazionit tatimor;
- Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës;
- Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, arkëtimi i të ardhurave të munguara për buxhetin e shtetit dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen.
- Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, gjatë veprimtarisë së tij.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar të shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar. Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;
- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre;
- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

3. Identifikimi i çështjes: Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021 deri më 31.12.2022, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni sipas ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përbërëse në DRT. Durrës të cilat monitorojnë ecurinë e realizimit të të ardhurave tatimore për Qarkun Durrës, ecurinë e vetëdeklarimit të tatimpagueseve, saktësinë e këtyre deklaratave, monitorimin e mosdeklaruesve në të gjitha llojet e tatimeve, si dhe çështje të tjera të cilat kanë rezultuar gjatë auditimit etj.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Është detyrimi i strukturave drejtuese në DRT. Durrës, që në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës.

Drejtori Rajonal përfaqëson Drejtorinë Rajonale Tatimore dhe vepron si pikë e parë e kontaktit midis DPT. dhe DRT. Është përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore për të maksimizuar mbledhjen e të ardhurave tatimore, si dhe zbatimin e detyrave të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi. Drejtori i Kontrollit mban përgjegjësi në menaxhimin e sektorëve të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në zbatimin e planeve mujore dhe vjetore të kësaj drejtorie, dhe merr raporte lidhur me zbatimin e tyre nga përgjegjësit e sektorëve. Përgatit raport për realizimin e detyrave dhe harton plane kontrolli apo vizita fiskale për inspektorët në varësi. Drejtori i Shërbimit mban përgjegjësi në informimin e Drejtorit Rajonal dhe raporton çdo problematikë të stafit punonjës. Siguron përdorimin, publikimin, dhe raportimin e të dhënave brenda afateve të përcaktuara.

5. Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar nëpërmjet auditimit të realizuar;

- Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4000), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne si Auditues Shtetëror do të shprehemi me një opinionin mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e aktivitetit të institucionit.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme për çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit: Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të DRT. Durrës, normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit dhe përcaktimet në marrëveshjet ndërkombëtare që kanë lidhje me sistemin tatimor në Republikën e Shqipërisë.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- *Kushtetuta dhe Ligji nr. 154.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit.*

- *Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*
- *Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.*
- *Ligji me Nr. 92.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”.*
- *VKM Nr.4, datë 19.06.2017 për miratimin e “Rregullores së njëhsuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Lartë të Arkivave.*
- *Rregullore Nr. 2 “Mbi procedurat e përzgjedhjes për kontroll të tatimpaguesve”,*
- *Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 14, datë 28.12.2006”, etj.*

7. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

- ISSAI 100 *“Parimet themelore të auditimit të sektorit publik“* që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 *“Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë“* që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 *“Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë“*; si dhe ISSAI 4200;
- INTOSAI *“Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”* etj.;
- *Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve;*
- *Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.*

8. Metodatat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera ,me qëllim arrijen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. Intervistimi - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- b. Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifiku me drejtimit e auditimit;
- c. Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- d. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arrijen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

9. Dokumentimi i auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me

standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport i Auditimit.

Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në entitetin DRT. Durrës, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit ka konsistuar në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtuar vlerësimin përmes skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1 Informacioni i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT.) Durrës është institucion publik, buxhetor, në varësi të drejtpërdrejtë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Misioni i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve është mbledhja e detyrimeve tatimore, ofrimi i shërbimeve dhe asistencës për tatimpaguesit, kontrolli i deklaratave dhe pagesave, kontrolli i tatimpaguesve si dhe mbledhja e borxhit tatimor.

Objektivat e përgjithshme të DRT.-së:

- Të sigurojnë ndërmarrjen e të gjithë veprimeve në aktivitetin e tyre të cilat çojnë në zbatimin rigoroz të planit strategjik të administratës tatimore qendrore;
- Të mbledhin të ardhurat tatimore në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin tatimor në fuqi me koston më të ulët të mundshme, nëpërmjet nxitjes dhe vetëvlerësimit e plotësimit vullnetar të detyrimeve nga tatimpaguesit dhe nëpërmjet kontrolleve të paanshme për të gjithë tatimpaguesit, për të zbuluar dhe korrigjuar rastet e moszbatimit të ligjeve tatimore;

- Të bashkëpunojnë me drejtoritë përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e planit operacional në përputhje me objektivat e vendosura në planin strategjik të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Të përcaktojnë plane operationale vjetore me shkrim për çdo funksion;
- Të bashkëpunojnë me strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për trajnimin e punonjësve;
- Të hartojnë dhe zbatojnë programe në mënyrë që përgjegjësit të përgatisin raporte me shkrim për vlerësimin e punës së kryer gjatë vitit nga punonjësit nën varësinë e tyre;
- Të ndjekin të gjitha procedurat standarde të punës, të përcaktuara nga drejtoritë funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejttimeve të auditimit

2.1. Mbi programimin e të ardhurave tatimore, realizimin e tyre, ndarë sipas strukturës së të ardhurave tatimore për periudhën objekt auditimi

Në zbatim të kësaj pike të Programit të Auditimit, u shqyrtuan informacionet dhe dokumentacionet:

- *Treguesit e realizimit të planit të DRT. Durrës;*
- *Raporte elektronike të gjeneruar prej sistemit informatik C@ts;*
- *Analiza dhe raporte progresive për realizimin e të ardhurave nga Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit;*
- *Të dhëna për tatimpaguesit në lidhje me taksat si TVSH, Tatimin mbi Fitimin, Ardhurat Personale, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore etj;*
- *Akt Rakordimet e mbajtura midis DRT. Durrës dhe Degës së Thesarit;*
- *Çdo informacion dhe dokumentacion shtesë i vlerësuar për kontroll nga grupi i auditimit dhe i vënë në dispozicion nga punonjësit në DRT. Durrës.*

- *Auditimi i të ardhurave kryesore tatimore.*

Nga auditimi i të dhënave të planit dhe faktit të të ardhurave në DRT. Durrës për vitin 2021, janë konstatuar se të ardhurat bruto tatimore dhe kontributet e sigurimeve janë realizuar në masën 15,126,585 mijë lekë ose +452,085 mijë lekë, ose +3.0% më shumë se plani i rishikuar. Ky realizim vjen kryesisht nga efekti i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore që janë realizuar me +185,766 mijë lekë ose +2% më shumë se plani i rishikuar, por ndikim negativ kanë pasur mosrealizimi i të të ardhurave nga tatimi i vlerës së shtuar me - 64,952 mijë lekë ose - 3% se planit i rishikuar.

Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat bruto tatimore në efekt rezultat kanë ndryshuar me 1,915,090 mijë lekë ose me +14.0%, respektivisht +21% nga rritja e të ardhurave tatimore dhe +11.0% nga rritja e kontributeve të sigurimeve.

Më poshtë po paraqesim në tabelë planin dhe faktin e të ardhurave të DRT. Durrës për vitet 2020-2021:

Tabela nr.1 Të ardhurat e DRT. Durrës

në 000 lekë

Emërtimi	Faktet		Plani	Diferenca Fakt-Plan		Diferenca 2020 - 2021	
	2020	2021	2021	+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje
DRT. Durrës TOTAL (Bruto)	13,211,495	15,126,585	14,674,500	452,084	3%	1,915,090	14%

(Tatimet + Rimbursime + Kontribute)				0		0	
Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	5,043,731	6,080,818	5,814,500	266,318	5%	1,037,087	21%
<i>Nga te cilat:</i>				0		0	
Tatimi Vleres se Shtuar	1,858,056	2,243,048	2,308,000	-64,952	-3%	384,992	21%
- Tatimi Vleres se Shtuar (neto)	834,432	865,691	1,138,000	-272,309	-24%	31,259	4%
- Rimbursimi i kryer (gjithej)	1,023,624	1,377,357	1,170,000	207,357	18%	353,733	35%
Tatim mbi Fitimin	1,467,443	1,817,872	1,624,000	193,872	12%	350,429	24%
Ardhura Personale	1,634,315	1,917,629	1,758,500	159,129	9%	283,314	17%
Taksat Nacionale	73,439	92,262	124,000	-31,738	-26%	18,824	26%
Taksa Qarkullimit Rrugor				0		0	
Lojrat e Fatit				0		0	
Te tjera pa identifikuar	10,478	10,007		10,007		-472	-5%
Denimet Administrative				0		0	
				0		0	
Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	4,020,107	4,703,461	4,644,500	58,961	1%	683,354	17%
				0		0	
Kontributet e Sigurimeve gjithsej	8,167,763	9,045,766	8,860,000	185,766	2%	878,003	11%
- Tarifa jo Tatimore				0		0	
DRT. Durres TOTAL (Neto)	12,187,871	13,749,227	13,504,500	244,727	2%	1,561,357	13%
(Tatimet neto + Kontributet)				0		0	

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës të përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për vitin 2021, është konstatuar se është realizuar në shumën 1,817,872 mijë lekë, me një rritje prej 193,872 mijë lekë ose 12% e planit të rishikuar. Realizimi i këtij zëri në fund të vitit 2020 është 1,467,443 mijë lekë ndërkohë që në buxhetin e vitit 2021 ky zë miratohet në nivelin 1,817,872 mijë lekë ose 24% më shumë se realizimi i një viti më parë.

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) për vitin 2021, është konstatuar se janë realizuar në masën 2,243,048 mijë lekë, ose më një nën realizim prej -64,952 mijë lekë ose 3% më pak se plani i rishikuar, por më një rritje prej 384,992 mijë lekë ose 21% në krahasim me realizimin e vitit 2020. Nga një analizë e detajuar e të dhënave në lidhje me TVSH-në, të vendosura në dispozicion për DRT. Durrës për vitin 2021, kanë rezultuar 4,308 subjekte deklarues të cilat kanë plotësuar deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së) në përputhje me Ligjin Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, seksioni 6, neni 106, të cilët të ndarë sipas sektorëve të ekonomisë paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.2 Subjekte që kanë plotësuar deklaratën e TVSH
Në lekë

Sektori Ekonomisë	Nr. Deklaruesish 2021	Deklarimi TVSH 2021	Nr. Deklaruesish 2022	Deklarimi TVSH 2022
Në Sektorin e Ndërtimit	416	15,422,241,292	485	20,382,949,010
Në Sektorin Prodhimit	901	40,095,409,297	925	54,180,999,002
Në Sektorin Shërbimit	1096	27,152,262,049	1,219	36,811,952,801
Në Sektorin Transportit	286	18,171,230,238	308	22,284,262,921
Në Sektorin Tregtisë	1609	62,230,156,201	1,702	70,789,207,434
Total	4308	163,071,299,077	4,639	204,449,371,168
			-	-

Burimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, përpunuar nga K.L.SH

Nga analiza e FDP përmbledhëse të TVSH-së, referuar deklarimeve të vitit 2021, kanë rezultuar ndryshimet në rubrikat kryesore, në krahasim me vitin paraardhës si më poshtë:

- Janë rritur (9) “Shitjet e përjashtuar” me +31% dhe (10) “Shitjet pa TVSH” me +7%;
- Janë rritur me +19% deklarimi i (13) “Shitjet të tatueshme me shkallë tatimore 20%”;
- Janë rritur me +115% deklarimi i (17) “Shitjeve të tatueshme me shkallë tatimore 6%”;
- Janë rritur me +28% deklarimet për (27) “Blerje investime brenda vendit pa TVSH”;

Nga auditimi ka rezultuar se në listën e 20 subjekteve me xhiron më të lartë në DRT. Durrës si dhe me TVSH-në e paguar më të lartë përgjatë vitit 2021, mbizotërojnë subjektet e sektorit të transportit, tregtisë dhe ndërtimit, konkretisht subjektet Adriaferries, Albtorus etj.

Nga auditimi i të dhënave të planit dhe faktit të të ardhurave në DRT. Durrës për vitin 2022, janë konstatuar se të ardhurat bruto tatimore dhe kontributet e sigurimeve janë realizuar në masën 17,905,655 mijë lekë ose +878,676 mijë lekë, pra +5% më shumë se plani i rishikuar. Ky realizim vjen nga realizimi i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore që janë realizuar me +606,808 mijë lekë ose +6 % se plani i rishikuar, por ndikim negativë kanë pasur mosrealizimi i të ardhurave të tatimit të vlerës së shtuar me -168,697 mijë lekë ose -7% se planit i rishikuar. Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat bruto tatimore në efekt rezultant kanë ndryshuar me +2,779,071 mijë lekë ose me +16.0%, respektivisht +19% nga rritja e të ardhurave tatimore dhe +13.0% nga rritja e kontributeve të sigurimeve. Më poshtë po paraqesim në tabelë planin dhe faktin e të ardhurave të DRT. Durrës për vitet 2021-2022:

Tabela nr.3 Të ardhurat e DRT. Durrës në 000 lekë

EMERTIMI	PERIUDHA - 12 MUJORE 2022						
	Faktet		Plani	Diferenca Fakt-Plan		Diferenca 2021-2022	
	2021	2022	2022	+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje
DRT. Durrës TOTAL (Bruto)	15,126,585	17,905,655	17,026,979	878,676	5%	2,779,071	16%
(Tatimet + Rimbursime + Kontribute)							
Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	6,080,818	7,552,047	7,281,979	270,068	4%	1,471,229	19%
<i>Nga te cilat:</i>							
Tatimi Vleres se Shtuar	2,243,048	2,491,303	2,660,000	-168,697	-7%	248,255	10%
- Tatimi Vleres se Shtuar (neto)	865,691	462,608	955,000	-492,392	-106%	-403,084	-87%
- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	1,377,357	2,028,695	1,705,000	323,695	16%	651,338	32%
Tatim mbi Fitimin	1,817,872	2,676,516	2,349,999	326,517	12%	858,643	32%
Ardhura Personale	1,917,629	2,273,267	2,160,000	113,267	5%	355,639	16%
Taksat Nacionale	92,262	100,377	111,980	-11,603	-12%	8,115	8%
Taksa Qarkullimit Rrugor							
Lojrat e Fatit							
Te tjera pa identifikuar	10,007	10,585		10,585		578	5%
Denimet Administrative							
Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	4,703,461	5,523,352	5,576,979	-53,627	-1%	819,891	15%
Kontributet e Sigurimeve gjithsej	9,045,766	10,353,608	9,745,000	608,608	6%	1,307,842	13%
- Tarifa jo Tatimore							
DRT. Durrës TOTAL (Neto)	13,749,227	15,876,960	15,321,979	554,981	3%	2,127,733	13%
(Tatimet neto + Kontributet)							

Burimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, përpunuar nga K.L.SH

Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për vitin 2022, është konstatuar se është realizuar në shumën 2,676,516 mijë lekë, me një rritje prej +326,517 mijë lekë ose +12% e planit të rishikuar. Realizimi i këtij zëri në fund të vitit 2021 është 1,817,872 mijë lekë ndërkohë që në buxhetin e vitit 2022 ky zë miratohet në nivelin 2,349,999 mijë lekë ose +29% më pak se realizimi i një viti më parë. Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2022, është konstatuar se janë

realizuar në masën 10,353,608 mijë lekë, me një tejkalim në realizim prej +608,608 mijë lekë ose +6% më shumë se plani i rishikuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ku të ardhurat nga kontributet ishin 9,045,766 mijë lekë, rezultatet janë në rritje me +1,307,842mijë lekë ose +13% më shumë se viti paraardhës. Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) për vitin 2022, është konstatuar se janë realizuar në masën 2,491,303 mijë lekë, ose më një mosrealizim prej -168,697mijë lekë ose -7% më pak se plani i rishikuar, por më një rritje prej +248,255mijë lekë ose +10% në krahasim me realizimin e vitit 2021 Nga një analizë e zgjeruar e të dhënave në lidhje me TVSH-në, të vendosura në dispozicion për DRT. Durrës për vitin 2022, kanë rezultuar 4,639 subjekte deklarues të cilat kanë plotësuar deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së) në përputhje me Ligjin Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, seksioni 6, neni 106, të cilët të ndarë sipas sektorëve të ekonomisë paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.4 Subjekte që kanë plotësuar deklaratën e TVSH në lekë

Sektori Ekonomisë	Nr. Deklaruesish 2021	Deklarimi TVSHTVSH 2021	Nr. Deklaruesish 2022	Deklarimi TVSHTVSH 2022
Në Sektorin e Ndërtimit	416	15,422,241,292	485	20,382,949,010
Në Sektorin Prodhimit	901	40,095,409,297	925	54,180,999,002
Në Sektorin Shërbimit	1096	27,152,262,049	1,219	36,811,952,801
Në Sektorin Transportit	286	18,171,230,238	308	22,284,262,921
Në Sektorin Tregtisë	1609	62,230,156,201	1,702	70,789,207,434
Total	4308	163,071,299,077	4,639	204,449,371,168

Burimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, përpunuar nga K.L.SH

Nga analiza e FDP përmbledhëse të TVSH-së, referuar deklarimeve të vitit 2022, kanë rezultuar ndryshimet në rubrikat kryesore, në krahasim me vitin paraardhës si më poshtë:

- Janë rritur (9) “Shitjet e përjashtuar” me +10% dhe (10) “Shitjet pa TVSH” me +45%;
- Janë rritur me +100% deklarimi i (15) “Shitjet të tatueshme me shkallë tatimore 10%”;
- Janë rritur me +14% deklarimi i (13) “Shitjet të tatueshme me shkallë tatimore 20%”;

Nga auditimi ka rezultuar se në listën e 20 subjekteve me xhiron më të lartë në DRT. Durrës si dhe me TVSH-në e paguar më të lartë përgjatë vitit 2022, mbizotërojnë subjektet e sektorit të transportit, tregtisë dhe ndërtimit, konkretisht subjektet Adriaferries, Albtorus etj.

Nga auditimi konstatohet se në vitin 2022 është rritur me 301 numri i subjekteve që kanë plotësuar deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së).

Nga auditimi konstatohet se si për vitin 2021 po ashtu edhe për vitin 2022 nuk është realizuar zëri me të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH).Ky mosrealizim vjen si pasojë e mungesës së saktë të planifikimit por edhe si pasojë e mungesës së kryerjes së analizave periodike sipas fushave kryesore të të ardhurave.

- Auditimi i të ardhurave dytësore tatimore, evidentimi dhe regjistrimi:

Nga auditimi u evidentua që të ardhurat tatimore në bazë deklarate, arkëtohen në një llogari të vetme në DPT., e cila nëpërmjet strukturës përkatëse të Drejtorisë së Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhurave evidenton, regjistron dhe përpilon pasqyrat financiare të të ardhurave tatimore për të gjitha DRT., nëpërmjet sistemeve informatike fiskale.

Për këto të ardhura që realizohen nga Sektori i Analizës dhe i Kontabilitetit të të Ardhurave në DRT. Durrës regjistron shumat e arkëtuara në kredi të llogarisë 4481100 “Agjent shërbimesh të vitit në vazhdim”, me kartela analitike për çdo Bashki dhe Njësi Administrative, për administrimin e tatim të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, dhe për këtë qëllim mbahen gjithashtu akt-rakordime për të ardhurat e realizuara dhe të derdhura për llogari të DPT. për në buxhetin e shtetit me degën e thesarit në fund të vitit.

Më konkretisht:

- Të ardhurat nga Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin (TTHF).

Duke ju referuar Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, neni 10 dhe neni 11, ku përcaktohet se për shërbimin e kryer administrata tatimore rajonale përfiton të ardhura në masën 1% të shumës së arkëtimit për llogari të qeverisjes vendore të të ardhurave tatimore nga TTHF për biznesin e vogël, të arkëtuara nga DRT.. Kjo shumë (1% i TTHF) derdhet për llogari të DPT., në buxhetin e shtetit nga të ardhurat e grumbulluara si agjent tatimor DRT. nga pushteti vendor. Nga auditimi i dokumentacionit dhe evidencave me të dhëna për periudhën kohore objekt auditimi, nga komisionet e përfituara në masën 1% të TTHF mbi biznesin e vogël si agjent taksash është realizuar një e ardhur në shumën prej 383 mijë lekë për vitin 2021, 78 mijë lekë për vitin 2022.

- Të ardhurat nga shitja e shtypshkrimeve.

Nga auditimi i evidencave dhe dokumentacionit mbi shitjet e shtypshkrimeve si fatura tatimore, fatura shoqërimi, dëftesë tatimore si dhe bileta transporti rrugor, etj, janë realizuar të ardhura në shumën prej 12,914 mijë lekë për vitin 2021 dhe 5,251 mijë lekë për vitin 2022.

Për sa më sipër mban përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre: Znj. D.T, në detyrën e Drejtores së Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës

1. Titulli gjetjes:	Mosrealizimi i zërave kryesore të planit të të ardhurave, si dhe mungesa e kryerjes së analizave periodike sipas fushave kryesore të të ardhurave.
Situata:	Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) për vitin 2021, është konstatuar se janë realizuar në masën 2,243,048 mijë lekë, ose më një mosrealizim prej -64,952 mijë lekë ose -3% se planit i rishikuar. Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) për vitin 2022, është konstatuar se janë realizuar në masën 2,491,303 mijë lekë, ose më një mosrealizim prej -168,697mijë lekë ose -7% më pak se plani i rishikuar. Shkresa nr.8637/1., datë 21.05.2021 “Dërgohet plani i të ardhurave për vitin 2021”; Shkresa nr.15208, datë 09.12.2022 “Dërgohet plani i të ardhurave për vitin 2022”; Rregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdhërin nr.192, datë 12.08.2020; pika 3 dhe pika 4;
Kriteri:	Planet vjetore 2021 dhe 2022
Ndikimi/Efekti:	Mosrealizim i të ardhurave tatimore sipas planit të dërguar nga DPT., duke shkaktuar mungese të ardhurave në buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Drejtoria e Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhurave nuk bën një parashikim dhe planifikim real në lidhje me të ardhurat, si rrjedhojë e mungesës së analizave të realizimit të zërave të të ardhurave, të dhënat e paraqitura nga

	kjo drejtori janë thjesht evidenca statistikore.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Drejtoria e Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhurave, të analizojë faktorët që ndikojnë në realizimin e planit të të ardhurave tatimore, sipas zërave dhe burimeve të disponueshme të tatimpaguesve që ajo administron dhe t'i paraqes ato në mënyrë të dokumentuar në DPT, për marrje në konsideratë nga ana e saj, si dhe të realizohen analiza periodike për ecurinë e realizimit të të ardhurave, në funksion të realizimit të planit të të ardhurave tatimore sipas zërave.

III.2.2. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.

Në bazë të dokumentacionit të kërkuar në lidhje me subjektet e planifikuara për kontroll dhe të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës grupi i auditimit ka përgjedhur dosjet e kontrollit mbi bazë risku. Përzgjedhja konsistoi në parimin e respektimit të shqyrtimit të dosjeve për çdo Inspektor Kontrolli në 6 kriteret bazë në lidhje me

1-Kontrolle Normale

2-Kontrolle për rimbursim,

3-Xhiron (Të ardhurat pa TVSH për secilën nga vitet).

4-Norma e fitimit Vjetor Fitimit Bruto/të ardhura për secilin vit.

5-Zbulime gjatë kontrollit

6-Sektori dhe lloji i aktivitetit të subjektit.

Sa më sipër, u përzgjedhën në bazë risku për auditim 40 dosje fizike të raport kontrolleve të evaduar gjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2022. Nga auditimi i kryer, analizuar rast pas rasti u konstatua se:

- Ka mangësi në evidentimin, sistemimin, përpunimin tekniko-shkresor, administrimin e dokumentacionit në dosjet e praktikave të kontrolluara, ky dokumentacion nuk është inventarizuar, protokolluar, arkivuar në përputhje me nenet 9, 15, 23, 24, 89 të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe nenet 4 dhe 8 të VKM Nr.4, datë 19.06.2017 për miratimin e “Rregullores së njëhsuar të punës me dokumentet ne autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Lartë të Arkivave.

Ka mangësi në hartimin e shkresave zyrtare dhe komunikimin shkresor, mangësi në miratimin e tyre, në moszbatim të neneve 43 dhe 99 të Ligjit Nr.44, datë 30.04.2015 “Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, neneve 1,3,7,12,13,80,83 të ligjit nr.9920, date 19.06.2008 “Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenet 57,58,59,60 të Urdhërit Nr.192, datë 12.08.2020 Për miratimin e Rregullores së Funksionimit të Administratës Rajonale Tatimore, pikat 9.3, 9.4, 9.5 të kapitullit IX Menaxhimi i Kontrollit Tatimor të Manualit të Kontrollit Tatimor. Konkretisht kemi firmosje të akteve zyrtare nga drejtori i caktuar i kontrollit tatimor edhe si drejtor edhe si përgjegjës. Vlerësojmë se ka moszbatim të këtyre kriterëve të ligjit, rregullores e manualit që janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga inspektorët, përgjegjesi, drejtori i kontrollit tatimor, drejtori i DRT.. Moszbatim të kriterëve të ligjshmërisë, cënim të tyre, në lidhje me drejtësin dhe integritetin si element stabiliteti dhe kohëzgjatje në emërimin meritokratik të stafit. Konstatohet mosrespektim të pikës 3, parimit të hierarkisë: “*Institucionet e administratës shtetërore të organizohen mbështetur në parimin e hierarkisë, sipas të cilit vartësis, në cdo nivel, duhet të ndjekin zinxhirin vendimarrës dhe të komunikojnë me eprorët e tyre vetëm nëpërmjet eprorit më të afërt në hierarki*”, të VKM nr.893, datë 17.12.2014 “Për

miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm. Në këto akte e veprime konstatohet parregullshmëri, papërshtatshmëri dhe mungesë të qëndrueshmërisë së tyre.

Kjo vjen si pasojë e mos zbatimit të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 48, Transferimi i përkohshëm, pika 1, ku citohet ” *Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, për këto arsye dhe kohëzgjatje: a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve;*

Me Urdhërin Nr.43, datë 05.08.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve urdhërohet të ushtrojë detyrat funksionale të Drejtorit të Drejtorisë, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës (deri në përfundim të auditimit në subjekt ky urdhër vazhdon të jetë në fuqi), z.D.XH i cili është në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës.

1. Subjekti E.GNIPT:me nipt K..T

Aktiviteti: *Prodhim qese plastike,fletë polietileni për bujqësi*

Inspektori i kontrollit Sh.P, përgjegjës kontrolli D.XH, Drejtor Kontrolli D.XH, Drejtor Rajonal D.T.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH 03/2016 deri me 02/2021.

-Tatim Fitimi vitit 2016 deri 2020.

-Kontributet e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetësore 03/2016 deri me 02/2021.

- Kontribute të tjera nga 03/2016 deri me 02/2021.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

Nga analiza e kryer nga ana e inspektorit të kontrollit, shitjet e realizuara sipas klientëve dhe llojit të produktit për vitin 2019 paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Njësi	Sasi	cmim	Vlerë në lekë
Fletë polietileni	kg	225,014	195.64	44,021,017
Plasmas	kg	897	205.93	184,720
Qese polietileni	kg	12,611.5	242.10	3,053,205
Shuma		238,523		47,258,942

Analiza e bilancit material nisur nga gjendja e inventarit të lëndës së parë dhe produktit të gatshëm në fillim të periudhës, blerjet e lëndës së parë gjatë periudhës së kontrollit, daljet e lëndës së parë për prodhim, prodhimin të gatshëm gjatë periudhës së kontrollit, shitjes së produktit të gatshëm gjatë periudhës së kontrollit, inventarit të lëndës së parë dhe produktit të gatshëm në fund të periudhës së kontrollit paraqitur nga ana e inspektorit të kontrollit për vitin 2019 rezulton si më poshtë:

	01.01.2019			31.12.2019
	gjendje	hyrje	dalje	gjendje
Polietilen	115,693	152,656	243,522	24,827

Nga sa më sipër rezulton se sasia në dalje nga magazina e lëndës polietilen prej 243,522 kg nuk rakordon me sasinë e shitur të polietilenit prej 238,523 kg, me një diferencë prej 4,999 kg polietilen të pa deklaruar në shitje me një çmim mesatar shitjeje prej 198.13 lekë/kg. Nga ana e inspektorit të kontrollit, nuk është analizuar kjo diferencë, por ka dalë në përfundimin se nga lëvizja materiale e lëndës së parë polietilen nuk ka diferenca materiale.

Diferencat e mësipërme në shumën prej 990,452 lekë (4,999 kg * 198.13 lekë/kg), nuk është trajtuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, neni 124 ku përcaktohet se: “Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”.

Perlllogaritjet sipas përcaktimit të mësipërm janë:

Detyrimi për TVSH-në $990,452 * 20\% = 198,092$ lekë.

Gjobë 100% $198,092 = 198,092$ lekë.

Detyrimi për Tatim Fitimin $990,452 * 15\% = 148,568$ lekë.

Gjobë 100% $148,568 = 148,568$ lekë.

Efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit vlerësohet paraprakisht se është në shumën 693,320 lekë.

Nga analiza e kryer nga ana e inspektorit të kontrollit, shitjet e realizuara sipas klientëve dhe llojit të produktit për vitin 2017 paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Njësi	Sasi	cmim	Vlerë
Fletë polietileni	kg	98,920	187.84	18,581,108
Plasmas	kg	100	200	20,000
Qese polietileni	kg	712	239.61	170,600
Shuma		99,732		18,771,708

Analiza e bilancit material nisur nga gjendje e inventarit të lëndës së parë dhe produktit të gatshëm në fillim të periudhës, blerjet e lëndës së parë gjatë periudhës së kontrollit, daljet e lëndës së parë për prodhim, prodhimin të gatshëm gjatë periudhës së kontrollit, shitjes së produktit të gatshëm gjatë periudhës së kontrollit, inventarit të lëndës së parë dhe produktit të gatshëm në fund të periudhës së kontrollit paraqitur nga ana e inspektorit të kontrollit për vitin 2017 rezultojnë si më poshtë:

	01.01.2017			31.12.2017
	gjendje	hyrje	dalje	gjendje
Polietilen	8,079	107,800	96,528	19,351

Nga sa më sipër rezultojnë se sasia në dalje nga magazina e lëndës polietilen prej 96,528 kg nuk rakordon me sasinë e shitur të polietilenit prej 99,732 kg, me një diferencë prej 3,204 kg polietilen të deklaruar në shitje por të pa deklaruar si dalje nga magazina me një cmim mesatar shitjeje prej 188.22 lekë/kg. Nga ana e inspektorit të kontrollit, nuk është analizuar kjo diferencë, por është dalë në përfundimin se nga lëvizja materiale e lëndës së parë polietilen nuk ka diferenca materiale.

Diferencat e mësipërme në shumën prej 603,062 lekë (3,204 kg * 188.22 lekë/kg), nuk janë trajtuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, neni 124 *Perlllogaritjet sipas përcaktimit të mësipërm janë:*

Detyrimi për TVSH-në $603,602 * 20\% = 120,612$ lekë.

Gjobë 100% $120,612 = 120,612$ lekë.

Detyrimi për Tatim Fitimin $603,602 * 15\% = 90,540$ lekë.

Gjobë 100% $90,540 = 90,540$ lekë.

Efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit vlerësohet paraprakisht se është në shumën 422,304 lekë.

Nga verifikimi i llogarisë shpenzime amortizimi për periudhën 2017 rezulton se subjekti ka amortizuar aktivet materiale nën normën e lejuar për efekte fiskale në kundërshtim ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ” Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 22, pika 3, pika 5.

3. *Kostot e blerjes ose të ndërtimit, kostot e përmirësimit, të rinovimit e të rikonstruksionit të ndërtesave, të konstruksioneve dhe makinerive e pajisjeve me afat të gjatë shërbimi, amortizohen veçmas, me vlerën e mbetur, me 5 për qind.”*

5. *Dy kategoritë e mëposhtme të aktiveve amortizohen me metodën e vlerës së mbetur, në bazë të një sistemi grupimi, me përqindje si më poshtë:*

a) *Kompjuterë, sisteme informacioni, produkte “software” dhe pajisje të ruajtjes së të dhënave me 25 për qind.*

b) *Të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë me 20 për qind. Në rastin kur vlera e mbetur e aktivitetit në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 10 për qind e kostos historike të këtij aktivi, atëherë kjo vlerë e mbetur do të njihet tërësisht si shpenzim i zbritshëm i periudhës tatimore.*

Tabela nr. Llogaritja e amortizimit viti 2017

(në lekë)

LLOGARITJA E AMORTIZIMIT A.A.M VITI 2017

N r	Emërtimi	Vlera Fillestare	Amortizim i progresiv	Vlera neto që llog amortizim i	Amortizim i për vitin 2017 Bilanc	Amortizim i	Amortizimi ligji 8438 datë 28.12.1998	Diferenca
1	MAKIN PRODH.F.BUIQESIE	5,353,985	1,345,795	4,008,190	90,000	20%	801,638	711,638
2	MAKINERI-eksud.4030	2,464,000	558,504	1,905,496	35,000	20%	381,099	346,099
3	MAKIN EKSDER TECCM .40-PRILL	1,402,130	0	1,402,130	45,000	20%	280,426	235,426
4	TAVOLINA PUNE	71,835	21,070	50,765	4,000	20%	10,153	6,153
5	MJET TRASPORTI AUT AA817PP SHK.	1,254,780	0	1,254,780	30,000	20%	250,956	220,956
	SHUMA	10,546,730	1,925,369	8,621,361	204,000		1,724,272	1,520,272

Për vitin 2017, rezulton se subjekti nuk ka pasqyruar shpenzimet për amortizimin e aktiveve materiale në shumën 1,520,272 lekë, e cila duke u indeksuar me normën e fitimit 1.2% të shoqërisë për periudhën 2017 shkon në vlerën 1,538,515 lekë.

Në zbatim të ligjit 9920 datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, germa “b”, neni 72, germa “a” dhe neni 115, pika 1 “Plotësim i pasaktë i deklarates tatimore”, ku citohet “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.”, janë llogaritur detyrimet përkatëse.

Tatim Fitimi 1,538,515 x 15 % = 230,777 lekë
 Gjobe TF..... 230,777 lekë x 0.06% x 365 dite = 50,540 lekë
 TVSH 1,538,515 x 20 % = 307,703 lekë
 Gjobe TVSH 307,703 lekë x 0.06% x 365 dite = 67,387 lekë
Shuma..... = 656,407 lekë

2. Subjekti: B... SHPK NIPT: K...K, Aktiviteti: Hotele dhe struktura të ngjashme

Inspektori i kontrollit D.D, përgjegjës kontrolli D.XH, Drejtor Kontrolli D.XH, Drejtor Rajonal D.T.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH 06/2019 deri me 12/2020

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

Saktësimi i kërkesës për Rimbursim të tatimpaguesit “B...” SHPK në DPT. me shkresën nr.3819/2 datë 09.03.2021 protokolluar në DRT.-Durrës me nr.3352 datë 18.03.2021 për periudhën tatimore Qershor 2019– Dhjetor 2020, lindur nga blerjet e materialeve me qëllim realizimin e rikonstruksionit të godinës së hotelit. Pas kontrollit tatimpaguesit *i është njohur nga ana e kontrollit si TVSH e rimbursueshme vlera e saktësuar shuma prej 10,748,989 lekësh, (mbasi zbritet nga teprica kreditore vlerë e zbuluar nga kontrolli prej 157,079 lekë).*

Nga ana e grupit të auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts dhe në dosjet e kontrollit ku ka rezultuar se:

Ndodhet bashkëlidhur certifikata e pronësisë për numrin e pasurisë 59/25 e llojit truall 600m² dhe ndërtëse me sipërfaqe 329 m² me pronar subjektin “B... SHPK”. Kjo certifikatë është rregjistruar në datën 10.10.2019.

Në faqen nr 1 të Raportit të Kontrollit nga ana e inspektorit është cituar se: *“Përgjatë periudhës shtator 2019 deri në dhjetor 2020 hoteli dhe restoranti kanë qenë objekt shtese kati dhe rikostruktimi. Për këtë ndërtim subjekti ka marrë leje ndërtimi pranë Bashkisë Durrës”*

Nga ana e inspektorit nuk është cilësuar as numri i lejes as data, gjithashtu nga verifikimi i dosjes së kontrollit tërhequr nga arkiva e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës nga grupi i auditimit, leja e ndërtimit nuk ndodhet bashkëlidhur dosjes. Nga sa dokumentuar në raportin e kontrollit nga ana e inspektorit të kontrollit rezulton se ndërtimi ka filluar në shtator 2019, pra një muaj para pajisjes me certifikatë pronësie të subjektit tatimpagues.

Referuar informacionit të dërguar nga ana e inspektorit me observacionin nr 30/7 datë 03.03.2023, grupi i auditimit pasi analizoi dokumentacionin e paraqitur sqaron se leja e ndërtimit e paraqitur e lëshuar nga Bashkia Durrës me nr.575 datë 23.07.2019 është në emër të një individi dhe jo në emër të shoqërisë “B... SHPK” e cila ka kërkuar rimbursimin. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.6, datë 30.01.2015 *“Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 20 “Rregulla të përgjithshme”, pikës 4, ku citohet: “Në rastin kur ndërtohet një objekt prej një personi të tatueshëm që ndërton sipas porosisë së një personi tjetër të tatueshëm, një objekt për qëllime të kryerjes së veprimtarisë ekonomike së tij ekonomike, mund të ndeshemi me dy situata: a) Objekti që do të ndërtohet do të shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm; b) Objekti që do të ndërtohet do të shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm. Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të tatueshme, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSH-së të parashikuara në kapitullin X të ligjit, i lind e drejta e zbritjes së TVSH-në së paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim do të përdoret për një veprimtari të tatueshme me TVSH, për pasojë bazuar në parimin e neutralitetit të TVSH-së do të shërbejë një veprimtarie nga e cila lindin pagesa të TVSH-së”. Referuar bazës ligjore të siëprcitur nga ana e grupit të auditimit gjatë shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se në lejen e ndërtimit të miratuar nga ana e Bashkisë Durrës, është përcaktuar se leja e ndërtimit i referohet zhvilluesit të objektit si person i cili ka aplikuar me*

kartë identiteti, fakt i cili tregon në mënyrë të qartë se kemi të bëjmë me një individ i cili ka përfituar lejen e ndërtimit dhe jo me një subjekt të tatueshëm. Sqarojmë se individit dhe subjektit i tatueshëm “B... SHPK” janë dy entitete juridikisht të ndryshme, dhe për rrjedhojë me të drejta dhe detyrime tatimore të ndryshme nga njëra tjetra. Në këtë kuptim individit nuk mund të jetë në asnjë moment person i tatueshëm për efekt të TVSH-së dhe ti lind e drejta e rimbursimit të saj. Nga ana e inspektorit nuk është vepruar në përputhje me legjislacionin tatimor duke mos analizuar në asnjë rast në raportin e kontrollit dhe duke mos cituar lejen e ndërtimit. Gjithashtu nuk është verifikuar që në fazën e parë të kontrollit të dhënat e lejes së ndërtimit dhe ekzistenca e kushtit nëse kemi të bëjmë me një person të tatueshëm ose jo.

Gjithashtu nuk ka një analizë të detajuar të situacioneve pjesore dhe përfundimtare për punimet e ndërtimit, si dhe nuk është verifikuar leja e ndërtimit, preventivi i punimeve për të faktuar kreditimin e TVSH –së së lindur nga blerjet e materialeve me qëllim realizimin e rikonstruksionit të godinës.

Për rrjedhojë inspektori i kontrollit duhet të kishte vepruar konform përcaktimeve të Manualit të Kontrollit Tatimor, kapitulli VII, Udhëzimit nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 20 “Rregulla të përgjithshme”, pikës 4 dhe pikës 8 dhe *Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhërin nr.192 datë 12.08.2020, neni 59* “Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit në Vend”, për të analizuar ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e të drejtës së kreditimit të TVSH-së, së investimit të realizuar nga subjekti.

Si përfundim për rimbursimin në vlerën 10,748,989 lekë të konfirmuar nga inspektori në raportin e kontrollit, bazuar në informacionet e paraqitura në dosjen e kontrollit, subjektit i lindin detyrime në zbatim të *ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 115, pika 3 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, ku përcaktohet se: “Deklarim i pasaktë konsiderohet edhe rasti kur, si rezultat i një kontrolli tatimor, bëhet rivlerësim në ulje i tepricës kreditore të tatimpaguesit. Në këtë rast tatimpaguesi penalizohet me gjobë 20% të diferencës ndërmjet tepricës kreditore të deklaruar me tepricën kreditore që duhej dekluar”.*

Nga grupi i auditimit janë llogaritur detyrimet përkatëse:

Shuma e kërkuar për rimbursim: 10,748,989 lekë

Gjobë 20%: 2,149,797 lekë

Total Detyrimi: 12,898,786 lekë

Vlerësohet paraprakisht se në total efekti financiar në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është 12,898,786 lekë

3. Subjekti: T.. SHPK, NIPT: L...K, Aktiviteti: Tregti me shumicë jo e specializuar
Inspektori i kontrollit M.K, përgjegjës kontrolli D.XH, Drejtor Kontrolli D.XH, Drejtor Rajonal D.T.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

TVSH 07/2016-09/2020,

Tatim Fitimi 2016-2019,

Sigurimet Shoqerore dhe shendetsore 07/2016-09/2020,

TAP 07/2016-09/2020.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se, në zërin e bilancit të vitit 2017 “Debitorë, kreditorë të tjerë” janë rregjistruar detyrime ndaj ortakëve në vlerën 13,052,933 lekë, në vitin 2018 në vlerën 20,656,518 lekë kjo me një rritje nga viti paraardhës në shumën 7,603,585 lekë, në vitin 2019 në vlerën 79,115,759 lekë kjo me një rritje nga viti paraardhës në shumën 58,459,241 lekë, të cilat nuk janë trajtuar dhe analizuar në raport kontrollin tatimor. Në asnjë prej rasteve të mësipërme të haumarrjes nuk janë cilësuar institucionet financiare (banka etj.), apo huadhënës, kontratat e kredisë apo huadhënies, aktet noteriale, termat e referencës së kredive, plani i amortizimit etj., në kundërshtim me kërkesat e programit të kontrollit ku cilësohet se: “Verifikimi i llogarisë së ortakut dhe detyrimit ndaj të tretëve”.

Gjithashtu, këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF nr. 16, datë 16.02.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5 “Raportimi i aktivitetit të dyshimtë (RAD)”, pika 1 dhe 2, ku cilësohet: “1. Organet tatimore i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit. 2. Nëse zbulohet një transaksion i dyshimtë, atëherë duhet dërguar një raport tek autoriteti përgjegjës për aktivitetin e dyshimtë (sipas shtojcave në anekset II dhe III për 4 formularin dhe instruksionet bashkëlidhur, të cilat janë pjesë e këtij udhëzimi)”.

4. Subjekti K...M SHPK, me NIPT: L...Q, Aktiviteti: Tregti me shumicë jo e specializuar. Inspektori i kontrollit Sh.K, përgjegjës kontrolli D.XH, Drejtor Kontrolli D.XH, Drejtor Rajonal D.T.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH 07/2020-06/2022.

-Tatim Fitimi vitit 2020-2021.

-Kontributet e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetësore 07/2020-06/2022.

- Kontribute të tjera nga 07/2020-06/2022.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

Nga analiza e kryer nga ana e inspektorit të kontrollit, për shitjet e realizuara sipas klientëve dhe llojit të produktit për vitin 2020 paraqiten si më poshtë:

Furnitori	Pershkrimi	Kosto Blerje	Shitje VL e Tatueshme
G.IS. S.R.L	KOKE TERHEQESE E PERDORUR TIP MAN NAFTE	907,160	718,667
CENTRO MACHINE SRL	ESKAVATOR I PERDORUR ME GOMA	1,308,650	1,035,000
ROCCA MAR S.R.L	ESKAVATOR ME ZINXHIRE CAT 318 B	1,708,175	825,333
SABBIE DEL PO SRL	KAMION IVECO MAGIRUS	1,545,665	1,085,000
Total		5,469,650	3,664,000

Nga analiza e koston së plotë për artikujt e sipërcituar sipas tabelës së ndërtuar nga inspektori i kontrollit konstatohet se shoqëria ka shitur nën kosto.

Kosto e blerjes së mallrave është 5,469,650 lekë, ndërkohë vlera e shitjes është 3,664,000 lekë.

Në zbatim të ligjit 9920 datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ,neni 71, germa “b”, neni 72,germa “a” dhe neni 115, pika 1 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, ku citohet “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.”.

Nga grupi i auditimit janë llogaritur detyrimet përkatëse.
 Kosto 5,469,650 lekë * 10% (vlerë të shtuar) = 6,016,615 lekë
 Diferenca 6,016,615 lekë - 3,664,000 lekë = 2,352,615 lekë
Detyrimi për TVSH-në 2,352,615 * 20% = 470,523 lekë
Gjobë 470,523 x 0.06% x 365 ditë = 103,044 lekë.
Detyrimi për Tatim Fitimin 2,352,615 * 15% = 352,892 lekë
Gjobë 148,568 * 0.06% x 365 ditë = 77,283 lekë.

Vlerësohet paraprakisht se efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 1,003,742 lekë.

5. Subjekti: D... SHPK, NIPT: K...W Aktiviteti: Konsulencë dhe administrim në fushën e biznesit dhe atë financiare. Tregëti të vlerave mobiliare dhe imobiliare, aktivitete marketingu. Tregëtim me pakice produktesh ushqimore. Shërbime funerale.

Inspektori i kontrollit A.D, përgjegjës kontrolli D.XH, Drejtor Kontrolli D.XH, Drejtor Rajonal D.T.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH 03/2020-02/2022.

-Tatim Fitimi vitit 2020-2021.

-Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore 03/2020-02/2022.

- Kontribute të tjera nga 03/2020-02/2022.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

Subjekti ka deklaruar shpenzime të cilat duhet të klasifikohen si shpenzime të pazbritshme pasi nuk i shërbejnë aktivitetit për blerjen e një autoveture paraqitur si më poshtë.

NR	Furnitori	Rrethi	Nipt	Vlerë	lloji i mallit
1	A..... 2021	DURRES	L.....I	2,750,559	blerje autoveture

Shpenzime të panjohura për blerjen e autoveturës bazuar në ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar nën 21 Shpenzime të panjohura, pika i) shpenzimet e konsumit personal, të përcaktuara nga Ministri i Financave;

Detyrimi për Tatim Fitimin 2,750,559 * 15% = 412,583 lekë

Gjobë 412,583 * 0.06% x 365 ditë = 90,355 lekë.

Konstatohet se në zërin n). shpenzimet për paga shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, nuk janë kaluar nëpërmjet sistemit bankar.

Shpenzime për paga shpërblime për vitin 2020 janë në shumën 2,087,208 lekë.

Shpenzime për paga shpërblime për vitin 2021 janë në shumën 3,247,509 lekë.

Total shpenzime për pagat janë në shumën 5,334,717 lekë.

Detyrimi për Tatim Fitimin 5,334,717 * 15% = 800,207 lekë

Gjobë 412,583 * 0.06% x 365 ditë = 172,844 lekë.

Pra, vlerësohen paraprakisht 1,475 mijë lekë detyrime tatimore, nga të cilat 1,213 mijë lekë për Tatim Fitimin dhe 264 mijë lekë gjobë tatimore.

6. Subjekti: P... F.. SHPK, NIPT: L...

Aktiviteti: Hotele dhe struktura të ngjajshme

Inspektori i kontrollit F.GJ, përgjegjës kontrolli D.XH, Drejtor Kontrolli D.XH, Drejtor Rajonal D.T.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH 01/12/2019 - 30/09/2022

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së;
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë;
- Është kryer zberthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së;
- Verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të TVSH-së dhe përputhja e tyre me të dhënat e librave të blerjes dhe shitjes;
- Janë kontrolluar dhe verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes dhe rakordimi i tyre me FDP;
- Janë kryer analizat financiare e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë si llogaritja e kostos së plotë për çdo llojë produkti, krahasimi me çmimet e deklaruara nga subjekti dhe çmimet reale të tregut;
- Është bërë inventarizimi fizik i faturave të shitjes me numër serie (*blloqet*) në momentin e kontrollit dhe është bërë krahasimi me numrat serial të tërhequr nga DRT. Durrës me numrat serial të përdorur (*të regjistruar në librin e shitjeve*);
- Është kryer lëvizja materialeve dhe mallrave për periudhat përkatëse;
- Është përcaktuar prejardhja e tepricës së TVSH-së kreditore në fund të periudhës;
- Është kryer analiza e TVSH-së, llogaritja e normës së TVSH-së dhe është kryer krahasimi me normën mesatare të subjekteve të ngjashme;
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti;
- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria dhe është mbajtur akt-konstatim me përfaqësuesin ligjorë të subjektit.

7. Subjekti:“A...” SHPK, NIPT: K....J.

Aktiviteti: Dhënie me qira pa shofer, të mjeteve të transportit, autovetura, makinave, furgonëve, për llogari të palëve të treta dhe për llogari të vet, në Shqipëri dhe jashtë saj.

Inspektori i kontrollit D.D, përgjegjës kontrolli D.XH, Drejtor Kontrolli D.XH, Drejtor Rajonal D.T.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

TVSH 10/2019-09/2021

Tatim Fitimi 2019-2020

Sigurimet Shoqërore dhe shendetsore 10/2019-09/2021

TAP 10/2019-09/2021.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

-Në Zërin "Konsum për vete" të vitit 2019 janë rregjistruar bileta udhëtimi në vlerën 1,107,833 lekë janë përfshirë shpenzimet e bëra për udhëtime për qëllime të biznesit, për të hapur treg të ri dhe për takime me furnitorë për furnizime. Është përfshirë në të edhe udhëtimi për pjesmarrje në panairin e organizuar nga H.. I. Gjermani.Furnitori i këtij shërbimi është Shoqëria L.I.me NUIS K..L.

Kjo në kundërshtim me ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Neni 21 Shpenzime të panjohura pika h) shpenzimet për përfaqësim dhe shpenzimet për pritje-përcjellje të cilat tejkalojnë shumën 0,3 për qind të qarkullimit vjetor;Për tatimpaguesit eksportues, përjashtuar prodhuesit me material porositi, të cilët në 3 vitet e fundit kanë realizuar mbi 70 për qind të të ardhurave nga eksporti, shpenzimet e dokumentuara, të kryera për

pjesëmarrje, prezantim në panairë apo ekspozita jashtë vendit, njihen si shpenzime të zbritshme deri në masën 3 për qind të qarkullimit vjetor.

Qarkullimi	Lejuar 0.3 %	Shpenzuar	Diferenca
107,922,675	323,768	1,107,833	784,065

Detyrimi për Tatim Fitimin 784,065 * 15% = 117,609 lekë

Gjobë 117,609 * 0.06% x 365 ditë = 25,756 lekë.

Vlerësohet paraprakisht se efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 143,365 lekë.

8. Subjekti :“V..T..” SHPK,me NIPT: L...M.

Aktiviteti: Transportues i udhëtarëve në sherbimet Kombëtare dhe Ndërkombëtar.

Inspektori i kontrollit N.D, përgjegjës kontrolli D.XH, Drejtor Kontrolli D.XH, Drejtor Rajonal D.T.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: 10/2020-09/2021

Nga auditimi i dosjes së kontrollit u konstatua se:

Nuk janë analizuar normativat e harxhimit të karburantit sipas km të përshkruara dhe normativave për 100/km ato analizohen me kontrollin për tatimin mbi fitimin.

Nuk është kryer analiza e harxhimit të karburantit dhe bilanci material për naftën e përdorur për të gjithë periudhën e kontrollit sipas km të përshkruara dhe normativave për 100/km sipas kartës teknologjike të mjeteve të kompanisë, harxhimi i karburantit në raport të rrugëve të kryera nga ana e subjektit për periudhën e kontrolluar.

- Tabela e blerje importit të investimit me TVSH 20 % sipas tabelës së mëposhtëme:

NR	FURNITORI	RRETHI	NIPTI	VLERA	PERSHKRIMI I BLERJES
1	AUTOMOBILE	GJERMANI		2,173,723	AUTOVETURE E PERDORUR
TOTALI				2,173,723	

Subjekti ka kryer blerje të cilat nuk i sherbejnë aktivitetit për të cilat nuk duhet të kreditohej TVSH në vlerën 435,545 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar)”, neni 74, pika 1 c.

Për veprimet e mësipërme në bazë të ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008, neni 115, për këtë diferencë llogariten edhe penalitetet si më poshtë:

Për vitin 2021: 2,173,723 lekë

TVSH : 435,545 lekë

Gjobë TVSH (20%): 87,109 lekë

Total Detyrimi për 2021: 522,654 lekë

Pra, vlerësohen paraprakisht 522,654 mijë lekë detyrime tatimore, nga të cilat 435 mijë lekë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe 87 mijë lekë gjobë tatimore.

Vlerësohet paraprakisht se efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 522,654 lekë.

9. Subjekti: “G..K..” SHPK, NIPT: L...U.

Aktiviteti: Konsulencë dhe administrim në fushën e biznesit dhe atë financiarë. Tregëti të vlerave mobiliare dhe imobiliare, aktivitete marketingu. Tregëtim me pakicë produkte ushqimore. Shërbime funerale.

Inspektori i kontrollit A.M, përgjegjës kontrolli D.XH, Drejtor Kontrolli D.XH, Drejtor Rajonal D.T.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH 01/2019 – 05/2022.

-Tatim Fitimi vitit 2020-2021.

-Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore 01/2019 – 05/2022.

- Kontribute të tjera nga 01/2019 – 05/2022.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezultoi se:

Nga kontrolli mbi tatim fitimin për vitin 2021 Shpenzime qera janë deklaruar 280,000 lekë nga 770,000 lekë e cila është vlera e kontratës.

Për këtë diferencë llogariten edhe penalitetet si më poshtë:

Për vitin 2021: 490,000 lekë

TF 15%: 73,500 lekë

Gjobë TF (21.9%): 15,876 lekë

Total Detyrimi për 2021: 89,376 lekë

Për vitin 2019 Kreditore të tjerë në vlerën 3,400,000 lekë përfshijnë vlerën e kontributit të ortakut me vendim asambleje për likuiditetet në arkë, për pagesa dhe shpenzime rritjen e fondit të kompanisë.

Për vitin 2020 kreditorë të tjerë janë në vlerë 5,550,000 lekë, ku nuk janë analizuar dhe nuk është përgatitur informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumën të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e *ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1, si dhe UMF nr. 16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.*

Vlerësohet paraprakisht se efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 89,376 lekë.

10. Subjekti: A....SHPK, NIPT: K...J.

Aktiviteti: Prodhim i dyerve dhe dritareve duro-alumin.

Inspektori i kontrollit E.SH, përgjegjës kontrolli D.XH, Drejtor Kontrolli D.XH, Drejtor Rajonal D.T.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH 2020/02-2022/01.

-Tatim Fitimi vitet 2019-2021.

-Sig Shoq e shëndetësore 2020/02-2022/01.

-Te tjera 2020/02-2022/01.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezultoi se:

Për vitin 2020 në zërin bleje nga furnitore vendas për investime është njohur si shpenzim për blerje e një autoveture Toyota në vlerën e tatueshme 4,341,800 lekë dhe TVSH në vlerën 868,360 lekë.

Furnitori	NIPT	Lloji blerjes	Investime vendi	
			Vlere e tatueshme	TVSH
A... G....	L.....D	Blerje mjete Toyota	4,341,800	868,360

Kjo autoveturë nuk i shërben aktivitetit të subjektit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998, Për Tatimin Mbi Të Ardhurat (i ndryshuar), Neni 21 Shpenzime të panjohura, pika i) shpenzimet e konsumit personal si dhe në kundërshtim me ligjin nr 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH i ndryshuar neni 74 pika 1 germa c.ky mjet nuk i shërben aktivitetit direkt por është për përdorim vetjak për nevojat e përfaqësuesit ligjor të subjektit dhe si i tillë nuk duhej kredituar TVSH-ja.

Për veprimet e mësipërme në bazë të ligjit nr.9920 datë 18.05.2008, neni 115 “*Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.*

Për këtë diferencë llogariten edhe penaltetet si më poshtë:

Për vitin 2020:	4,341,800 lekë
TF 15%:	651,270 lekë
Gjobë TF (21.9%):	142,628 lekë
TVSH :	868,360 lekë
Gjobë TVSH (20%):	190,170 lekë
Total Detyrimi për 2020:	1,852,428 lekë

Vlerësohet paraprakisht se efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 1,852,429 lekë

11. Subjekti: “T..I.” SHPK me NIPT-K...V,
Kontrolluar nga inspektori i Sektorit të Kontrollit në Vend z. Sh.P.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 04/2020-03/2022
- Për TF periudha tatimore nga: 2020-2021
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore - periudha tatimore nga: 04/2020-03/2022
- Të tjera periudha tatimore nga: 04/2020-03/2022

Nga auditimi i dosjes së kontrollit u konstatua se:

- Është mbajtur procesverbal i fuqisë punëtore ku është bërë verifikimi i fuqisë punëtore .
- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Është kryer lëvizja materialeve dhe mallrave për periudhat përkatëse.
- Është kryer zberthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së.
- Verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të TVSH-së dhe përputhja e tyre me të dhënat e librave të blerjes dhe shitjes.
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i ambienteve ku ushtron veprimtarinë subjekti.
- Është kryer verifikimi i të ardhurave të deklaruara në pasqyrat financiare dhe janë krahasuar me të dhënat e deklaruara në FDP.

Nga auditimi ka rezultuar se:

Subjekti operon në fushën e përpunimit të materialeve plastike në formë primare, ku kryen importe të lëndës së parë nga jashtë (e tipit lëndë e parë plastike PE dhe lëndë e parë plastike PVC). Nga të dhënat e paraqitura në RPK të mbajtur nga Inspektori i Kontrollit citohet se për prodhimin e gatshëm përdoret lënda e parë e marrë nga magazina e cila futet në proces si dhe

shoqëria ka hartuar skedën teknologjike sipas të cilës humbjet teknologjike llogariten 7%, por kartelat teknologjike janë të pa depozituara në organet tatimore, për rrjedhojë nisur nga fakti që mungojnë kartat teknologjike humbjet e deklaruar nga subjekti janë të pa dokumentuara.

Në faqen nr.13 të RPK, është analizuar nga ana e Inspektorit bilanci material i shoqërisë për vitin 2020, 2021 dhe periudhën janar – mars 2022, për lëndët e para PE/kg, PVC/kg, Karbonat/kg, ngjyrues dhe stabilizant.

Nga verifikimi i bilancit material për vitin 2021 rezulton se për lëndën e parë PE/kg gjëndja në fund të inventarit paraqitet në vlerën 50,326,323 lekë me kosto/ njësi 84 lekë/kg dhe sasi 602,278 kg.

Artikulli	Gjëndje 01.01.2020			Hyrjet 2020			Daljet 2020			Gjëndje 31.12.2020		
	Sasia	Kosto	Vlerë	Sasi	Kosto	Vlerë	Sasi	Kosto	Vlerë	Sasi	Kosto	Vlerë
PE/kg	573,693	134	76,891,271	1,037,780	109	113,180,428	1,212,949	121	146,641,810	398,524	109	43,429,888
	Gjëndje 01.01.2021			Hyrjet 2021			Daljet 20201			Gjëndje 31.12.2021		
	Sasia	Kosto	Vlerë	Sasi	Kosto	Vlerë	Sasi	Kosto	Vlerë	Sasi	Kosto	Vlerë
PE/kg	398,524	109	43,429,888	2,160,215	158	340,378,245	1,956,461	170	333,481,810	602,278	84	50,326,323

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën më sipër rezulton se për vitin 2021 edhe pse sasia e gjendjes së lëndës së parë PE është dyfishuar në raport me vitin 2020 kemi një ulje drastike të koston për njësi prej 84 lekë/kg, për rrjedhojë kemi një situatë të nënvlerësimit të gjendjes kontabël të inventarëve të shoqërisë e cila do të analizohet si më poshtë duke ju referuar për analogji edhe vitit 2020.

Në gjendjen në fund të paraqitur në vitin 2020 kosto për njësi e lëndës së parë PE është 109 lekë/kg e cila vjen si rezultat i metodës FIFO, ku regjistrohet kosto për njësi sipas hyrjes së vitit në këtë rast në vlerën 109 lekë/kg.

Nga analiza e kryer nga ana e Grupit të Auditimit për vitin 2021, në RPK duhej të ishte analizuar nga ana e inspektorit gjendja në fund e lëndës së parë PE si dhe regjistrimi i koston për njësi që është bërë nga ana e shoqërisë. Për rrjedhojë duhej të ishte përdorur pesha specifike midis sasive dhe kosto/njësi në çelje të vitit si dhe kosto/njësi e hyrjeve të vitit, duke kryer regjistrimin e saktë kontabël të kosto/njësi në fund të vitit, konkretisht si më poshtë:

Pesha specifike sasi/kosto për njësi për hyrjet e vitit: sasi hyrje 2,160,215 kg / (sasi çelje 398,524 kg + sasi hyrje 2,160,215 kg) = 0.844 %

Pesha specifike sasi/ kosto për njësi për çeljet e vitit: $1 - 0.844 = 0.155$

Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për hyrjet e vitit: $0.844\% * 158 \text{ lekë/kg} = 133.3915 \text{ lekë/kg}$

Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për çeljet e vitit: $0.156\% * 109 \text{ lekë/kg} = 16.97677 \text{ lekë/kg}$

Shuma e të dyjave do të duhej të ishte regjistrimi i kosto/njësi në fund të vitit ushtrimor: $(133.39 \text{ lekë/kg} + 16.98 \text{ lekë/kg}) = 150.37 \text{ lekë/kg}$

Për sa më sipër nga ana e subjektit si dhe në RPK kosto/njësi në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 84 lekë/kg e pa analizuar dhe e pa argumentuar, për rrjedhojë kemi një diferencë të kosto/njësi në vlerën $(150.37 \text{ lekë/kg} - 84 \text{ lekë/kg}) = 66.3 \text{ lekë/kg}$

Nga analiza e kryer më sipër rezulton se kemi një nënvlerësim të inventarit kontabël në fund të vitit 2021 për lëndën e parë plastike PE me diferencë në cmim prej 66.3 lekë/kg, ku llogariten edhe detyrimet si më poshtë:

Sipas RPK, gjendja në 31.12.2021 për lëndë e parë PE/kg

Sasi 602,278 kg * 84 lekë/kg = 50,326,323 lekë, vlera kontabël

Sipas Grupit të Auditimit

Sasi 602,278 kg * 150.37 lekë/kg = 90,563,484 lekë, vlera kontabël e korrektuar

Nga diferenca e konstatuar si pasojë e nënvlerësimit të inventarëve të shoqërisë është kryer nga Grupi i Auditimit rikarakterizimi i situatës, bazuar në Ligjin 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”, germa (b) ku cilësohet se: “*Administrata tatimore ka të drejtë të përdorë mënyra alternative vlerësimi të detyrimit tatimor të tatimpaguesit dhe të nxjerrë një vlerësim, në rastet kur: b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara*”, si dhe bazuar në nenin 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit” është kryer rivlerësimi sipas të cilit janë përlllogaritur detyrimet dhe gjobat e mësipërme në zbatim të nenit 115 “*Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore*”, pika 1 ku cilësohet: “*Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike*”.

Diferenca si pasojë e nënvlerësimit të inventarit rezulton në shumën (90,563,484 lekë – 50,326,323 lekë) = **40,237,161 lekë**

Për këtë diferencë llogariten edhe penalitetet si më poshtë:

Për vitin 2021:	40,237,161 lekë
TF 15%:	6,035,574 lekë
Gjobë TF (21.9%):	1,321,791 lekë
TVSH 20%:	8,047,432 lekë
Gjobë TVSH (21.9%):	1,762,388 lekë
Total Detyrimi për 2021:	17,167,185 lekë

Nga vlerësimi paraprak konstatohet se në total efekti financiar në të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit nga ky subjekt është: 17,167,185 lekë

12. “H...M..” SHPK me NIPT-K.....V, kontrolluar nga inspektori i Sektorit të Kontrollit në Vend z.A.D.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 05/2016-04/2021
- Për TF periudha tatimore nga: 2016-2020
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore - periudha tatimore nga: 05/2016-04/2021
- Të tjera periudha tatimore nga: 05/2016-04/2021

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Janë kryer procedurat verifikuese të regjistrimit të shoqërisë, forma juridike dhe kapitali, organizimi funksional.
- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë kryer procedurat verifikuese në lidhje, për tatimin mbi të ardhurat në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria dhe është mbajtur akt-konstatim me përfaqësuesin ligjorë të subjektit.
- Është kryer verifikimi i saktësisë së llogaritjes në zërin paga, sigurime shoqërore dhe likuidimit të detyrimeve mbi sigurimet shoqërore.
- Është bërë verifikimi i zbatimit të ligjit dhe standarteve të kontabilitetit.
- Është kryer verifikimi i të ardhurave të deklaruara në pasqyrat financiare dhe janë krahasuar me të dhënat e deklaruara në FDP.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.

- Është bërë përcaktimi i kostos së blerjes dhe kostos së plotë për çdo artikull dhe është kryer krahasimi me çmimet e shitjes.
- Është bërë inventarizimi fizik i faturave të shitjes me numër serie (*blloqet*) në momentin e kontrollit dhe është bërë krahasimi me numrat serial të tërhequr nga DRT. Durrës me numrat serial të përdorur (*të regjistruar në librin e shitjeve*).
- Janë kontrolluar dhe verifikuar kasat fiskale të subjektit

Nga kontrolli mbi tatim fitimin (2016-2020)

Pasivi i Bilancit për periudhën 2016-2020

Përshkrimi	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Detyrime afatgjata					
Të tjera të pagueshme	31,434,223	42,828,122	42,596,397	45,596,397	54,024,027

Referuar të dhënave të pasqyrave të pozicionit financiar për periudhën 2016-2020, ka rezultuar se subjekti paraqitet me afatgjata kundrejt të tretë (hua).

- Detyrimet afatgjata “Hua” të krijuara në vitin 2016 në shumën 31,434,223 lekë, janë rritur në vitin 2017 në shumën 42,828,122 lekë si dhe në fund të vitit 2020 rezultojnë në shumën 54,024,027 lekë.
- Nga ana e inspektorit të kontrollit në RPK, nuk është cilësuar dhe analizuar burimi i këtyre të ardhurave dhe të dhëna të tjera, pasi nuk është analizuar dhe shpjeguar kjo shumë, por është cituar vetëm se: *“Ne rubriken “Detyrime afatgjata”, llogarinë “Të tjera të pagueshme” në 31.12.2020 rezulton me në shumën 54,024,027 lekë, shuma nga data 31.12.2019 është 42,596,397 lekë. Për këtë shumë të transferuar në llogarinë e subjektit janë hartuar kontrata huadhënie midis shoqërisë H...M.. SHPK dhe individëve (ortakët)”*.
- Në asnjë prej rasteve të mësipërme të haumarrjes nuk janë cilësuar institucionet financiare (banka etj.), apo huadhënës, kontratat e kredisë apo huadhënies, aktet noteriale, termat e referencës së kredive, plani i amortizimit etj., në kundërshtim me kërkesat e programit të kontrollit ku cilësohet se: *“Shqyrtimi i rregullsisë të dokumentave të marrëveshjeve të kryera midis shoqërisë dhe bankës në fushën e kreditit; Fakti nëse huatë bankare nuk janë rregjistruar në llogarinë 163 “Huara nga bankat dhe institucionet e kreditit” por figurojnë në llogarinë 51 “Banka, institucione financiare e të ngjashme”; Respektimi i ndarjes së ushtrimeve përsa i takon kontabilizimit të interesave rrjedhëse për t’u paguar; Kontrolli i afateve të pagesës së këstëve prej shoqërisë; Për kreditë bankare që shoqërohen me garanci të shihet se në çpërpjestim është garancia në raport me totalin e aktiveve të shoqërisë”*.

Gjithashtu, këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF nr. 16, datë 16.02.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5 “Raportimi i aktivitetit të dyshimtë (RAD)”, pika 1 dhe 2.

13. “A... I...” SHPK me NIPT-L....M, kontrolluar nga inspektori i Sektorit të Kontrollit në Vend z.K.Rr.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 03/2016-02/2021
- Për TF periudha tatimore nga: 2016-2020
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore - periudha tatimore nga: 03/2016-02/2021
- Të tjera periudha tatimore nga: 03/2016-02/2021

Nga auditimi i dosjes së kontrollit u konstatua se:

Subjekti operon në fushën e import dhe eksport të materialeve dhe pajisjeve të ndryshme elektrike si dhe materialeve industrial tregtimin e tyre me shumicë dhe pakicë brenda dhe jashtë vendit. Nga të dhënat e paraqitura në RPK të mbajtur nga inspektori i kontrollit ka kontrolluar periudhën e tatim fitimit për vitet 2016 – 2020.

Në faqen nr.7 të RPK të mbajtur nga ana e inspektorit është hartuar bilanci material i vitit ushtrimor 2016 ku janë cilësuar artikujt e shoqërisë, gjendje në fillim, hyrjet e vitit, daljet e vitit si dhe gjendja në fund të periudhës me sasi, kosto/njësi dhe vlerat kontabël.

Nga auditimi i kryer nga Grupit i Auditimit janë verifikuar të dhënat e paraqitura si dhe lëvizjet në bilancin material të hartuar nga ana e inspektorit, ku kanë rezultuar parregullsi si më poshtë:

Bilanci material 01/2016 – 12/2016

Artikulli	Gjendje 01.01.2016			Hyrjet 2016			Daljet 2016			Gjendje 31.12.2016		
	Sasia	Kosto	Vlerë	Sasi	Kosto	Vlerë	Sasi	Kosto	Vlerë	Sasi	Kosto	Vlerë
Transformator	32	156,823	5,018,323	236	167,380	39,501,708	196	154,935	30,367,276	72	196,566	14,152,754

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se artikulli “*transformator tensioni*” me vlerë kontabël prej 14,152,754 lekë përbën peshën kryesore të inventarit kontabël të shoqërisë konkretisht në masën 71%. Për rrjedhojë u krye një analizë e thelluar e bilancit material në lidhje me kartelën inventarit “*Transformator tensioni*”.

Nga auditimi rezulton se për këtë artikull është kryer dalje gjatë vitit ushtrimor nga ana e shoqërisë për 196 copë me cmim 154,935 lekë dhe vlerë kontabël 30,367,276 lekë. Çmimi i aplikuar në dalje paraqitur në bilancin material është dukshëm më i ulët se kosto/njësi paraqitur të hyrjet e vitit prej 167,380 lekë si dhe kosto/njësi paraqitur të daljet e vitit prej 156,823 lekë.

Nga ana e inspektorit në RPK nuk është kryer një analizë e thelluar dhe e qartë mbi aplikimin e shoqërisë të çmimit për daljet e vitit të paraqitur në bilancin material të shoqërisë, ku rezulton më i ulët për artikullin kryesor të inventarit kontabël.

Për rrjedhojë nga ana e inspektorit duhej të ishte kryer një test analitik mbi çmimet e aplikuara nga shoqëria nëse janë paraqitur saktë dhe të mos jenë nën kosto.

Nga ana e Grupit të Auditimit është përdorur metoda FIFO, për të përlllogaritur çmimin që duhej të aplikohet nga subjekti për artikullin “*Transformator tensioni*”, konkretisht si më poshtë:

Diferenca në çmim: Kosto/njësi hyrjet e vitit 167,380 lekë – çmim dalje në Bilanc Material 154,935 lekë = **12,445 lekë**

Marzhi i fitimit për vitin 2016: **23%**

Diferenca e çmimit e rivlerësuar: (12,445 lekë * 23%) = **15,307 lekë**

Diferenca në vlerë: (196 copë * 15,307 lekë/copë) = **3,000,241 lekë**

Inspektori i kontrollit duhet të bënte rivlersimin e të ardhurave në bazë të ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar. Neni 71 E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi Administrata tatimore ka të drejtë të përdorë mënyra alternative vlerësimi të detyrimit tatimor të tatimpaguesit dhe të nxjerrë një vlerësim, në rastet kur:

- c) tatimpaguesi nuk mban ose ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve;
- d) tatimpaguesi nuk vë në dispozicion informacionin e kërkuar dhe dokumente të tjera, të nevojshme, për llogaritjen e detyrimit të tij tatimor;
- dh) tatimpaguesi hyn në transaksione me persona të lidhur jo në bazë të parimit të vlerës së tregut, ose hyn në transaksione pa efekte ekonomike thelbësore.

Për diferencën e konstatuar llogariten penalitetet si më poshtë:

Për vitin 2016: 3,000,241 lekë

TF 15%: 450,036 lekë

Gjobë TF (0.06%/365): 98,558 lekë

TVSH 20%: 600,048 lekë

Gjobë TVSH (0.06%/365): 131,411 lekë

Total Detyrimi për 2016: 1,280,053 lekë

Në faqen nr.14 të RPK të mbajtur nga ana e Inspektorit është hartuar bilanci material i vitit ushtrimor 2017 ku janë cilësuar artikujt e shoqërisë, gjendje në fillim, hyrjet e vitit, daljet e vitit si dhe gjendja në fund të periudhës me sasi të, kosto/njësi dhe vlerat kontabël.

Nga auditimi i kryer nga Grupit i Auditimit janë verifikuar të dhënat e paraqitura si dhe lëvizjet në bilancin material të hartuar nga ana e Inspektorit, ku kanë rezultuar parregullsi si më poshtë:

Bilanci material 01/2017 – 12/2017

Artikulli	Gjendje 01.01.2017			Hyrjet 2017			Daljet 2017			Gjendje 31.12.2017		
	Sasia	Kosto	Vlerë	Sasi	Kosto	Vlerë	Sasi	Kosto	Vlerë	Sasi	Kosto	Vlerë
Transformator	72	196,566	14,152,754	302	142,752	43,111,194	283	162,384	45,384	91	124,277	11,309,207

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se artikulli “*Transformator tensioni*” me vlerë kontabël prej 11,309,207 lekë përbën peshën kryesore të inventarit kontabël të shoqërisë konkretisht në masën 40%. Për rrjedhojë u krye një analizë e thelluar e bilancit material në lidhje me kartelën inventarit “*Transformator tensioni*”.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën më sipër rezulton se për vitin 2017 rezulton se kosto/njësi prej 124,277 lekë është dukshëm më e ulët se kosto/njësi në celje prej 196,566 lekë si dhe kosto/njësi në hyrjet e vitit prej 142/752 lekë, për rrjedhojë kemi një situatë të nënvlerësimit të gjendjes kontabël të inventarëve të shoqërisë.

Nga analiza e kryer nga ana e Grupit të Auditimit për vitin 2017, në RPK duhej të ishte analizuar nga ana e inspektorit gjendja në fund e artikullit “*Transformator tensioni*” si dhe regjistrimi i kostos për njësi që është bërë nga ana e shoqërisë. Për rrjedhojë duhej të ishte përdorur pesha specifike midis sasive dhe kosto/njësi në celje të vitit si dhe kosto/njësi e hyrjeve të vitit, duke kryer regjistrimin e saktë kontabël të kosto/njësi në fund të vitit, konkretisht si më poshtë:

Pesha specifike sasi/kosto për njësi për hyrjet e vitit: $\text{sasi hyrje } 302 / (\text{sasi celje } 72 + \text{sasi hyrje } 302) = 0.81\%$.

Pesha specifike sasi/ kosto për njësi për celjet e vitit: $1 - 0.81 = 0.19\%$.

Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për hyrjet e vitit: $0.81 * 142,752 \text{ lekë/copë} = 115,270 \text{ lekë/copë}$.

Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për celjet e vitit: $0.19 * 196,566 \text{ lekë/copë} = 37,842 \text{ lekë/copë}$.

Shuma e të dyjave do të duhej të ishte regjistrimi i kosto/njësi në fund të vitit ushtrimor: $(115,270 \text{ lekë/copë} + 37,842 \text{ lekë/copë}) = \mathbf{153,112 \text{ lekë/copë}}$.

Për sa më sipër nga ana e subjektit si dhe në RPK kosto/njësi në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 124,277 lekë/copë e pa analizuar dhe e pa argumentuar, për rrjedhojë kemi një diferencë të kosto/njësi në vlerën $(153,112 \text{ lekë/copë} - 124,277 \text{ lekë/copë}) = \mathbf{28,835 \text{ lekë/copë}}$.

Nga analiza e kryer më sipër rezulton se kemi një nënvlerësim të inventarit kontabël në fund të vitit 2017 për artikullin “*Transformator tensioni*” me diferencë në çmim prej 28,835 lekë/copë, ku llogariten edhe detyrimet si më poshtë:

Sipas RPK, gjendja në 31.12.2017 për artikullin Transformator Tensioni.

Sasi 91 copë * 124,277 lekë/copë = 11,309,207 lekë, vlera kontabël.

Sipas Grupit të Auditimit

Sasi 91 copë * 28,835 lekë/copë = 2,623,978 lekë, vlera kontabël e korrektuar.

Nga diferenca e konstatuar si pasojë e nënvlerësimit të inventarëve të shoqërisë është kryer nga Grupi i Auditimit rikarakterizimi i situatës, bazuar në Ligjin 9920/2008 “Për procedurat tatimore

në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”, germa (b) ku cilësohet se: “*Administrata tatimore ka të drejtë të përdorë mënyra alternative vlerësimi të detyrimit tatimor të tatimpaguesit dhe të nxjerrë një vlerësim, në rastet kur: b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara*”, si dhe bazuar në nenin 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit” është kryer rivlerësimi sipas të cilit janë përlllogaritur detyrimet dhe gjobat e mësipërme në zbatim të nenit 115 “*Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore*”, pika 1 ku cilësohet: “*Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike*”.

Diferenca si pasojë e nënvlerësimit të inventarit rezulton në shumën (90,563,484 lekë – 50,326,323 lekë) = **2,623,978 lekë**

Për diferencën e konstatuar llogariten penalitetet si më poshtë:

Për vitin 2017:	2,623,978 lekë
TF 15%:	393,597 lekë
Gjobë TF (21.9%):	86,198 lekë
TVSH 20%:	524,796 lekë
Gjobë TVSH (21.9%):	114,930 lekë
Total Detyrimi për 2017:	1,119,520 lekë

Vlerësohet paraprakisht se në total efekti financiar në të ardhura të munguara nga ky subjekt është: 2,399,573 lekë

14. “M.K” Person Fizik me NIPT-L.....H, kontrolluar nga inspektori i Sektorit të Kontrollit në Vend z.A.D.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

-TVSH 05/2019 deri me 12/2020

Nga verifikimi i dosjes së kontrollit të Personit fizik “M.K” operon në fushën e Hotelerisë dhe Strukturave të ngjashme, ku ka kërkuar rimbursimin e TVSH-së për periudhën 05/2019 – 12/2020 në vlerën 14,059,317 lekë. Nga ana e Grupit të Auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts në lidhje me personin fizik “M.K” ku ka rezultuar se: 1. Leje ndërtimi me nr. 1233, datë 19.06.2019 për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, nga ana e Bashkisë Kavajë, i është dhënë kjo leje ndërtimi për zhvilluesin M.K me **NID/F...H**, të cilit i lejohet ndërtimi i objektit për ndryshim projekti gjatë ndërtimit në objektin Hotel 5 kate + papafingo + bodrum sipas kushteve:

Sipërfaqe e parcelës e zënë nga parkimi: 249.8 m²

Sipërfaqe totale e ndërtimit: 2317.7 m²

Afati i lejes është i vlefshëm për një periudhë 25 mujore nga data e fillimit të punimeve referuar grafikut të punimeve

2. Leje ndërtimi me nr. 1978, datë 12.10.2020 për objektin pishinë në funksion të hotelit, nga ana e Bashkisë Kavajë, i është dhënë kjo leje ndërtimi për zhvilluesin M.K me **NID/F...H**, të cilit i lejohet ndërtimi i pishinës në funksion të hotelit sipas kushteve:

Sipërfaqe e truallit: 500 m²

Sipërfaqe e ndërtimit gjurma: 250 m²

Afati i lejes është i vlefshëm për një periudhë 12 mujore nga data e fillimit të punimeve referuar grafikut të punimeve .

Nga të dhënat e cituara më sipër rezulton se nga lejet e ndërtimit të dhëna nga Bashkia Kavajë janë miratuar punimet për zhvilluesin M.K si individ me NID, dhe jo si person fizik me NIPT, për rrjedhojë zhvilluesit M.K nuk i lind e drejta e kreditimit të TVSH-së për shkak se nuk jemi në kushtet e një personi të tatueshëm. Nga lejet e ndërtimit të miratuara nga ana e Bashkisë Kavajë për të qenë në kushtet e një personi të tatueshëm duhej të ishin në favor të zhvilluesit të paraqitur me NIPT dhe i regjistruar në organet tatimore.

Në RPK, e mbajtur nga Inspektori nuk janë analizuar lejet e ndërtimit si dhe të ishin verifikuar zhvilluesi i miratuar në këto leje ndërtimi nëse është person i tatueshëm dhe më pas të procedohej me kërkesën për rimbursim të paraqitur nga zhvilluesi M.K.

Kreditimi i TVSH i saktësuar nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është në përputhje me Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 20 “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes”, pika 3 “Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim”, ku citohet se: -pika 4.

Për rrjedhojë e gjithë shuma e kërkuar prej 14,059,317 lekë për rimbursim nuk duhej proceduar nga Inspektori në RPK, subjektit i lindin detyrime në zbatim të pikës 3, të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë llogaritur detyrimet përkatëse.

Shuma e kërkuar për rimbursim: 14,059,317 lekë

TVSH 20%: 2,811,863 lekë

Total Detyrimi: 16,871,180 lekë

Nga 40 subjekte të përzgjedhura nga grupi i auditimit, 26 subjekte të detajuara në aneksin nr.4.1 kanë rezultuar në përputhje me manualin e kontrollit tatimor dhe nga ana e grupit të auditimit nuk janë identifikuar problematika materiale.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.30/43 protokollit, datë 16.05.2023, “Observacion”, nga z. D.XH, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Për sa trajtoni më lart në lidhje me Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhërin nr.192 datë 12.08.2020, neni 58, neni 57, ju bëj me dije se në të gjitha rastet ndërhyrja e përgjegjësit ose e drejtorit është parashikuar kur inspektori ka vështirësi në realizimin e procesit tatimor. Në rastet e sipërcituara nuk rezulton të jetë ngritur një problematikë e tillë nga ana e inspektorëve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i observacionit të drejtorit të kontrollit, z. Xh., ku gjenden edhe dokumentacionet shtesë të paraqitura, sqarojmë se nuk janë paraqitur të dhëna të tjera shtesë nga ato që i janë vendosur në dispozicion grupit të auditimit gjatë fazës së trajtimit të Projekt Raport kontrollit.

Bazuar në sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.30/38 prot., datë 16.05.2023, nga inspektori i kontrollit z. M.K, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Për sa trajtoni më lart në lidhje me procedurën e kontrollit në subjektin “T. SHPK”, ku citoni se detyrimet e ortakut nuk janë analizuar, ju sqaroj se: Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se ndryshimi i llogarisë “debitorë e kreditorë të tjerë”, është krijuar nga burimi i të ardhurave nga aktiviteti kryesor i ortakut, si dhe shitja e apartamentit,

bashkangjitur informacioni detajuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, z. K., ku gjenden edhe dokumentacionet shtesë të paraqitura, sqarojmë se nuk janë paraqitur të dhëna të tjera shtesë nga ato që i janë vendosur në dispozicion grupit të auditimit gjatë fazës së trajtimit të Projekt Raport kontrollit dhe që janë reflektuar që në fazën e Projekt Raportit. Bazuar në sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.30/40 prot., datë 25.05.2023, nga inspektori i kontrollit z. A.D, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *Për sa trajtoni më lart në lidhje me procedurën e kontrollit me personin fizik M.K, “Për periudhën 05/2019 deri 12/2020 është kryer kontrolli tatimor për kërkesën e bërë nga subjekti M.K (Person Fizik). Në akt kontrollin e inspektorit është cituar se në lejen e ndërtimit nr.929 ,datë 18.01.2019 është përcaktuar qartë lloji i objektit dhe përdorimit të tij Hotel (aktivitet i tatueshëm). Gjithashtu edhe nga verifikimet në vend dhe deklaratimet në sistemin C@ts aktivitet i ushtruar në këtë object (të hipotekuar nga subjekti M.K) është i tatueshëm. Prandaj personi i tatueshëm M.K Person Fizik, investitor i objektit i cili e përdor objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të tatueshme, bazuar në rregullat e zbritjes së TVSH-së. Sa më sipër observojmë se pasi është e vërtetë që leja e ndërtimit ka dalë në emër të personit M.K me nr. kartë identiteti, por duhet sqaruar se personi fizik me nipt për të ushtruar një biznes është i njëjlojtë me personin fizik pa nipt. Është e cilësuar që në lejen e ndërtimit që objekti që investitori do të ndërtojë do të jetë me destinacion hotel gjë që është e vërtetuar nga faturat e blerjes gjatë kohës së investimit po ashtu edhe nga faturat tatimore në shitje nga subjekti”*

Për sa trajtoni më lart në lidhje me procedurën e kontrollit me personin fizik M.K, “Për periudhën 05/2019 deri 12/2020 është kryer kontrolli tatimor për kërkesën e bërë nga subjekti M.K (Person Fizik). Në akt kontrollin e inspektorit është cituar se në lejen e ndërtimit nr.929 ,datë 18.01.2019 është përcaktuar qartë lloji i objektit dhe përdorimit të tij Hotel (aktivitet i tatueshëm). Gjithashtu edhe nga verifikimet në vend dhe deklaratimet në sistemin C@ts aktivitet i ushtruar në këtë object (të hipotekuar nga subjekti M.K) është i tatueshëm. Prandaj personi i tatueshëm M.K Person Fizik, investitor i objektit i cili e përdor objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të tatueshme, bazuar në rregullat e zbritjes së TVSH-së. Sa më sipër observojmë se pasi është e vërtetë që leja e ndërtimit ka dalë në emër të personit M.K me nr. kartë identiteti, por duhet sqaruar se personi fizik me nipt për të ushtruar një biznes është i njëjlojtë me personin fizik pa nipt. Është e cilësuar që në lejen e ndërtimit që objekti që investitori do të ndërtojë do të jetë me destinacion hotel gjë që është e vërtetuar nga faturat e blerjes gjatë kohës së investimit po ashtu edhe nga faturat tatimore në shitje nga subjekti”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga observacioni i dërguar nga ana e z. D, grupi i auditimit pasi analizoi dokumentacionin e paraqitur sqaron se leja e ndërtimit e paraqitur është në emër të një individi dhe jo si person fizik i cili ka kërkuar rimbursimin. Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 20 “Rregulla të përgjithshme”, pikës 4, ku citohet: “Në rastin kur ndërtohet një objekt prej një personi të tatueshëm që ndërton sipas porosisë së një personi tjetër të tatueshëm, një objekt për qëllime të kryerjes së veprimtarisë ekonomike së tij ekonomike, mund të ndeshemi me dy situata: a) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm; b) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë

veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm. Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të tatueshme, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSH-së të parashikuara në kapitullin X të ligjit, i lind e drejta e zbritjes së TVSH-në së paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim do të përdoret për një veprimtari të tatueshme me TVSH, për pasojë bazuar në parimin e neutralitetit të TVSH-së do t'i shërbejë një veprimtarie nga e cila lindin pagesa të TVSH-së”.

Referuar bazës ligjore të siëprcitur nga ana e grupit të auditimit gjatë shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se në lejen e ndërtimit të miratuar nga ana e Bashkisë Kavajë, është përcaktuar se leja e ndërtimit i referohet zhvilluesit të objektit si person i cili ka aplikuar me kartë identiteti, fakt i cili tregon në mënyrë të qartë se kemi të bëjmë me një individ i cili ka përfituar lejen e ndërtimit dhe jo me një person të tatueshëm. Sqarojmë se individ dhe personi i tatueshëm “M.K” janë dy entitete juridikisht të ndryshme, dhe për rrjedhojë me të drejta dhe detyrime tatimore të ndryshme. Në këtë kuptim individ i me kartë identiteti nuk mund të jetë në asnjë moment person i tatueshëm për efekt të TVSH-së dhe ti lind e drejta e rimbursimit të saj. Nga ana e inspektorit nuk është vepruar në përputhje me legjislacionin tatimor duke mos analizuar në asnjë rast në raportin e kontrollit. Gjithashtu nuk është verifikuar që në fazën e parë të kontrollit të dhënat e lejes së ndërtimit dhe ekzistenca e kushtit nëse kemi të bëjmë me një person tatueshëm ose jo.

Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, z.D, ku gjenden edhe dokumentacionet shtesë të paraqitura, sqarojmë se nuk janë paraqitur të dhëna të tjera shtesë nga ato që i janë vendosur në dispozicion grupit të auditimit gjatë fazës së trajtimit të Projekt Raport kontrollit.

Bazuar në sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Pretendimet e subjektit: Për sa trajtoni më lart në lidhje me procedurën e kontrollit me subjektin H...M.. SHPK, *Burimi i të ardhurave të tjera është nga huamarrjet që subjekti ka marrë nga individë të cilët janë të afërm të drejtuesve të shoqërisë. Huamarrjet sipas viteve janë: Viti 2015 në shumën 23,486,013 lekë, në vitin 2016 në shumën 31,434,223 lekë, viti 2017 në shumën 42,828,122 lekë, viti 2018 në shumën 42,596,397, viti 2019 në shumën 45,596,397 lekë dhe viti 2020 në shumën 54,024,027 lekë. Këto huamarrje janë marrë me kontrata me individë (R.H., E. H., K. H., A.H.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, z. D., ku gjenden edhe dokumentacionet shtesë të paraqitura, sqarojmë se nuk janë paraqitur të dhëna të tjera shtesë nga ato që i janë vendosur në dispozicion grupit të auditimit gjatë fazës së trajtimit të Projekt Raport kontrollit.

Bazuar në sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.30/44 protokolli, datë 19.05.2023, “Observacion”, nga z. D.D, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *Për sa trajtoni më lart në lidhje me kontrollin e ushtruar në subjektin “B... SHPK”, subjekti disponon leje ndërtimi nga Bashkia Durrës me nr.575 datë 23.07.2019. Në materialin e kontrollit janë detajuar të gjitha blerjet e kryera nga subjekti si dhe të përmbledhura në funksionin e tyre në shërbim të aktivitetit.Gjithashtu është paraqitur dhe një*

rast i dërguar për interpretim në DPT.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga observacioni i dërguar nga ana e z.D, grupi i auditimit pasi analizoi dokumentacionin e paraqitur sqaron se leja e ndërtimit e paraqitur është në emër të një individi dhe jo në emër të shoqërisë “B... SHPK”e cila ka kërkuar rimbursimin. Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 20 “Rregulla të përgjithshme”, pikës 4.. Referuar bazës ligjore të siëprecuruar nga ana e grupit të auditimit gjatë shyqrtimit të dokumentacionit rezultoi se në lejen e ndërtimit të miratuar nga ana e Bashkisë Durrës, është përcaktuar se leja e ndërtimit i referohet zhvilluesit të objektit si person i cili ka aplikuar me kartë identiteti, fakt i cili tregon në mënyrë të qartë se kemi të bëjmë me një individ i cili ka përfituar lejen e ndërtimit dhe jo me një subjekt të tatueshëm. Sqarojmë se individi dhe subjekti i tatueshëm “B... SHPK” janë dy entitete juridikisht të ndryshme, dhe për rrjedhojë me të drejta dhe detyrime tatimore të ndryshme nga njëra tjetra. Në këtë kuptim individi nuk mund të jetë në asnjë moment person i tatueshëm për efekt të TVSH-së dhe ti lind e drejta e rimbursimit të saj. Nga ana e inspektorit nuk është vepruar në përputhje me legjislacionin tatimor duke mos analizuar në asnjë rast në raportin e kontrollit dhe duke mos cituar lejen e ndërtimit. Gjithashtu nuk është verifikuar që në fazën e parë të kontrollit të dhënat e lejes së ndërtimit dhe ekzistenca e kushtit nëse kemi të bëjmë me një person të tatueshëm ose jo.

Për sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.30/41 protokollit, datë 15.05.2023, “Observacion”, nga z. Sh.P, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: 1. *Për sa trajtoni më lart në lidhje me kontrollin e ushtruar në subjektin “E. G.” diferenca e konstatuar nga ana juaj bazohet në sasinë e produktit të shitur dhe daljet në lëvizjen e lëndës së parë.... Pra bilanci material paraqet vetëm daljen e lëndës së parë polietilen për prodhimin e produktit të gatshëm pa përfshirë mallrat e blear. Kështuqë daljet e magazinës nuk mund të krahasohen me shitjet e produktit të gatshëm dhe mallrave sipas klientëve. Lidhur me amortizimin e sqarojmë se ligji 8438, datë 28.12.1998, përcakton kufirin ku subjekti nuk mund të llogarisë amortizimin më shumë se norma 10%, por në asnjë moment nuk e kufizon të drejtën e subjektit të llogarisë me norma të tjera amortizimi. Shpenzimet e amortizimit llogariten nga shoqëria mbi bazën e politikave ekonomike të vetë tatimpaguesit, i cili i përcakton normat në raport me masën e shfrytëzimit të aktivitetit të tij.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: 1. Nga shyqrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, z. P, ku gjenden edhe dokumentacionet shtesë të paraqitura, sqarojmë se nuk janë paraqitur të dhëna të tjera shtesë nga ato që i janë vendosur në dispozicion grupit të auditimit gjatë fazës së trajtimit të Projekt Raport kontrollit.

Bazuar në sa më sipër ***observacioni nuk merret në konsideratë.***

Pretendimet e subjektit: 2.*Sa trajtoni më lart në lidhje me procedurën e kontrollit me subjektin T. I. SHPK, Nga ana e grupit të auditimit një ndryshim të vlerës së inventarit të produktit të gatshëm datë 31.12.2021 nga shuma prej 101,250,441 lekë të pasqyruara nga subjekti, në një shumë të llogaritur nga grupi i auditimit, në shumën prej 141,487,601 lekë, për një diferencë në shumën 40,327,161 lekë, sipas ligjit të kontabilitetit është diferencë që ka të bëjë me ndryshim të shtesës së gjendjes së inventarit të produktit të gatshëm tek pasqyra fitim humbje 2021, dhe asnjehere me të ardhurat e deklaruara nga subjekti dhe nuk mund të bëhet rivlerësim të*

ardhurash pasi nuk jemi në kushtet e nenit 72.1, ky veprim ka të bëjë me pasqyrime e shpenzimeve tek pasqyra fitim humbje dhe efekte që rezultojnë, nuk mund të bëhet pa prova dhe fakte një rivlerësim dhe në zyrat tona. Shoqëria gjatë hartimit të pasqyrave financiare 2021 e ka parë të domosdoshme të bënte vlerësimin e inventarit me vlerën më të ulët mes koston dhe cmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'a përfunduar dhe shitur, na ka detyruar të bëjmë regjistrimet në kontabilitet humbje nga zhvlerësimi në momentin ku ky i fundit ndodh. Zvogëlimet për të arritur në cmimin e vlerësuar të shitjes pakësuar me koston mund të ndodhë në ato raste kur ka rënie të cmimit të shitjes ose kur shpenzimet përfundimtare apo shpenzimet direkte të shitjes janë rritur. Shoqëria këtë zhvlerëim në kosto e ka reflektuar edhe tek gjendja në vlerë të inventarit të produktit të gatshëm me datë 31.12.2021, që i jep efekte positive në pasqyrën të ardhura dhe shpenzime të ushtrimit 2022 pasi celja e produktit të gatshëm në vlerë është marrë në shumën prej 101,250,441 lekë dhe jo në shumën prej 141,487,601 lekë, pasi në rast se do të merret gjendja 141,487,601 lekë për vitin 2022 do të rezultojë në pasqyrën e të ardhura shpenzime me minus 40,237,161 lekë shtesa e produktit të gatshëm, por me veprimet që ka bërë shoqëria jep efekt pozitiv në pasqyrën të ardhura shpenzime plus 40,237,161 lekë. Po mos ta kishte reflektuar këtë zhvlerësim edhe tek gjendja e produktit të gatshëm datë 31.12.2021 shoqëria do të kishte pasqyruar si vlerë nga zhvlerësimi shumën prej 142,762,840 lekë dhe jo shumën prej 183,000,000 lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: 2. Nga observacioni i dërguar nga ana e z. P, grupi i auditimit pasi analizoi dokumentacionin e paraqitur sqaron se në periudhën ushtrimore 2021 rezulton një nënvlerësim i inventarit të lëndës së parë plastik Polietileni PE/kg me kosto për njësi prej 84 lekë, dukshëm më pak se kosto për njësi në celje të vitit 2021 si dhe në hyrje të vitit 2021.

- Nga ana e inspektorit në raport kontrollin tatimor nga faqja nr.13 deri në faqen nr.16 është përpunuar bilanci material dhe analiza e koston sipas periudhave (01/2020-03/2022), por nga auditimi rezulton se inspektori nuk ka përshkruar arsyet e regjistrimit me kosto për njësi të materialit PE/kg prej 84 lekë për njësi në fund të vitit 2021, duke mos shpjeguar pse ka ndodhur ky zhvlerësim i inventarit të lëndës së parë, arsyet pse lënda e parë PE/kg që përbën peshën specifike prej 78% të të gjithë inventarit të lëndës së parë është regjistruar dukshëm me kosto për njësi shumë më të ulët se në celje dhe në hyrjet e vitit.
- Gjithashtu në faqen nr.16, inspektori citon se: “*Daljet e materialeve për periudhën e kontrolluar janë bërë mbi bazën e normativave të përcaktuara në skedën teknologjike*”, por nga auditimi i dosjes nga ana e grupit të auditimit rezulton se citimi i inspektorit nuk qëndron pasi shoqëria nuk ka depozituar skedat teknologjike, të cilat i ka detyrim ligjor t'i paraqesë pranë organeve tatimore, duke mos përcaktuar normativat e përpunimit të lëndës së parë të futur në prodhim nga shoqëria. Për rrjedhojë situata e daljes së materialeve për periudhën e kontrolluar nga inspektori është e pa qartë, e pa analizuar si dhe nuk është shteruar plotësisht.
- Në lidhje me zhvlerësimin e inventarit që ka kryer shoqëria, i cili rezulton të jetë edhe më i ulët se kostoja e lëndës së parë (në celje dhe hyrje të vitit) nga ana e inspektorit nuk është vepruar në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, pika nr.5.3.1 ku citohet se “*Norma e qarkullimit të stokut Shuma e fitimit bruto (në kundërshtim me normën) të një subjekti është funksion i dy faktorëve: Diferenca midis procesit të blerjes dhe atij të shitjes (marzhi bruto) Numri i herëve që arrihet marzhi (norma e qarkullimit të mallit gjëndje – xhirime të tij). Pra, norma e qarkullimit të mallit gjëndje, është tregues i efikasitetit të një subjekti, sa herë ky mall gjëndje qarkullon gjatë një periudhe kontabiliteti. Përderisa malli gjëndje vlerësohet kryesisht me koston e tij, është e nevojshme të krahasohet malli në gjëndje me koston e mallrave që shiten gjatë vitit (Jo me shitjet). Për të reflektuar që niveli i mallit gjëndje mund të jetë rritur*

përprjestimisht gjatë vitit, merret gjëndja mesatare e stokut (d.m.th., mesatarja e mallit gjëndje në fillim dhe në fund)”. **Si dhe jo në përputhje me SKK nr.4 “Inventarët”,** pika nr.10-12 “Matja Fillestare” citohet se **“Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.”**, si dhe pikat 13-22 **“Vlerësimi i mëpasshëm”** ku citohet se: pika nr.13 **“Pas njohjes, një njësi ekonomike duhet të matë inventarin me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për tu përfunduar dhe shitur.”** Pika nr.14 **“Për ato mallra që nuk janë të këmbyeshme në tregje të zakonshme apo që janë të veçanta për projekte specifike, kostoja duhet të përcaktohet mbi bazën e metodës së identifikimit specifik. Metoda e koston bazuar në identifikimin specifik nuk është e përshtatshme për produkte homogjene si për shembull lëndët e para që përdoren në prodhim dhe pjesët e këmbimit që blihen shpesh dhe me çmime të ndryshme. Për të përcaktuar koston e një inventari të tillë, duhet të përdoret ose mesatarja e ponderuar ose metoda-hyrje e parë, dalje e parë (FIFO). Për të llogaritur koston e inventareve që kanë të njëjtën natyrë dhe përdorim për njësinë ekonomike, duhet të përdoret e njëjta formulë. Megjithatë, për inventarët me natyrë ose përdorim të ndryshëm, për llogaritjen e koston mund të justifikohet përdorimi i formulave të ndryshme nga ato të përmendura më sipër.,** Pika nr.15 **“Njësitë ekonomike që merren me prodhim produktesh duhet të përcaktojnë koston e inventarit të tyre. Kostoja e inventarit duhet të përfshijë të gjitha kostot e blerjes, koston e shndërrimit/prodhimit dhe koston që lidhen me sjelljen e inventarit në kushtet dhe vendndodhjen ekzistuese. Metoda të bazuara në koston direkte ku të gjitha shpenzimet indirekte futen në shpenzimet e periudhës nuk lejohen. Kostot indirekte duhet t’i ngarkohen inventarit pavarësisht se si klasifikohen ato nga njësia ekonomike.”**

- Në lidhje me pretendimin e inspektorit se shoqëria ka kryer zhvlerësimin e inventarit për shkak të rënies së cmimeve sqarojmë se, nga ana e inspektorit në faqen nr.12 të raport kontrollit përfundimtar, i cili ka kryer kontrollin e shitjeve të tatueshme 04/2020-03/2022, ku citon se **“Shitjet e kryera janë produkt i gatshëm i prodhuar nga vetë shoqëria. Produktet prodhohen sipas porosive të marra nga klientët si me kontrata ashtu edhe në mënyrë joformale. Për prodhimin e produktit të gatshëm përdoret lënda e parë dhe manikota etj., të cilat shkarkohen nga magazina e lëndës së parë dhe materialeve sipas normativave të harxhimit të tyre”**. Nga auditimi rezulton se nga inspektori nuk është kryer një analizë të qartë dhe të plotë e shitjeve, me qëllim vlerësimin nëse çmimi i produktit të gatshëm ka pësuar rënie në mënyrë të tillë që shoqëria të kryejë zhvlerësim të inventarit të lëndës së parë. Gjithashtu nga auditimi i të dhënave në raportin e mbajtur nga inspektori konstatohet se për vitin 2021 produkti i gatshëm Tub PE/kg është regjistruar me kosto për njësi në vlerën **138.2 lekë** dhe është shitur me **çmim 158.6 lekë** me marzh fitimi **14,73%**, ndërkohë që në tabelën e paraqitur në RPK në faqen nr.15 ku jepen të dhënat për **“Harxhimin e lëndës së parë në prodhimin e produktit të gatshëm”**, rezulton se lënda e parë PE/kg e hyrë në prodhim është regjistruar me kosto për njësi **në vlerën 170 lekë**. Për rrjedhojë situata e mësipërme tregon qartë që **kemi të bëjmë me shitje nën kosto** nga të dhënat e paraqitura në RPK e hartuar nga inspektori, duke regjistruar kosto për njësi të produktit të gatshëm tub plastik më pak se vetë kostot e lëndës së parë PE/kg. Nga ana e inspektorit jo vetëm që nuk është kryer një analizë e mirfilltë e cmimeve të shitjes së produktit të gatshëm tub plastik por gjithashtu nuk ka analizuar arsyen pse nga ana e shoqërisë ka ndodhur shitje nën kosto e produktit final në raport me koston e lëndës së parë.

Sa më sipër nuk jemi në kushtet e zhvlerësimit të inventarit nga ana e shoqërisë në përputhje me SSK nr.4 “Inventarët”, pikat 23-28 ku citohet se, pika nr.24 “Kërkesa për vlerësimin e inventarit me vlerën më të ulët mes kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për tu përfunduar dhe shitur e detyron njesinë ekonomike që të regjistrojë në kontabilitet humbjet nga zhvlerësimi në momentin kur ky i fundit ndodh. **Zvogëlimet për të arritur në çmimin e vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për tu përfunduar dhe shitur mund të ndodhin në ato raste kur ka një rënie të çmimeve të shitjes ose kur shpenzimet e përfundimit apo shpenzimet direkte të shitjeve janë rritur. Ka dhe raste kur disa produkte dëmtohen përpara se të shiten ose kur disa të tjerë mund të mbahen në sasira të tilla që nuk mund të shiten brenda një periudhë kohe të arsyeshme. Në raste të tilla, kostoja e inventarit duhet të zvogëlohet për të arritur në çmimin e vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për tu përfunduar dhe shitur.”, pika nr.25 “**Shuma e uljes së vlerës duhet të përcaktohet zë për zë. Në rastet kur një vlerësim i tillë nuk është praktik, zhvlerësimi duhet të matet për një grup zërash të ngjashëm ose që kanë lidhje me njëri-tjetrin. Zërat janë të ngjashëm ose kanë lidhje me njëri-tjetrin nëse ato i përkasin të njëjtës linjë prodhimi si dhe kanë funksione ose përdorime të njëjta. Zvogëlimi duhet të marrë parasysh kostot e vlerësuar për përfundimin dhe shitjen e produkteve, por nuk duhet të përfshijë fitimin që do të krijohet në fazat e mëvonshme të prodhimit.**”, pika nr.26 “Çmimet e tregut për materialet dhe furnizimet për përdorim në prodhim mund të zbresin nën koston e tyre. **Njësia ekonomike duhet të vazhdojë t’i mbajë në kontabilitet këto materiale me kosto dhe të mos bëjë ndryshime për zhvlerësimin e tyre nëse ajo parashikon që këto produkte do shiten me çmime më të larta se kostoja e prodhimit.**”**

Gjithashtu nga ana e inspektorit është vepruar në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor, për mos kryerje të analizës së çmimeve të shitjes si dhe riskut të shitjes nën koston e lëndës së parë ku përcaktohet në Kapitullin III pika nr.3 “Teknikat e analizës së normave”, Kapitulli IV pika nr.4 “Listë verifikimi i detyrueshëm për veprimet gjatë kontrollit tatimor”, Kapitulli V, pika nr.5.2 “Përqindja e fitimit bruto” Nëse norma ndryshon në kohë apo në raport me konkurrentë të tjerë, atëherë është i nevojshëm investigimi i mëtejshëm. Rënia e normës së fitimit bruto mund të shkaktohet ose jo nga: Çmime më të larta për mallrat e blerje? Blerje të këqia ose stok me lëvizje të ngadaltë? Gabime në kryerjen e inventarit? Vjedhje e mallrave dhe /ose arkës? Ndryshime në shitje – rritje të shitjeve për mallra me marzh fitimi më të vogël dhe me pak shitje me marzh më të lartë fitimi? Fshehje të shitjeve të bëra /rritje të blerjeve?”

Sa më sipër në mungesë të një analize të qartë dhe shteruese nga ana e inspektorit si dhe mungesat e arsyetimit të qartë për zhvlerësimin e inventarit të lëndës së parë dhe shitjes më pas nën kosto të produktit final.

Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, z. P, ku gjenden edhe dokumentacionet shtesë të paraqitura, sqarojmë se nuk janë paraqitur të dhëna të tjera shtesë nga ato që i janë vendosur në dispozicion grupit të auditimit gjatë fazës së trajtimit të Projekt Raport kontrollit.

Bazuar në sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.30/37 protokolli, datë 15.05.2023, “Observacion”, nga z. E.SH, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<p>Pretendimet e subjektit: Për subjektin “A...” SHPK, sqarojmë se: Gjetja e cila i referohet blerje automjet Toyota XA5 është në funksion të aktivitetit pasi përdoret për transport personeli dhe transport materialesh, prandaj citimi ku thuhet se është kreditim i gabuar nuk qëndron.</p>
--

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, z. Sh., ku gjenden edhe dokumentacionet shtesë të paraqitura, sqarojmë se nuk janë paraqitur të dhëna të tjera ndryshe nga ato që i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit gjatë fazës së trajtimit të Raportit kontrollit.

Bazuar në sa më sipër ***Observacioni nuk merret në konsideratë.***

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.30/40 protokoli, datë 15.05.2023, “Observacion”, nga z. A.D, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *Për subjektin “D...” SHPK, sqarojmë se: Gjetja e cila i referohet blerje automatizuar është në funksion të aktivitetit pasi përdoret për transport personeli, prandaj citimi ku thuhet se është kreditim i gabuar nuk qëndron, gjithashtu lidhur me konstatimin në zërin shpenzime për paga dhe shpërblime nuk janë kaluar me bankë ju sqarojmë se subjekti nuk i ka kaluar pagat me bankë por ato i ka paraqitur në pasiv të bilancit si detyrime ndaj punonjësve në vlerën 862,083 lekë, gjithashtu afati ligjor nuk ka kaluar mbi 5 vjet dhe për rrjedhojë nuk mund të hiqen nga detyrimet që ka subjekti ndaj punonjësve.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, z. D, sqarojmë se automjeti të cilit grupi i auditimit i referohet nuk është automjet për transport, por është për përdorim personal kjo vërtetohet edhe nga lloji i cili është autovetur, gjithashtu lidhur me kundërshtimin mbi fondin e pagave për të cilin inspektori pretendon se janë paraqitur në bilanc në pasiv kjo nuk qëndron pasi zëri detyrime ndaj punonjësve për këtë periudhë është 0. Bazuar në sa më sipër ***Observacioni nuk merret në konsideratë.***

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.30/44 protokoli, datë 19.05.2023, “Observacion”, nga z. D ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *Për subjektin “A...” SHPK, sqarojmë se: konstatimi i cili i referohet shpenzimeve për bileta udhëtimi nga ana e shoqërisë nga ana ime nuk janë konsideruar si shpenzime për pritje përcjellje por si shpenzime që përfshihen në zërin Udhëtime, dieta, të cilat nuk e kanë kaluar vlerën 50% të fondit të pagave për vitin 2019.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, z. D, lidhur me kundërshtimet e paraqitura mbi gjetjen ku citohet: udhëtimi për pjesmarrje në panairin e organizuar nga H... I...Gjermani, referuar bazës ligjore të sipërcituar këto shpenzime nuk duhet ti njihen subjektit. Bazuar në sa më sipër ***Observacioni nuk merret në konsideratë.***

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.30/46 protokoli, datë 31.05.2023, “Observacion”, nga znj. Sh.K, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *Për subjektin “K...M” SHPK, lidhur me shitjet nën kosto të konstatuara nga ana juaj ju bëj me dije se tableat të cilat ju i jeni referuar ka të bëjë me analizën e kostos së mallrave të blera sipas deklaratve doganore dhe jo analizës lidhur me cmimin e shitjes së tyre.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i observacionit të inspektores të kontrollit, znj. K, lidhur me kundërshtimet e paraqitura mbi gjetjen grupi i auditimit i është referuar të dhënave në sistemin tatimor si dhe në të dhënat të cilat janë pasqyruar në raportin kontrollit, të dhëna të cilat janë përdoruri nga inspektori i kontrollit për të analizuar situatën financiare të subjektit objekt

kontrolli, nuk është sjellë asnjë argumentim, analiza ose dokumenta justifikuese të reja, për të kundërshtuar konstatimet e grupit të audituesve të KLSH. Bazuar në sa më sipër **Observacioni nuk merret në konsideratë.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.30/39 protokollit, datë 15.05.2023, “Observacion”, nga z. N.D, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *Për subjektin “V..T..” SHPK, sqarojmë se: Gjetja e cila i referohet blerje autoveture mercedes është në funksion të aktivitetit pasi përdoret për transport udhëtarësh, kjo vërtetohet edhe nga faturat e shërbimit të cilat gjenden bashkëlidhur,prandaj citimi ku thuhet se është kreditim i gabuar nuk qëndron.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i observacionit të inspektorit të kontrollit, z. D, sqarojmë se grupi i auditimit pasi u njoh me faturat e blerjet së autoveturës konstatohet se jemi në rastin kur duhet të ishin rregjistruar si blerje e përjashtuar nga kreditimi i TVSH sipas përcaktimeve të ligjit 92/2014, neni 74, pika 1 c. Bazuar në sa më sipër **observacioni merret pjesërisht në konsideratë.**

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:

Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, neni 72, neni 115, neni 124;

Ligji nr.92/2014 datë 24.07.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” neni 74;

Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1.

Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ” Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 22, pika 3, pika 5.

UMF nr. 16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.

Udhëzimi nr.5, datë 30.01.2006 për “Tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar pika 3.6;

Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, neni 8, neni 55;

Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër Nr.1482/2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave;

Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhërin nr.192 datë 12.08.2020;

Neni 59 ““Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit në Vend”.

Pika 1.

Neni 58 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësitë të Sektorit të Kontrollit në Vend”.

Pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8.

Neni 57 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtoritë të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në Drejtoritë e tjera Rajonale”

Pikat 2, 7.

Neni 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”.

Pikat 3, 10, 11, 18.

Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër Nr.1482/2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave.

Manuali i Kontrollit Tatimor.

Formulari i dokumentimit të lëvizjes së dokumentacionit të kontrollit nga Inspektori deri tek Drejtori i Drejtorisë Rajonale. (Inspektor, Përgjegjës Sektori, Drejtor Kontrolli, Drejtor Rajonal). Fakti që firmos dhe ka të drejtën e komenteve Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal i DRT.-së, në aneksin e raportit paraprak dhe përfundimtar i bën përgjegjës, sepse manuali ju rezervon të drejtën e shprehjes dhe të komenteve për rezultatet e procedurës së kontrollit. Në rastin e Drejtorit Rajonal ky fakt që përbën përgjegjësi funksionale të nënpunësit/titullar si person që ka dijeni dhe nënshkruan aktin administrative të organit përkatës të administratës publike sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:

- z. D.T me detyrën e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.
- z. D.XH me detyrën e Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, si dhe Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit.
- z. Sh.P me detyrën e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.
- z. A.D me detyrën e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.
- z. M.K me detyrën e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.
- z. K.Rr me detyrën e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.
- z. N.D me detyrën e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.
- z. D.D me detyrën e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës
- znj. Sh.K me detyrën e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.
- znj. A. M. me detyrën e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës
- z. E.SH me detyrën e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.

-Sektori i Kontrollit nga zyra dhe Monitorimit

Në zbatim të kësaj çështje të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, informacioni dhe të dhënat si më poshtë:

1. Organika e Sektorit të kontrollit nga Zyra dhe monitorimit;
2. Plane mujore të punës;
3. Ndarjet e Nipt-ve sipas inspektorëve;
4. Kasat Fiskale;
5. Deklaratat vjetore në nivel subjekti të TVSH
6. Tepricat kreditore TVSH-TF-TTHF;
7. Deklaratat e TF-TTHF;
8. Rivlerësimet e kësteve të TF etj.

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Manuali për Kontrollin nga Zyra, shërben për punën e përditëshme të inspektorëve të kontrollit nga zyra.

Objekt i punës të kontrollit tatimor nga zyra:

- Analizon nëpërmjet raporteve të implementuar në sistem, nxjerr konkluzione përkatëse për situata të parregullta të deklaratave të ndryshme tatimore, tatimpaguesit me gjëndje të lartë e të vazhdueshme kreditore TVSH, tatimfitimi, mosdeklarues për lloje të ndryshme tatimi, deklaruesit pa veprimtari apo tatimpaguesit që kanë ndërprerë deklarimin.
- Analizon dhe nxjerr konkluzione nëpërmjet kryqëzimit të librave të shitjes dhe të blerjes për deklarimin e faturave tatimore të shitjes apo blerjes duke përcaktuar detyra për sisteme e rivlerësime të ndryshme tatimore kur është e nevojshme.
- Në zbatim të ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr. 5 datë 30.01.2006 në zbatim të ligjit krijon në ulje apo në rritje, me kërkesë ose jo të tatimpaguesit plan të rishikuar të parapagimeve sipas modulit të krijimit të planeve të parapagimit të implementuar në sistem.
- Zbaton dhe hedh në sistem vendimet e apelimit tatimor dhe vendimet e formës së prerë të gjykatave në lidhje me detyrimet tatimore dhe penalitetet. Për detyrimin tatimor nëpërmjet rivlerësimit të deklaratave tatimore sipas vendimeve përkatëse (Moduli i kontrollit nga zyra) dhe për anulimin e penalteteve me modulën e anulimit të gjobave.
- Ndjekin procedurat e përthithjes, ndarjes së tatimpaguesve, për transferimin e kredive të tatimeve të ndryshme nga një tatimpagues tek tjetri brenda një DRT.-je apo në DRT.-të të ndryshme.
- Kryen rimbursimin e tatimeve të ndryshme tatimore sipas këkesave të tatimpaguesve përveç TVSH-së.
- Ndjekin në çdo rast kryerjen e procesit të kompensimit të detyrimeve të papaguara para kryerjes së rimbursimeve qoftë nga DPT.-ja për TVSH-në, apo nga DRT.-të të tatimeve të tjera, sipas manualeve të përdorimit të implementuara në sistemin informatik.
- Analizojnë dhe pregatisin planet e ndryshuara të parapagimeve sipas kërkesave të tatimpaguesve në zbatim të legjislacionit tatimor në fuqi gjatë gjithë vitit ushtrimor.
- Ndjek arkëtimin e detyrimeve tatimore të vetëdeklaruara por të papaguara deri në kalimin e tyre në borxh që duhet të mblidhet me forcë.
- Ndjek nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit tatimpaguesit të cilët nuk kanë deklaruar në afatin ligjor.

Struktura e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, Sektori Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit:

Struktura e miratuar me Urdhrin Nr. 33, datë 12.02.2020 “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore” ka përfunduar në datën 03.08.2020.

Sektori Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, në strukturën organizative është e përbërë nga 24 pozicione pune, ku nga auditimi rezulton se një pozicion pune (inspektor i dytë), është vakant.

Struktura e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit:

Drejtoria e Kontrollit (SKZM)	Struktura	Vakanca
Përgjegjës Sektori	1	-
Inspektor	22	1
Total	23	1

Shënim: Burimi i të dhënave: DRT. Durrës; Punoi: KLSH

2. Veprimtaria e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.

Nga auditimi u konstatua se: Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe monitorimit për periudhën e auditimit disponon plane mujore dhe vjetore ku të përcaktohen objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët për të monitoruar subjektet në mënyrë të vazhdueshme. Nga dokumentacioni i kërkuar në DRT. Durrës mbi hartimin dhe raportimin e planeve mujore, grupit të auditimit janë vënë në dispozicion planet mujore dhe vjetore të punës për këtë sektor.

3. Ndarja e NIPT-eve sipas Inspektorëve

Grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion 4 shkresa në lidhje me ndarjen e subjekteve si në vijim:

- Shkresa nr. 1370 prot datë 04.02.2021, drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra.
- Shkresa nr. 4461 prot datë 14.04.2021, drejtuar Inspektorit A.C.
- Shkresa nr. 575 prot datë 26.01.2022, Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra.
- Shkresa nr. 5644 prot datë 05.07.2022, drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra.

Memot janë të përgatitura nga përgjegjësi i Sektorit, aprovuar nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit dhe miratuar nga Drejtori Rajonal, në përputhje me manualin e kontrollit.

4. Kasat Fiskale

Nga auditimi u kryqëzuan të dhënat e marra nga DRT. Durrës në lidhje me kasat fiskale dhe gabimet e kasave. Grupi i auditimit përpunoi të dhënat për të nxjerrë xhiron e korrektuar të subjekteve dhe konstatoi sa më poshtë:

Tabela nr. 1 Kasat fiskale

(në lekë)

Vitet	Totali i Xhiros nga Kasa	Gabime Kasa	Xhiro e korrektuar
2021	43,720,685,040	(456,355,161)	43,264,329,879
2022	443,594,459		443,594,459

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës

Të dhënat për diferencat e sipërcituara nuk gjenerojnë detyrime tatimore pasi subjektet biznesi i vogël me xhiro deri në 8,000,000 lekë nuk paguajnë Tatim Fitimi.

Për vitin 2022 kemi një xhiro të vogël deklaruar me kasë pasi subjektet janë bërë pjesë e fiskalizimit.

Në vijim për bizneset e vogla pa TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës (zbritur gabimet e kasës) dhe të ardhurat në deklaratën e TTHF ku u konstatuan diferenca si në vijim:

Tabela nr. 2 qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TTHF- 2021 në Lekë

Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të ardhura DEKL TFTH	DIF (+)
147	333,034,498	104,114,603	226,919,895

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës

Në vijim për bizneset e vogla me TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës (zbritur gabimet e kasës) dhe të ardhurat në deklaratën e TVSH ku u konstatuan diferenca vetëm për subjektet si në vijim për të cilat nuk është vepruar me sistemimin dhe saktësimin e këtyre diferencave:

Tabela nr.3 qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TTHF- 2021 Në Lekë

Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të ardhura DEKL TFTH	DIF (+)
18	40,508,423	20,012,422	20,496,001

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës

Në nivel NIPT-i subjektet me diferenca paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.4 diferenca sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TTHF në nivel nipti.

NR	Nipt	Subjekti	P.Tatimore	Deklarata TTHF	Kasa	Diferenca	Inspektori
1	L.....Q	E.M.	BV ME TVSH	0	2,281,144	(2,281,144)	E.C
2	L.....Q	S. K.	BV ME TVSH	0	2,154,298	(2,154,298)	V.K
3	M.....E	D. E.	BV ME TVSH	0	2,154,224	(2,154,224)	F.Y
4	L.....I	E.B.	BV ME TVSH	0	1,900,474	(1,900,474)	S.Q
5	K.....V	F. R.	BV ME TVSH	0	1,649,928	(1,649,928)	R.S
6	K.....G	Sh. B.	BV ME TVSH	0	1,492,118	(1,492,118)	D.B
7	L.....E	F. F.	BV ME TVSH	0	1,146,429	(1,146,429)	V.K
8	L.....J	B. K.	BV ME TVSH	0	825,519	(825,519)	N.SH
9	L.....E	A.P..	BV ME TVSH	0	764,456	(764,456)	V.K
10	L.....T	A. M.	BV ME TVSH	0	735,200	(735,200)	A.C
11	M.....A	B. Ç.	BV ME TVSH	345,533	1,023,200	(677,667)	F.Y
12	L.....R	L.Ç.	BV ME TVSH	1,723,010	2,146,096	(423,086)	N.SH
13	K.....P	G.V.	BV ME TVSH	2,417,355	2,757,926	(340,571)	D.B
14	L.....O	F. N.	BV ME TVSH	2,640,520	3,679,808	(1,039,288)	V.K
15	L.....G	M.A.	BV ME TVSH	2,744,609	4,278,960	(1,534,351)	A.C
16	L.....J	A. K.	BV ME TVSH	2,992,095	3,113,414	(121,319)	S.Q
17	K.....J	H. Z.	BV ME TVSH	3,400,000	4,417,696	(1,017,696)	R.D
18	L.....B	A. D.	BV ME TVSH	3,749,300	3,987,534	(238,234)	G.L
		Totali		20,012,422	40,508,423	(20,496,001)	

Efekt i financiar:

TVSH për tu paguar detyrim (20,496,001 lekë *20%) = 4,099,200 lekë

Gjoha (4,099,200 * 100%) = 4,099,200 lekë

Nga sa më sipër vlerësohet paraprakisht se diferenca sipas kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TTHF- në për 18 subjekte në vitin 2021 ka sjellë një total të ardhura të munguara gjithsej 8,198,400 lekë, nga të cilat 50% janë vlerat e gjobave.

Në vijim për bizneset e mëdha u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës së TVSH-së. (Shumatore e plotë e kategorive: shitje të përjashtuara nga TVSH, shitje pa TVSH, eksporte mallrash, furnizime me shkallë 0%, shitje të tatueshme me shkallë 20%, TVSH e llogaritur shitje të tatueshme me shkallë 20%, shitje të tatueshme me shkallë 10%, TVSH e llogaritur shitje të tatueshme me shkallë 10%, shitje të tatueshme me shkallë 6%, TVSH e llogaritur shitje të tatueshme me 6%, shitje të tatueshme sipas regjimeve të agjentit të udhëtimit, TVSH e llogaritur sipas agjentit të udhëtimit).

Duke vlerësuar riskun, në testim u morën rastet kur xhiroja sipas kasës rezultonte më e madhe se shitjet sipas deklaratës së TVSH-së ku u konstatuan diferenca si në vijim:

Tabela nr.5 Diferencat sipas qarkullimit viti 2021 B.M

Në Lekë

Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të ardhura DEKL TF	DIF (+)
9	94,998,427	6,378,632	88,619,795

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës

Në nivel NIPT-i subjektet me diferenca paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.6 diferenca sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TF në nivel nipti.

NR	Nipt	Subjekti	P.Tatimore	Deklarata TTHF	Kasa	Diferenca	Inspektori
1	L.....F	Z...H....	BM	3,376,331	21,320,295	(17,943,964)	E.C
2	L.....B	K...T....	BM	0	17,305,318	(17,305,318)	A.C
3	L.....N	F....C....	BM	308,093	6,636,572	(6,328,479)	S.Q
4	L.....O	A...S....	BM	1,293,189	12,639,257	(11,346,068)	V.K
5	L.....G	B....C....	BM	0	9,523,266	(9,523,266)	E.C
6	J.....P	D...F....	BM	0	8,620,504	(8,620,504)	E.G
7	M.....N	N... T....	BM	1,401,019	9,060,762	(7,659,743)	F.Y
8	K.....K	I...A....	BM	0	7,191,708	(7,191,708)	D.B
9	L.....O	Sh.....	BM	0	2,700,745	(2,700,745)	D.B
Totali				6,378,632	94,998,427	(88,619,795)	

Efektet financiar:

TVSH për tu paguar detyrim $(88,619,795 \text{ lekë} * 20\%) = 17,723,959 \text{ lekë}$

Gjoha TVSH $(17,723,959 * 100\%) = 17,723,959 \text{ lekë}$

Detyrim TF $(88,619,795 * 15\%) = 13,292,969 \text{ lekë}$

Gjoha TF $(13,292,969 * 100\%) = 13,292,969 \text{ lekë}$

Nga sa më sipër vlerësohet paraprakisht se diferenca sipas kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TF- në për 9 subjekte në vitin 2021 ka sjellë një total të ardhura të munguara gjithsej 62,033,856 lekë, nga të cilat 50% janë vlerat e gjobave.

Duhet theksuar se, në trajtimin e mësipërm risku është vlerësuar për rastet kur shitjet sipas kasës rezultojnë më të larta se qarkullimi sipas deklaratave.

5. Subjekte që rezultojnë debitorë në TF.

Nisur nga deklarata e TF 2021 si dhe të dhënave të përpunuara, nga informacioni vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultojnë debitorë në mos likuidimin e TF të vetdeklaruar si në vijim:

Tabela nr.7 Subjekte që rezultojnë debitorë në TF 2021

Në Lekë

Subjekti 2021	Detyrimi Principal	Interesa	Gjoha	Detyrimi Total
Aktiv	40,201,312	12,580,345	1,003,668	53,785,325
Kërkesë për Çregjistrim	1,095,092	400,059	44,258	1,539,409
Pasiv	80,645,336	26,952,222	242,627	107,840,185
Total	121,941,740	39,932,626	1,290,553	163,164,919

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës

Për sa më sipër konstatohen subjekte, të cilët kanë kryer deklarimin e TF për vitin 2021 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 163,164,919 lekë (Sipas zërave përbërës), vlerë e cila duhet të ishte e arkëtuar brenda 31.03.2022.

Nisur nga deklarata e TF për vitin 2022 si dhe të dhënave të përpunuara, nga informacioni vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultojnë debitorë në mos likuidimin e TF të vetdeklaruar si në vijim:

Tabela nr.8 Subjekte që rezultojnë debitorë në TF 2022

Në Lekë

Subjekti 2022	Detyrimi Principal	Interesa	Gjoha	Detyrimi Total
Aktiv	155,876,326	13,727,701	3,953,397	173,557,424
Kërkesë për Çregjistrim	1,573,329	245,691	0	1,819,020
Pasiv	48,436,161	9,045,702	107,606	57,589,469
Total	205,885,816	23,019,094	4,061,003	232,965,913

Burimi: Të dhëna të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës

Për sa më sipër konstatohen subjekte të cilët kanë kryer deklarimin e TF për vitin 2022 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 232,965,913 lekë (Sipas zërave përbërës), vlerë e cila duhet të ishte e arkëtuar brenda 31.12.2022. Për periudhën objekt auditimi rezulton detyrim i pa mbledhur nga DRT. Durrës.

Tepricat Kreditore të TVSH-së dhe Tatimit mbi Fitimin.

Teprica Kreditore e TVSH-së.

Nga databaza e tepricave kreditore të TVSH-së u përzgjedhën subjektet (Top 50) me tepricën më të lartë kreditore për periudhën tatimore deri në Dhjetor 2022, të detajuara në tabelën nr.9:

Për sa më sipër, konstatohet se për periudhën e auditimit, kemi subjekte me tepricë kreditore kryesisht në rritje me aktivitet tregti dhe prodhim të cilat risin riskun e evazionit nëpërmjet mosdeklarimit të shitjeve. Këto subjekte mbajnë peshën më të madhe dhe teprica kreditore e tyre është rritur ndjeshëm nga viti 2021 deri në me 31.12.2022.

Fakti që teprica kreditore nuk ndryshon apo ka pësuar rritje, nga ana e Inspektorit përkatës për këtë periudhë nuk është kërkuar informacion, analizuar apo propozuar për kontroll, kjo tregon veprime dhe mos veprime që ndikojnë në uljen e performancës në lidhje me deklaratimet tatimore të tatimpaguesit.

Për këta subjekte të detajuara në Aneksin nr.4.2 nuk është kryer verifikimi në vend nëpërmjet kombinimit me sektorin e zbatimit/DVT nëse kanë gjendje malli apo aktive në vendndodhjet e deklaruara të biznesit.

Teprica kreditore e Tatim Fitimit.

Nga të dhënat e marra lidhur me ecurinë e tepricës kreditore të Tatim Fitimit rezulton se në DRT. Durrës, për periudhën janar- dhjetor 2022 teprica kreditore e tatim fitimit është në shumën 729,906,028 lekë, të detajuara në Aneksin nr.4.3.

Teprica kreditore e Tatim të Thjeshtuar mbi Fitimin.

Nga të dhënat e marra lidhur me ecurinë e tepricës kreditore të Tatim të Thjeshtuar mbi Fitimin rezulton se për periudhën Dhjetor 2022 tepricat kreditore të TTHF në DRT. Durrës është në shumën 82,028,573 lekë.

Për sa më sipër konstatohet një monitorim i dobët për këto biznese, veçanërisht për kategorinë Biznes i madh, i cilësuar me risk të lartë.

Subjekte të cilët kanë paguar me vones ose nuk e kanë paguar këstin e Tatim Fitimit.

Nga auditimi u konstatuan biznese të detajuara në Aneksin nr.4.4 që nuk kanë paguar këstët e T.Fitimit Bazuar në Ligjin 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar, Neni 114/1 - “Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatim mbi fitimin, i

ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. dënohet me gjobë në masën 10 për qind të shumës së këstit për t'u paguar.

Sa më sipër vihet re se për periudhën objekt auditimi, janë konstatuar 289 raste të cilët nuk kanë paguar këstet e Tatim Fitimit në afat, në vlerën në vlerën 69,132,771, lekë cilët duhet të ishin penalizuar në masën e gjobës 10% të vlerës së këstit, sipas kërkesave të Ligjit 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar, Neni 114/1 “Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatim mbi fitimin, i ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. dënohet me gjobë në masën 10 për qind të shumës së këstit për t'u paguar.

Gjoha TF (69,132,771 *10 %) = 6,913,277 lekë

Total detyrimi = 62,033,856 lekë.

Nga sa më sipër vlerësohet për këto subjekte në vitin 2022 ka sjellë një total të ardhura të munguara gjithsej 6,913,277 lekë, e cila përfaqëson vlerën e gjobës.

Këstet e Tatim Fitimit në ulje

Grupi i auditimit testoi qarkullimin e subjekteve që kanë paraqitur kërkesë për ulje të kësteve të tatim fitimit, ku rezultuan 20 subjekte për periudhën 2021-2022 me këstet fillestare të tatim fitimit në vlerën 14,642 mijë lekë, këste të rivlerësuar tatim fitimi në vlerën 1,599 mijë lekë me një diferencë prej 13,043 mijë lekë, të detajuara në Aneksin nr.4.5

Nga auditimi i vlerësimit të kërkesave të subjekteve në lidhje me uljen e kësteve të tatim fitimit për vitin 2021-2022 lidhur me subjektet të cilat kanë vlerat më të mëdhaja të kërkuara rezultojnë 20 subjekte, nga trajtimi i të cilave është miratuar ulja sipas kërkesave bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” Neni 30 , pika 5 citon: “Në rastin kur tatimpaguesi, në cdo kohë, vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrit të Financave. Në rast se subjekti ka ulur këstet e parapagimit, të caktuara nga organi tatimor, dhe detyrimi tatimor vjetor për tatimfitimin, që rezulton nga bilanci, tejkalon parapagimin me më shumë se 10%, subjekti duhet të paguaj kamatëvonesë mbi diferencën ndërmjet detyrimit real vjetor dhe shumës së parapaguar gjatë vitit, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrit të Financave”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr.30/42 prot., datë 16.05.2023 dhe observacioni me nr.30/45 prot., datë 19.05.2023 “Observacion mbi Akt Konstatimin nr.5”, nga 21 inspektorët e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Lidhur me konstatimin e diferencave kasë / TFTH viti 2021 nuk është marr në analiza rubrika e të ardhurave tatimore por ato të ushtrimit, gjithashtu inspektorët e kontrollit nga zyra kanë pasur një ngarkesë të madhe subjektësh për t'u verifikuar e cila është 1257 subjekte, krahas edhe detyrave të tjera funksionale.

2. Lidhur me diferencat e kasave të biznesi i madh nuk është marr në analiza rubrika e të ardhurave tatimore por ato të ushtrimit, gjithashtu për disa aktivitete në FDP jepet vetëm vlera e shërbimit.

3. Lidhur me mos aplikimin e penaltetit për subjektet të cilët nuk kanë paguar në afat këstet e tatim fitimit u analizuan me kujdes për secilin tatim pagues dhe kemi dhënë argumentat e mos aplikimit të gjobës për secilin rast.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1. Grupi i auditimit referuar kundërshtimeve të paraqitura nga ana juaj në këtë observacion nuk merren në konsideratë pasi grupi mbështet në dokumentacionin dhe deklaratat të paraqitura nga ana e subjektit në sistemin C@ts. *Pretendimet e paraqitura në observacion nuk qëndrojnë.*

2. Grupi i auditimit i referohet deklaratave të cilat gjenden në sistemin C@ts, për periudhën e auditimit në teren, argumentat justifikues të paraqitur nga ana juaj, reflektojnë të dhëna për ndryshime të deklaratave të subjekteve pas përfundimit të auditimit. *Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.*

3. Grupi i auditimit referuar kundërshtimeve të paraqitura nga ana juaj në këtë observacion u qëndron konstatimeve pasi konstatimi mbështet në afatet e përcaktuara sipas për aplikimin e penalitetit, arsyetimet e paraqitura në tabelën bashkëlidhur nuk qëndrojnë dhe nuk i përjashton inspektorët e kontrollit nga zyra për të aplikuar penalitetin për cdo rastë në të cilin konstatohet se subjekti nuk e ka kryer pagesën në afatin e përcaktuar. *Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.*

1. Titulli gjetjes:	Diferenca në qarkullimin e të ardhurave të deklaruara në kasë me të ardhurat e deklaruara në deklaratat e TF dhe TTFH, me pasoja negative në të ardhurat buxhetore.
Situata:	<p>Nga auditimi i DRT. Durrës u konstatua se Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e qarkullimit sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat e TTFH dhe TF për tatimpaguesit, nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e procedurale, të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:</p> <p>a) Për subjekte biznesi i vogël pa TVSH u konstatuan se:</p> <ul style="list-style-type: none">- për vitin 2021 për 147 subjekte me qarkullim sipas kasës me vlerë 226,919,895 lekë më tepër sesa të ardhurat e deklaruara në TTFH dhe <p>b) Për bizneset e vogla me TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TVSH-s, ku u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none">- Për vitin 2021, për 18 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklaratat në FDP në vlerën 20,496,001 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 8,198,400 lekë. <p>c) Për BM u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës, ku u konstatuan se,</p> <ul style="list-style-type: none">- Për vitin 2021, 9 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklaratat në FDP në vlerën 88,619,795 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 62,033,856 lekë. <p>Nga sa më sipër, bazuar në vlerësimet paraprake të grupit të auditimit konstatohen të ardhura të munguara gjithsej në shumën 70,232,256 lekë.</p>
Kriteri :	<ul style="list-style-type: none">- Ligji 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 71,- Rregullore e Funkcionimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, miratuar nga MFE me Urdhër nr.19, datë 22.02.2017, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Një situatë e vazhdueshme për periudhën në auditim duke mos u shoqëruar me përmirësime në këtë proces dhe duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit të vlerësuara paraprakisht në shumën e 70,232,256 lekë.

Shkaku:	Menaxhim dhe planifikim jo efektiv i kryer nga drejtuesit, duke mos iu kushtuar rëndësinë e duhur këtyre çështjeve.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Sektori i Kontrollit nga Zyra, të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë menjëherë masat e duhura administrative, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara në Tatimin mbi Fitimin, Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH nëpërmjet rikontrolleve, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën gjithsej prej 70,232,256 lekë nga të cilat 50 % gjobë tatimore për kundravajtjet në lëshimin e faturave tatimore.

2.Titulli gjetjes:	Mos pagesa në afat e kësteve të Tatimit mbi Fitimin, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit.
Situata:	Nga auditimi i DRT. Durrës u konstatua se Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për bizneset që nuk kanë paguar këstët e T.Fitimit sipas afatit të përcaktuar në <i>Ligjin 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar, Neni 114/1 - “Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatim mbi fitimin, i ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. dënohet me gjobë në masën 10 për qind të shumës së këstit për t’u paguar.</i> Konstatohen 289 raste në vlerën 69,132,771 lekë, për të cilat duhej të vendosej gjoba TF (69,132,771 *10 %) = 6,913,277 lekë Nga sa më sipër, konstatohen penalitete të pallogaritura, të pambajtura dhe të papaguara në të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit të vlerësuara gjithsej në shumën 6,913,277 lekë.
Kriteri :	- Ligji 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar, Neni 114/1.
Ndikimi/Efekti	Një situatë e vazhdueshme për periudhën në auditim duke mos u shoqëruar me përmirësime në këtë proces dhe duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit të vlerësuara në shumën e 6,913,277 lekë.
Shkaku:	Menaxhim dhe planifikim jo efektiv i kryer nga drejtuesit, si dhe nga mungesa e vlerësimit për të vepruar për çështje të tilla.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të marrë menjëherë masat e duhura administrative, të llogaris penalitetet përkatëse, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit për penalitete të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 6,913,277 lekë për mos pagimin në afat të kësteve të tatimit mbi fitimin.

3. Titulli gjetjes:	Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raporteve të kontrollit, të inspektorëve të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në lidhje me mos llogaritjen e interesave për transaksionet e huamarrjes dhe huadhënies së shoqërive me ortakët.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre shoqëritë “T..” SHPK, “H...M..” SHPK, në periudha të ndryshme kohore kanë kryer transaksione huamarrje dhe huadhënie me ortakun (<i>kreditime dhe debitime nga llogaria e ortakut</i>), për llogari të këtyre shoqërive, me qëllim kryesor mbarëvajtjen normale të aktivitetit tregtar të shoqërive, sipas përshkrimeve në raportet e kontrolleve të

	<p>inspektorëve tatimor. Këto pagesa nuk konfirmohen me saktësi në raportet e kontrollit tatimor, si pagesa të kryera nëpërmjet sistemit bankar dhe të pasqyruara me prova në aktet e mbajtura nga inspektorët e kontrollit. Në lidhje me transaksionet kur ortaku i jep shoqërisë hua ose e anasjellta, pa aplikuar interesa, grupi i audituesve gjykon se kemi të bëjmë me veprime të cilat janë pa thelb ekonomike dhe në kundërshtim me parimin e vlerës së tregut. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e pikave b, c, dh të nenit 71, germat a, b, c, ç të nenit 71/2 dhe germa ç të neni 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 24 date 02.09.2008, i ndryshuar, për të cilat duhet të ishte kryer vlerësim alternativ i situatës financiare së shpenzimeve të interesit të pallogaritura në PASH, si rikarakterizim të ardhurash duke sjellë si pasojë detyrime tatimore. Referuar kuadrit legjislativ tatimor, rezulton se ortaku dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuara janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Sipas legjislacionit tatimor si shoqëria dhe ortaku konsiderohen si “Palë të lidhura”, meqenëse ortaku ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr.16, datë 18.6.2014 “Për transferimin e çmimit”, gjë që sjell se çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t’u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut (Arm’s Length). Megjithëse nuk ka të përcaktuar saktë dhe qartë mënyrën e procedimit në legjislacionin tatimor të fushës së llogaritjes së interesave dhe detyrimeve tatimore të rillogaritura në rastet e huadhënies nga llogaria e ortakut drejt llogarisë së shoqërisë ose e anasjelltas, referuar Kodit Civil i miratuar me Ligjin Nr.7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar, nenet 1050-1055, Kreu XIX “Huaja”, cilësohet se huamarrësi duhet t’i paguajë huadhënësit një interes në rastet kur ekziston një marrëveshjeve ndërmjet palëve.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji Nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 1050-1055, Kreu XIX “Huaja”; - Ligji Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; - Udhëzimi Nr.16 datë 18.6.2014 “Për transferimin e çmimit”.
Ndikimi/Efekti :	<p>Nga ana e inspektorit të kontrollit në vend, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit për verifikimin e transaksioneve të huadhënies dhe huamarrjes së shoqërive me ortakët.</p>
Shkaku:	<p>Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional.</p>
Rëndësia:	<p>E lartë.</p>
Rekomandimi:	<p>DRT. Durrës t’i propozojë Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve të hartojë një akt administrativ për analizimin e llogarisë së ortakut, kur konstatohen se jepen hua pa interes ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, bazuar në përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.</p>
4. Titulli gjetjes:	<p>Parregullsi të dala nga auditimi i raporteve të kontrollit, në lidhje me mungesën e rivlerësimit të situatës financiare dhe penalizimit, sipas legjislacionit tatimor nga ana</p>

	e inspektorëve.
Situata:	<p><i>Nga auditimi me përzgjedhje i 40 raporteve të kontrollit tatimor, në 11 subjekte nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur procedurat e kontrollit, mbi analizimin e situatës financiare dhe deklarimeve të subjektit, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr.192 datë 12.08.2020 më konkretisht:</i></p> <p><i>1. Për subjektin “E...” për vitin 2019 rezulton se, sasia në dalje nga magazina e lëndës polietilen prej 243,522 kg nuk rakordon me sasinë e shitur të polietilenit prej 238,523 kg, me një diferencë prej 4,999 kg polietilen të pa deklaruar në shitje me një çmim mesatar shitjeje prej 198.13 lekë/kg. Nga ana e inspektorit të kontrollit, nuk është analizuar dhe trajtuar kjo diferencë, por ka dalë në përfundimin se nga lëvizja materiale e lëndës së parë polietilen nuk ka diferenca materiale.</i></p> <p><i>Diferencat e mësipërme në shumën prej 990,452 lekë (4,999 kg * 198.13 lekë/kg), të trajtuara nga grupi i auditimit sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, neni 124, rezultojnë:</i></p> <p><i>Detyrimi për TVSH-në $990,452 * 20\% = 198,092$ lekë</i></p> <p><i>Gjobë 100% $198,092 = 198,092$ lekë.</i></p> <p><i>Detyrimi për Tatim Fitimin $990,452 * 15\% = 148,568$ lekë</i></p> <p><i>Gjobë 100% $148,568 = 148,568$ lekë.</i></p> <p><i>Për këtë rast, efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit vlerësohet se është në shumën 693,320 lekë.</i></p> <p><i>Nga analiza e kryer nga ana e inspektorit të kontrollit, shitjet e realizuara sipas klientëve dhe llojit të produktit për vitin 2017 rezulton se sasia në dalje nga magazina e lëndës polietilen prej 96,528 kg nuk rakordon me sasinë e shitur të polietilenit prej 99,732 kg, me një diferencë prej 3,204 kg polietilen të deklaruar në shitje, por të pa deklaruar si dalje nga magazina me një çmim mesatar shitjeje prej 188.22 lekë/kg. Nga ana e inspektorit të kontrollit, nuk është analizuar dhe trajtuar kjo diferencë, por është dalë në përfundimin se nga lëvizja materiale e lëndës së parë polietilen nuk ka diferenca materiale.</i></p> <p><i>Diferencat e mësipërme në shumën prej 603,062 lekë (3,204 kg * 188.22 lekë/kg), të trajtuara nga grupi i auditimit sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, neni 124 rezultojnë:</i></p> <p><i>Detyrimi për TVSH-në $603,602 * 20\% = 120,612$ lekë</i></p> <p><i>Gjobë 100% $120,612 = 120,612$ lekë.</i></p> <p><i>Detyrimi për Tatim Fitimin $603,602 * 15\% = 90,540$ lekë</i></p> <p><i>Gjobë 100% $90,540 = 90,540$ lekë.</i></p> <p><i>Për këtë rast efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 422,304 lekë.</i></p> <p><i>Nga verifikimi i llogarisë shpenzime amortizimi për periudhën 2017 rezulton se subjekti ka amortizuar aktivet materiale nën normën e lejuar për efekte fiskale në kundërshtim ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ” Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 22, pika 3, pika 5.</i></p> <p><i>Për vitin 2017, rezulton se subjekti nuk ka pasqyruar shpenzimet për amortizimin e aktiveve materiale në shumën 1,520,272 lekë, e cila duke u indeksuar me normën e fitimit 1.2% të shoqërisë për periudhën 2017 shkon në vlerën 1,538,515 lekë.</i></p>

Në zbatim të ligjit 9920 datë 18.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, germa "b", neni 72, germa "a" dhe neni 115, pika 1, janë llogaritur detyrimet përkatëse, të cilat rezultojnë:

Tatim Fitimi	1,538,515 x 15 %	=	230,777 lekë
Gjobe TF.....	230,777 lekë x 0.06% x 365 dite	=	50,540 lekë
TVSH	1,538,515 x 20 %	=	307,703 lekë
Gjobe TVSH	307,703 lekë x 0.06% x 365 dite	=	67,387 lekë
Shuma.....		=	656,407 lekë

Pra, paraprakisht vlerësohen të ardhura të munguara gjithsej 1,772,031 lekë, nga të cilat detyrime tatimore 1,096,292 lekë dhe 675,739 lekë gjobë tatimore.

2. Nga verifikimi i dosjes së kontrollit të subjektit "B..." SHPK rezulton se grupi i auditimit pasi analizoi dokumentacionin e paraqitur sqaron se leja e ndërtimit e paraqitur e lëshuar nga Bashkia Durrës me nr. 575 datë 23.07.2019 është në emër të një individi dhe jo në emër të shoqërisë "B... SHPK" e cila ka kërkuar rimbursimin. Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 20 "Rregulla të përgjithshme", pikës 4. Referuar bazës ligjore të sipërcituar nga ana e grupit të auditimit gjatë shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se në lejen e ndërtimit të miratuar nga ana e Bashkisë Durrës, është përcaktuar se leja e ndërtimit i referohet zhvilluesit të objektit si person i cili ka aplikuar me kartë identiteti, fakt i cili tregon në mënyrë të qartë se kemi të bëjmë me një individ i cili ka përfutur lejen e ndërtimit dhe jo me një subjekt të tatueshëm. Sqarojmë se individi dhe subjekti i tatueshëm "B... SHPK" janë dy entitete juridikisht të ndryshme, dhe për rrjedhojë me të drejta dhe detyrime tatimore të ndryshme nga njëra tjetra. Në këtë kuptim individi nuk mund të jetë në asnjë moment person i tatueshëm për efekt të TVSH-së dhe ti lind e drejta e rimbursimit të saj. Nga ana e inspektorit nuk është vepruar në përputhje me legjislacionin tatimor duke mos analizuar në asnjë rast në raportin e kontrollit dhe duke mos cituar lejen e ndërtimit. Gjithashtu nuk është verifikuar që në fazën e parë të kontrollit të dhënat e lejes së ndërtimit dhe ekzistenca e kushtit nëse kemi të bëjmë me një person të tatueshëm ose jo. Gjithashtu nuk ka një analizë të detajuar të situacioneve pjesore dhe përfundimtare për punimet e ndërtimit, si dhe nuk është verifikuar leja e ndërtimit, preventivi i punimeve për të faktuar kreditimin e TVSH -së së lindur nga blerjet e materialeve me qëllim realizimin e rikonstruksionit të godinës. Si përfundim, për rimbursimin në vlerën 10,748,989 lekë të konfirmuar nga inspektori në raportin e kontrollit, bazuar në informacionet e paraqitura në dosjen e kontrollit, subjektit i linden detyrime në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 115, pika 3, nga grupi i auditimit janë llogaritur detyrimet përkatëse;

Shuma e kërkuar për rimbursim: 10,748,989 lekë

Penalitet 20%: 2,149,797 lekë

Total Detyrimi: 12,898,786 lekë

Pra, vlerësohen paraprakisht 10,748,989 lekë detyrime tatimore dhe 2,149,797 lekë gjobë tatimore.

3. Nga auditimi i raportit të kontrollit të subjektit "K...M" SHPK, kosto e blerjes së mallrave është 5,469,650 lekë, ndërkohë vlera e shitjes është 3,664,000 lekë. Në zbatim të ligjit 9920 datë 18.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, germa "b", neni 72, germa "a" dhe neni 115, pika 1, janë llogaritur detyrimet përkatëse, të cilat rezultojnë si më poshtë:

Kosto 5,469,650 lekë * 10% (vlerë të shtuar) = 6,016,615 lekë

Diferenca 6,016,615 lekë - 3,664,000 lekë = 2,352,615 lekë

Detyrimi për TVSH-në 2,352,615 * 20% = 470,523 lekë

Gjobë 470,523 x 0.06% x 365 ditë = 103,044 lekë.

Detyrimi për Tatim Fitimin 2,352,615 * 15% = 352,892 lekë

Gjobë 148,568 * 0.06% x 365 ditë = 77,283 lekë.

Pra, vlerësohen paraprakisht të ardhura të munguara gjithsej 1,003,742 lekë, nga të cilat 823,415 lekë detyrime tatimore dhe 180,327 lekë gjobë tatimore.

4. Nga auditimi rezulton se për subjektin "D..." SHPK Subjekti ka deklaruar shpenzime të cilat duhet të klasifikohen si shpenzime të pazbritshme pasi nuk i shërbejnë aktivitetit dhe rezultojnë shpenzime të panjohura për blerjen e autoveturës bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar", neni 21

Detyrimi për Tatim Fitimin 2,750,559 * 15% = 412,583 lekë

Gjobë 412,583 * 0.06% x 365 ditë = 90,355 lekë.

Konstatohet se në zërin n). shpenzimet për paga shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, nuk janë kaluar nëpërmjet sistemit bankar.

Shpenzime për paga shpërblime për vitin 2020 janë në shumën 2,087,208 lekë.

Shpenzime për paga shpërblime për vitin 2021 janë në shumën 3,247,509 lekë.

Total shpenzime për pagat janë në shumën 5,334,717 lekë.

Detyrimi për Tatim Fitimin 5,334,717 * 15% = 800,207 lekë

Gjobë 412,583 * 0.06% x 365 ditë = 172,844 lekë.

Pra, vlerësohen paraprakisht 1,475 mijë lekë detyrime tatimore, nga të cilat 1,213 mijë lekë për Tatim Fitimin dhe 264 mijë lekë gjobë tatimore.

5. Nga auditimi i raportit të kontrollit, të subjektit "A..." SHPK konstatohet se në zërin "Konsum për vete" të vitit 2019 janë regjistruar bileta udhëtimi në vlerën 1,107,833 lekë, si dhe janë përfshirë shpenzimet e bëra për udhëtime për qëllime të biznesit, për të hapur treg të ri dhe për takime me furnitorë për furnizime. Në këtë zë është përfshirë edhe udhëtimi për pjesëmarrje në panairin e organizuar nga Hertz International Gjermani. Furnitori i këtij shërbimi është Shoqëria L. I. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, neni 21 dhe sipas përlllogaritjeve rezulton:

Detyrimi për Tatim Fitimin 784,065 * 15% = 117,609 lekë

Gjobë 117,609 * 0.06% x 365 ditë = 25,756 lekë.

Pra, vlerësohen paraprakisht gjithsej 143,365 lekë detyrime tatimore, nga të cilët 117,609 lekë detyrime tatimore për Tatim Fitimin dhe 25,756 lekë gjobë tatimore.

6. Nga auditimi i praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik) të subjektit “V..T..” SHPK konstatohet se:

- Nuk janë analizuar normativat e harxhimit të karburantit sipas km të përshkruara dhe normativave për 100/km ato analizohen me kontrollin për tatimin mbi fitimin.

Nuk është kryer analiza e harxhimit të karburantit dhe bilanci material për naftën e përdorur për të gjithë periudhën e kontrollit sipas km të përshkruara dhe normativave për 100/km sipas kartës teknologjike të mjeteve të kompanisë, harxhimi i karburantit në raport të rrugëve të kryera nga ana e subjektit për periudhën e kontrolluar.

Subjekti ka kryer blerje të cilat nuk i shërbejnë aktivitetit për të cilat nuk duhet të kreditohej TVSH në vlerën 435,545 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar”, neni 21, pasi ky mjet nuk i shërben aktivitetit direkt por është për përdorim vetjak për nevojat e përfaqësuesit ligjor të subjektit dhe si i tillë nuk duhet kredituar TVSH-ja.

Për veprimet e mësipërme në bazë të ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008, neni 115, për këtë diferencë që për vitin 2021 është 2,173,723 lekë penalitetet si më poshtë:

TVSH : 435,545 lekë

Gjobë TVSH (20%): 87,109 lekë

Total Detyrimi për 2021: 522,654 lekë

Pra, vlerësohen paraprakisht 522,654 lekë detyrime tatimore, nga të cilat 435,545 lekë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe 87,109 lekë gjobë tatimore.

7. Nga auditimi i praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik) të subjektit “G....” SHPK, konstatohet se nga kontrolli mbi tatim fitimin për vitin 2021, shpenzimet për qira janë deklaruar 280,000 lekë nga 770,000 lekë që është vlera e kontratës.

Për këtë diferencë për vitin 2021 prej 490,000 lekë llogariten penalitetet si më poshtë:

TF 15%: 73,500 lekë

Gjobë TF (21.9%): 15,876 lekë

Total Detyrimi për 2021: 89,376 lekë

Për vitin 2019 Kreditorë të tjerë në vlerën 3,400,000 lekë përfshijnë vlerën e kontributit të ortakut me vendim asambleje për likuiditetet në arkë, për pagesa dhe shpenzime rritjen e fondit të kompanisë.

Për vitin 2020 kreditorë të tjerë janë në vlerë 5,550,000 lekë, ku nuk janë analizuar dhe nuk është përgatitur informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumat të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “, neni 5, pika 1 dhe 2.

Pra, vlerësohen paraprakisht gjithsej 89,376 lekë detyrime, nga të cilët 73,500 lekë detyrime tatimore për Tatim Fitimin dhe 15,876 lekë gjobë tatimore.

8. Nga auditimi të subjektit “A....” SHPK, për vitin 2020 në zërin blerje nga furnitorë vendas për investime është njohur si shpenzim për blerje e një autoveture

Toyota në vlerën e tatueshme 4,341,800 lekë dhe TVSH në vlerën 868,360 lekë, e cila nuk i shërben aktivitetit të subjektit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 21, pasi ky mjet nuk i shërben aktivitetit direkt, por është për përdorim vetjak për nevojat e përfaqësuesit ligjor të subjektit dhe si i tillë nuk duhej kredituar TVSH-ja.

Për veprimet e mësipërme në bazë të ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008, neni 115, për vitin 2020: për 4,341,800 lekë penalitetet si më poshtë:

TF 15%: 651,270 lekë

Gjobë TF (21.9%): 142,628 lekë

TVSH : 868,360 lekë

Gjobë TVSH (20%): 190,170 lekë

Total Detyrimi për 2020: 1,852,428 lekë

Pra, vlerësohen paraprakisht gjithsej 1,852,428 lekë detyrime, nga të cilët 1,519,630 lekë detyrime tatimore dhe 332,798 lekë gjobë tatimore.

9. Nga verifikimi i dosjes së kontrollit të subjektit “T....” SHPK, rezulton se subjekti operon në fushën e përpunimit të materialeve plastike në formë primare, ku kryen importe të lëndës së parë nga jashtë (e tipit lëndë e parë plastike PE dhe lëndë e parë plastike PVC). Nga të dhënat e paraqitura në RPK të mbajtur nga Inspektori i Kontrollit citohet se për prodhimin e gatshëm përdoret lënda e parë e marrë nga magazina e cila futet në proces si dhe shoqëria ka hartuar skedën teknologjike sipas të cilës humbjet teknologjike llogariten 7%, por kartelat teknologjike janë të pa depozituara në organet tatimore, për rrjedhojë nisur nga fakti që mungojnë kartat teknologjike humbjet e deklaruar nga subjekti janë të pa dokumentuara.

Në faqen nr. 13 të RPK, është analizuar nga ana e Inspektorit bilanci material i shoqërisë për vitin 2020, 2021 dhe periudhën janar- mars 2022, për lëndët e para PE/kg, PVC/kg, Karbonat/kg, ngjyrues dhe stabilizant.

Nga verifikimi i bilancit material për vitin 2021 rezulton se për lëndën e parë PE/kg gjendja në fund të inventarit paraqitet në vlerën 50,326,323 lekë me kosto/njësi 84 lekë/kg dhe sasi 602,278 kg.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për vitin 2021 edhe pse sasia e gjendjes së lëndës së parë PE është dyfishuar në raport me vitin 2020 ka një ulje drastike të koston për njësi prej 84 lekë/kg, për rrjedhojë ka një situatë të nënvlerësimit të gjendjes kontabël të inventarëve të shoqërisë e cila analizohet duke ju referuar për analogji edhe vitit 2020.

Në gjendjen në fund të paraqitur në vitin 2020 kosto për njësi e lëndës së parë PE është 109 lekë/kg e cila vjen si rezultat i metodës FIFO, ku regjistrohet kosto për njësi sipas hyrjes së vitit në këtë rast në vlerën 109 lekë/kg.

Nga analiza e kryer nga ana e Grupit të Auditimit për vitin 2021, në RPK nuk është analizuar nga ana e inspektorit gjendja në fund e lëndës së parë PE, si dhe regjistrimi i koston për njësi që është bërë nga ana e shoqërisë. Për rrjedhojë nuk është përdorur pesha specifike midis sasive dhe kosto/njësi në çelje të vitit si dhe kosto/njësi e hyrjeve të vitit, duke kryer regjistrimin e saktë kontabël të kosto/njësi në fund të vitit, si më poshtë:

Pesha specifike sasi/kosto për njësi për hyrjet e vitit: sasi hyrje 2,160,215 kg / (sasi çelje 398,524 kg + sasi hyrje 2,160,215 kg) = 0.844 %;

Pesha specifike sasi/ kosto për njësi për çeljet e vitit: $1 - 0.844 = 0.155$;

*Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për hyrjet e vitit: $0.844\% * 158$ lekë/kg = 133.3915 lekë/kg;*

*Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për çeljet e vitit: $0.156\% * 109$ lekë/kg = 16.97677 lekë/kg;*

Shuma e të dyjave do të duhej të ishte regjistrimi i kosto/njësi në fund të vitit ushtrimor: $(133.39 \text{ lekë/kg} + 16.98 \text{ lekë/kg}) = 150.37 \text{ lekë/kg}$.

Për sa më sipër nga ana e subjektit, si dhe në RPK kosto/njësi në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 84 lekë/kg e pa analizuar dhe e pa argumentuar, për rrjedhojë kemi ka një diferencë të kosto/njësi në vlerën $(150.37 \text{ lekë/kg} - 84 \text{ lekë/kg}) = 66.3 \text{ lekë/kg}$.

Nga analiza e kryer më sipër rezulton një nënvlerësim të inventarit kontabël në fund të vitit 2021 për lëndën e parë plastike PE me diferencë në çmim prej 66.3 lekë/kg, detyrimet si më poshtë:

*Sipas RPK, gjendja në 31.12.2021 për lëndë e parë PE/kg Sasi 602,278 kg * 84 lekë/kg = 50,326,323 lekë, vlera kontabël*

*Sipas Grupit të Auditimit, sasi 602,278 kg * 150.37 lekë/kg = 90,563,484 lekë, vlera kontabël e korrektuar.*

Nga diferenca e konstatuar si pasojë e nënvlerësimit të inventarëve të shoqërisë është kryer nga Grupi i Auditimit rikarakterizimi i situatës, bazuar në Ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”, germa (b), si dhe bazuar në nenin 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit” është kryer rivlerësimi sipas të cilit janë përlllogaritur detyrimet dhe gjokat e mësipërme në zbatim të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”.

Diferenca si pasojë e nënvlerësimit të inventarit rezulton në shumën $(90,563,484 \text{ lekë} - 50,326,323 \text{ lekë}) = 40,237,161 \text{ lekë}$

Për këtë diferencë për vitin 2021 prej 40,237,161 lekë edhe penalitetet si më poshtë:

TF 15%: 6,035,574 lekë

Gjobë TF (21.9%): 1,321,791 lekë

TVSH 20%: 8,047,432 lekë

Gjobë TVSH (21.9%): 1,762,388 lekë

Total Detyrimi për 2021: 17,167,185 lekë

Pra, vlerësohen paraprakisht 17,167,185 lekë gjithsej detyrime nga të cilët 14,083,006 lekë detyrime tatimore dhe 3,084,179 lekë gjobë tatimore.

10. Nga verifikimi i dosjes së kontrollit të subjektit “A....” SHPK, rezulton se artikulli “Transformator tensioni” me vlerë kontabël prej 14,152,754 lekë përbën peshën kryesore të inventarit kontabël të shoqërisë konkretisht në masën 71%. Për rrjedhojë u krye një analizë e thelluar e bilancit material në lidhje me kartelën inventarit “Transformator tensioni”.

Nga auditimi rezulton se për këtë artikull është kryer dalje gjatë vitit ushtrimor 2016 nga ana e shoqërisë për 196 copë me çmim 154,935 lekë dhe vlerë kontabël

30,367,276 lekë. Çmimi i aplikuar në dalje paraqitur në bilancin material është dukshëm më i ulët se kosto/njësi paraqitur të hyrjet e vitit prej 167,380 lekë si dhe kosto/njësi paraqitur të çeljet e vitit prej 156,823 lekë.

Nga ana e inspektorit në RPK nuk është kryer një analizë e thelluar dhe e qartë mbi aplikimin e shoqërisë të çmimit për daljet e vitit të paraqitur në bilancin material të shoqërisë, ku rezulton më i ulët për artikullin kryesor të inventarit kontabël. Për rrjedhojë nga ana e inspektorit duhej të ishte kryer një test analitik mbi çmimet e aplikuara nga shoqëria nëse janë paraqitur saktë dhe të mos jenë nën kosto.

Nga ana e Grupit të Auditimit është përdorur metoda FIFO, për të përllogaritur çmimin që duhej të aplikohet nga subjekti për artikullin “Transformator tensioni”, konkretisht si më poshtë:

Diferenca në çmim: Kosto/njësi hyrjet e vitit 167,380 lekë – çmim dalje në Bilanc Material 154,935 lekë = 12,445 lekë;

Marzhi i fitimit për vitin 2016: 23%;

Çmimi i rivlerësuar: (12,445 lekë * 23%) = 15,307 lekë;

Diferenca në vlerë: (196 copë * 15,307 lekë/copë) = 3,000,241 lekë.

Inspektori i kontrollit nuk ka bërë rivlerësimin e të ardhurave në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71.

Për diferencën e konstatuar për vitin 2016 prej 3,000,241 lekë penalitetet si më poshtë:

TF 15%: 450,036 lekë

Gjobë TF (0.06%/365): 98,558 lekë

TVSH 20%: 600,048 lekë

Gjobë TVSH (0.06%/365): 131,411 lekë

Total Detyrimi për 2016: 1,280,053 lekë

Në RPK të mbajtur nga ana e Inspektorit është hartuar bilanci material i vitit ushtrimor 2017, ku janë cilësuar artikujt e shoqërisë, gjendje në fillim, hyrjet e vitit, daljet e vitit si dhe gjendja në fund të periudhës me sasi të, kosto/njësi dhe vlerat kontabël.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se artikulli “Transformator tensioni” me vlerë kontabël prej 11,309,207 lekë përbën peshën kryesore të inventarit kontabël të shoqërisë konkretisht në masën 40%. Për rrjedhojë u krye një analizë e thelluar e bilancit material në lidhje me kartelën inventarit “Transformator tensioni”.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për vitin 2017 rezulton se kosto/njësi prej 124,277 lekë është dukshëm më e ulët se kosto/njësi në çelje prej 196,566 lekë si dhe kosto/njësi në hyrjet e vitit prej 142/752 lekë, për rrjedhojë kemi ka një situatë të nënvlerësimit të gjendjes kontabël të inventarëve të shoqërisë.

Nga analiza e kryer nga ana e Grupit të Auditimit për vitin 2017, në RPK nuk është analizuar nga ana e inspektorit gjendja në fund e artikullit “Transformator tensioni” si dhe regjistrimi i koston për njësi që është bërë nga ana e shoqërisë. Për rrjedhojë nuk është përdorur pesha specifike midis sasive dhe kosto/njësi në çelje të vitit si dhe kosto/njësi e hyrjeve të vitit, duke kryer regjistrimin e saktë kontabël të kosto/njësi në fund të vitit, konkretisht si më poshtë:

Pesha specifike sasi/kosto për njësi për hyrjet e vitit: sasi hyrje 302 / (sasi çelje 72

+ sasi hyrje 302) = 0.81%;

Pesha specifike sasi/ kosto për njësi për çeljet e vitit: $1 - 0.81 = 0.19 \%$;

*Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për hyrjet e vitit: $0.81 * 142,752$ lekë/copë = 115,270 lekë/copë;*

*Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për celjet e vitit: $0.19 * 196,566$ lekë/copë = 37,842 lekë/copë;*

Shuma e të dyjave do të duhej të ishte regjistrimi i kosto/njësi në fund të vitit ushtrimor: $(115,270 \text{ lekë/copë} + 37,842 \text{ lekë/copë}) = 153,112 \text{ lekë/copë}$.

Për sa më sipër nga ana e subjektit si dhe në RPK kosto/njësi në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 124,277 lekë/copë e pa analizuar dhe e pa argumentuar, për rrjedhojë kemi një diferencë të kosto/njësi në vlerën $(153,112 \text{ lekë/copë} - 124,277 \text{ lekë/copë}) = 28,835 \text{ lekë/copë}$.

Nga analiza e kryer më sipër rezulton se ka një nënvlerësim të inventarit kontabël në fund të vitit 2017 për artikullin “Transformator tensioni” me diferencë në çmim prej 28,835 lekë/copë, ku edhe detyrimet si më poshtë:

*Sipas RPK, gjendja në 31.12.2017 për artikullin Transformator Tensioni Sasi 91 copë * 124,277 lekë/copë = 11,309,207 lekë, vlera kontabël*

*Sipas Grupit të Auditimit Sasi 91 copë * 28,835 lekë/copë = 2,623,978 lekë, vlera kontabël e korrektuar*

Nga diferenca e konstatuar si pasojë e nënvlerësimit të inventarëve të shoqërisë është kryer nga Grupi i Auditimit rikarakterizimi i situatës, bazuar në Ligjin 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, germa (b) si dhe bazuar në nenin 72 është kryer rivlerësimi sipas të cilit janë përlogaritur detyrimet dhe gjobat e mëposhtme në zbatim të nenit 115 pika 1. Diferenca si pasojë e nënvlerësimit të inventarit rezulton në shumën $(90,563,484 \text{ lekë} - 50,326,323 \text{ lekë}) = 2,623,978 \text{ lekë}$

Për diferencën e konstatuar për vitin 2017 në shumën prej 2,623,978 lekë penalitetet si më poshtë:

<i>TF 15%:</i>	<i>393,597 lekë</i>
<i>Gjobë TF (21.9%):</i>	<i>86,198 lekë</i>
<i>TVSH 20%:</i>	<i>524,796 lekë</i>
<i>Gjobë TVSH (21.9%):</i>	<i>114,930 lekë</i>
<i>Total Detyrimi për 2017:</i>	<i>1,119,521 lekë</i>

Pra, vlerësohen paraprakisht gjithsej 2,399,574 lekë, nga të cilët 1,968,477 lekë detyrime tatimore dhe 431,097 lekë gjobë tatimore.

11. Nga verifikimi i dosjes së kontrollit të Personit fizik “M.K” operon në fushën e Hotelerisë dhe Strukturave të ngjashme, ku ka kërkuar rimbursimin e TVSH-së për periudhën 05/2019 – 12/2020 në vlerën 14,059,317 lekë. Nga ana e Grupit të Auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts në lidhje me personin fizik “M.K” ku ka rezultuar se: 1. Leje ndërtimi me nr. 1233, datë 19.06.2019 për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, nga ana e Bashkisë Kavajë, i është dhënë kjo leje ndërtimi për zhvilluesin M.K me **NID/F...H**, të cilit i lejohet ndërtimi i objektit për ndryshim projekti gjatë ndërtimit në objektin Hotel 5 kate + papafingo + bodrum sipas kushteve:

Sipërfaqe e parcelës e zënë nga parkimi: 249.8 m²

Sipërfaqe totale e ndërtimit: 2317.7 m²

	<p>Afati i lejes është i vlefshëm për një periudhë 25 mujore nga data e fillimit të punimeve referuar grafikut të punimeve</p> <p>2. Leje ndërtimi me nr. 1978, datë 12.10.2020 për objektin pishinë në funksion të hotelit, nga ana e Bashkisë Kavajë, i është dhënë kjo leje ndërtimi për zhvilluesin M.K me NID/F...H, të cilit i lejohet ndërtimi i pishinë në funksion të hotelit sipas kushteve:</p> <p>Sipërfaqe e truallit: 500 m² Sipërfaqe e ndërtimit gjurma: 250 m²</p> <p>Afati i lejes është i vlefshëm për një periudhë 12 mujore nga data e fillimit të punimeve referuar grafikut të punimeve</p> <p>Nga të dhënat e cituara më sipër rezulton se nga lejet e ndërtimit të dhëna nga Bashkia Kavajë janë miratuar punimet për zhvilluesin M.K si individ me NID, dhe jo si person fizik me NIPT, për rrjedhojë zhvilluesit M.K nuk i lind e drejta e kreditimit të TVSH-së për shkak se nuk jemi në kushtet e një personi të tatueshëm. Nga lejet e ndërtimit të miratuara nga ana e Bashkisë Kavajë për të qenë në kushtet e një personi të tatueshëm duhej të ishin në favor të zhvilluesit të paraqitur me NIPT dhe i regjistruar në organet tatimore.</p> <p>Në RPK, e mbajtur nga Inspektori nuk janë analizuar lejet e ndërtimit si dhe të ishin verifikuar zhvilluesi i miratuar në këto leje ndërtimi nëse është person i tatueshëm dhe më pas të procedohej me kërkesën për rimbursim të paraqitur nga zhvilluesi M.K.</p> <p>Kreditimi i TVSH i saktësuar nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është në përputhje me Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 20 “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes”, pika 3 “Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim”, ku citohet se: <i>-pika 4.</i></p> <p>Për rrjedhojë e gjithë shuma e kërkuar prej 14,059,317 lekë për rimbursim nuk duhej proceduar nga Inspektori në RPK, subjektit i lindi detyrime në zbatim të <i>pikës 3, të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë llogaritur detyrimet përkatëse.</i></p> <p>Shuma e kërkuar për rimbursim: 14,059,317 lekë TVSH 20%: 2,811,863 lekë Total Detyrimi: 16,871,180 lekë</p> <p>Pra, vlerësohen paraprakisht 14,059 mijë lekë detyrime tatimore dhe 2,812 mijë lekë gjobë tatimore.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, neni 72, neni 115, neni 124; - Ligji nr.92/2014 datë 24.07.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” neni 74; - VKM nr 469 “Për përcaktimin e vlerës minimale të cmimet të referencave të qirave të ndërtimit për qëllime tatimore”, pika 2 - UMF nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar. - Udhëzimi Nr.5, datë 30.01.2006 për “Tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar pika 3.6; - Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, neni 8, neni 55;

	<p>- Rregullore e Funkcionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër Nr.1482/2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave;</p> <p>- Rregulloren e Funkcionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr.192 datë 12.08.2020; Neni 59 Pika 1. Neni 58 Pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8. Neni 57 Pikat 2, 7. Neni 4</p> <p>Pikat 3, 10, 11, 18.</p> <p>- Manuali i Kontrollit Tatimor, kapitulli VII</p>
Ndikimi/Efekti :	Nga ana e inspektorëve të kontrollit operacional, nuk është kryer rivlerësimi i situatës financiare të subjekteve dhe penalizimi sipas legjislacionit tatimor, duke shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e Sektorit të Kontrollit Operacional, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandimi:	Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, referuar dosjeve përkatëse të kontrollit, për të cilat janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën gjithsej prej 56,196,310 lekë, nga të cilët detyrime tatimore 46,138,570 lekë dhe 10,057,740 lekë gjobë tatimore për plotësim të pasaktë të deklaratës tatimore.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:

- Ligji 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar, Neni 114/1.
- Ligji 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 71,
- Rregullore e Funkcionimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, miratuar nga MFE me Urdhër nr.19, datë 22.02.2017, i ndryshuar.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:

- znj. D.T në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore.
- z. D.XH në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimor.
- Z. A.M në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.
- z. A.C në cilësinë e inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.
- z. S.S në cilësinë e inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.
- z. V.K në cilësinë e inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.
- z. A.C në cilësinë e inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.
- z. G.Lj në cilësinë e inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.
- znj.F.Y në cilësinë e inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.
- znj. D.B në cilësinë e inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.
- znj. E.C në cilësinë e inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.
- znj. R.D në cilësinë e inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.
- znj. E.G në cilësinë e inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.
- znj. S.Q në cilësinë e inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.
- z. N.SH në cilësinë e inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.

III.2.3. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, të veprimitarisë së Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve”

-Detyrat sipas rregullores dhe manualit

-Klasifikimi i subjekteve (aktiv/pasiv/ të regjistruar/të çregjistruar/ të pezulluar etj) për periudhën objekt auditimi

-Vërtetimet që janë lëshuar për subjektet në lidhje me detyrimet

-Korrespondenca me Qendrën kombëtare të Regjistrimit

Cdo dokumentacion e cilësuar e nevojshme për përpunimin e materialit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT. Durrës është e organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonale” miratuar më urdhërin nr.192 datë 12.08.2020.

Drejtorja e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve Durrës në zbatim të detyrave funksionale për vitet 2021-2022 është fokusuar kryesisht në përpunimin e kërkesave për vërtetime, dhënien e asistencës, dhënien e fjalëkalimeve, dërgimin e njoftimeve subjekteve të ndryshme, edukimin dhe informimin e subjekteve me bazën ligjore.

Sipas të dhënave të ofruara nga DSHT, në zbatim të neneve 5, 6, 7 dhe 8 të Rregullores së brendshme për funksionimin e Zbatimit të Rregullores për ofrimin e asistencës dhe shërbimeve për Tatimpaguesit e regjistruar dhe individët nga funksioni i shërbimit të tatimpaguesve në DRT., Sektori i Shërbimit dhe Asistencës ka qënë i fokusuar kryesisht në:

Informimin e shpejtë dhe të saktë të tatimpaguesve, administrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme teknike brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Shërbimi dhe asistenca në këtë drejtori është dhënë kryesisht nëpërmjet email-it zyrtar, nëpërmjet telefonit, si dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me tatimpaguesit në ambientet e Drejtorisë Shërbimit, janë bërë nëpërmjet sqarimeve verbale apo shpërndarjes së broshurave informuese mbi mënyrën e deklaramit, përpilimit të librave të shitblerjes etj., si dhe janë dhënë sqarime të nevojshme në lidhje me paqartësitë e tatimpaguesve rreth situatave të tyre financiare në sistemin tatimor.

Detyrat kryesore të kësaj strukture janë: Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT. sipas Manualit të Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues ka si objektiva/parime/detyra kryesore:

- Parimin për zbatimin e njëjtë dhe efektiv të legjislacionit për të gjithë tatimpaguesit.
- Vetëvlerësimin dhe vetdeklarimin e detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit.
- Nxitjen e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor, nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve nënligjore.

Strukura

Struktura e DSHT ka funksionuar në zbatim “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonale” miratuar më urdhërin nr.192 datë 12.08.2020.

Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT. ka të miratuar në strukturë aktualisht 20 punonjës: *1 Drejtor Drejtorie, 2 përgjëgjës sektori, 17 specialistë.*

Analizat vjetore

Kjo Drejtori ka zhvilluar analizat vjetore për vitin 2021 me anë të shkresës me nr 507 Prot të datës 25.01.2022 dhe për vitin 2022 me anë të shkresës me nr 177/1 Prot të datës 12.01.2023.

Gjithashtu DSHT ka zhvilluar planin operacional për vitin 2021 me anë të shkresës me nr 220/1 Prot të datës 22.01.2021 dhe për vitin 2022 me anë të shkresës me nr 506 Prot të datës 25.01.2022.

Nga analizimi i veprimtarisë së kësaj Drejtorie për vitet 2021-2022 u konstatua si në vijim:
Përgjatë vitit 2021 ka patur në total 7.966 regjistrime të reja subjektesh nga të cilët: 127 BM, 284 BV me TVSH, 1571 BV dhe 987 Fermer.

Janë konstatuar 1863 pezullime nga të cilat: 253 i përkasin subjekteve BM, 227 BV+TVSH, 1379 BV. Kanë aplikuar për çregjistrim 807 subjekte nga të cilët 57 BM, 70 BV+TVSH, 654 BV dhe 24 fermer. Në fund të 2021 numri i subjekteve aktivë rezulton 24,559 nga 18,354 që rezultonin në 01.01.2021, pra një rritje me 6.205 subjekte.

Përgjatë vitit 2022 ka patur në total 4.555 regjistrime të reja subjektesh nga të cilët: 173 BM, 256 BV me TVSH, 1723 BV dhe 1.273 prej tyre Fermer. Janë konstatuar 1.981 pezullime nga të cilat: 282 BM, 198 BV+TVSH, 1.496 BV dhe 5 pezullime entesh. Kanë aplikuar për çregjistrim 774 subjekte nga të cilët 42 BM, 54 BV+TVSH, 584 BV dhe 94 fermer. Në fund të vitit 2022 numri i subjekteve aktivë rezulton 27,415 nga 24,559 që rezultonin në 01.01.2022, pra një rritje me 2.856 subjekte.

Në lidhje me ndryshimet e e përgjegjësitë TVSH dhe Tatim Fitimit sipas subjekteve

Gjatë vitit 2021 rezultojnë 837 ndryshime përgjegjësish nga të cilët 294 subjekte kanë kaluar me Tatim Fitimi dhe 543 prej tyre me TVSH.

Gjatë vitit 2022 rezultojnë 981 ndryshime përgjegjësish nga të cilët 570 subjekte kanë kaluar me Tatim Fitimi dhe 411 me TVSH.

Në lidhje me çregjistrimet e subjekteve situata paraqitet si në vijim:

Në lidhje me çregjistrimet e subjekteve, gjatë vitit 2021 kanë aplikuar për çregjistrim 807 subjekte dhe janë çregjistruar 264 prej tyre. Numri më të lartë të aplikimeve për çregjistrim e zënë BV me 654 aplikime.

Në lidhje me çregjistrimet e subjekteve, gjatë vitit 2022 kanë aplikuar për çregjistrim 774 subjekte dhe janë çregjistruar 164 prej tyre. Numri më të lartë të aplikimeve për çregjistrim e zënë BV me 584 aplikime.

-Nga auditimi konstatohet se në 7 raste (sipas aneksit nr.5.1) është tejkualuar nga ana e DRT. Durrës afati 10 ditor i kthimit të përgjigjes ndaj Qendrës Kombëtare të Biznesit përsa i përket verifikimit të situatës tatimore të tatimpaguesit i cili ka aplikuar për çregjistrim që plotësonte kushtet për çregjistrim.

- Nga auditimi konstatohet se në 208 raste (sipas aneksit nr.5.2) janë çregjistruar subjektet nga ana e Qendrës Kombëtare të Biznesit të cilat kanë aplikuar për çregjistrim por rezultojnë ende në proces çregjistrimi nga ana e DRT. Durrës pas periudhës së auditimit, me verifikim post factum (pas çregjistrimit nga ana e QKB) nga ana e DRT. Durrës si pasojë e tejkualimit të afatit 10 ditor të kthimit të përgjigjes ndaj Qendrës Kombëtare të Biznesit.

-Referuar subjekteve që kanë aplikuar për çregjistrim por që rezultojnë ende në proces çregjistrimi nga ana e DRT. Durrës pas periudhës së auditimit, konstatohet nga auditimi se në 48 raste (sipas aneksit nr.5.3) janë çregjistruar nga ana e Qendrës Kombëtare të Biznesit subjektet të cilat kanë aplikuar për çregjistrim, por që rezultojnë me detyrime dhe nuk plotësonin kushtet për çregjistrim, si pasojë e tejkualimit të afatit të kthimit të përgjigjes nga ana e DRT. Durrës ndaj Qendrës Kombëtare të Biznesit.

-Nga auditimi konstatohet se nga 8 subjektë të çregjistruata që i përkisnin përgjegjësishë tatimore Tatim Fitimi (sipas aneksit nr.5.4), për 7 subjekte (sipas aneksit nr.5.5) nuk është kryer kontrolli tatimor i thelluar në mjediset e subjektit dhe gjithashtu nuk është realizuar analiza e riskut për të vlerësuar nëse është e nevojshme të ushtrohet ky kontroll.

Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 3.3 të nenit 45 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë i ndryshuar" dhe

me pikën 45.3 dhe 45.4 të Udhëzimit Nr.24 datë 02.09.2008 të ndryshuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Të dhëna të përgjithshme në lidhje me veprimtarinë e kësaj Drejtorie paraqiten si në vijim: Gjatë vitit 2021, në Drejtorinë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, në shërbim të problematikave dhe nevojave të hasura nga individë dhe subjekte të ndryshme, në këtë drejtori janë paraqitur në total 48 kërkesa. Numrin më të lartë të kërkesave e zënë vërtetimet për pagesën e detyrimeve tatimore. Numri total i tyre përbëhet nga 25 kërkesa. Vazhdon me vërtetimet kontribut individual të punonjësve me 22 të tilla.

Gjatë vitit 2022, në Drejtorinë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, në shërbim të problematikave dhe nevojave të hasura nga individë dhe subjekte të ndryshme, në këtë drejtori janë paraqitur në total 74 kërkesa. Numrin më të lartë të kërkesave e zënë vërtetimet për kontributet individuale të punonjësve, numri total i tyre përbëhet nga 52 kërkesa. Vazhdon me vërtetimet për pagesën e detyrimeve tatimore me 21 të tilla.

LLOJI I KOMUNIKIMIT	Numri i rasteve 2021	Numri i rasteve 2022
Asistuar Tatimpaguesit nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve rutinë të tyre kryera on line në Sistemin C@TS.	10415	7905
Vizita në ambientet e tatimpaguesve Sqarimi dhe trajnimi i Biznese të vogla regjistruar në TVSH.	858	224
Sqarime në këndin e asistencës së biznesit vogël me TVSH		
Seminare të hapura	67	
Vizita në ambientet e tatimpaguesve për sensibilizimin e tatimpaguesve në lidhje me përdorimin e kuponit tatimor për çdo shitje me lekë në dorë.	5926	1538
Vizita në ambientet e tatimpaguesve me qëllimin e Informimit të tatimpaguesve për deklarimin e aktit të pronësisë apo kontratës së qerasë për vendin e ushtrimit të aktivitetit të tyre.	481	296
Vizitave për informimin tatimpaguesve të rinj me procedurat që duhet të ndjekin për zbatimin e legjislacionit fiskal	1425	1382
Te tjera		
TOTALI	19172	11345

Burimi: Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues (Përpunuar nga KLSH)

Për sa më sipër konstatohet se për periudhën objekt auditimi numrin më të lartë në veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues e zënë asistimet kundrejt Tatimpaguesve nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve të kryera online në Sistemin C@TS, sqarimet në këndin e asistencës së biznesit të vogël dhe gjithashtu njoftimet e ndryshme për korrigjim vullnetar, fiskalizimin etj.

Fjalëkalime për C@TS	Nr
Viti 2021	51
Viti 2022	48

Vërtetime Individësh	Drejtoria e Shërbimit nga Tatimpaguesve (Nr)	Portali E-Albania (Nr)
Viti 2021	688	8101
Viti 2022	430	9243

Burimi: Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues (Përpunuar nga KLSH)

Për sa më sipër konstatohet se numri i vërtetimeve të dhëna për individët nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues zë 8 % të totalit për vitin 2021 dhe 4.5% të totalit për vitin 2022. Kjo kryesisht për faktin e nxjerrjes së Urdhërit të KM nr 153 datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 1.1.2020”. Megjithatë ende vijohet të lëshohen vërtetime me vulë të njomë edhe përpos faktit që Portali E-Albania është konceptuar dhe ofron mundësinë e marrjes së këtij shërbimi.

Në lidhje me transferimet e subjekteve nga DRT. e tjera në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës dhe anasjelltas:

Në lidhje me transferimet e subjekteve nga DRT. e tjera në DRT. Durrës për vitin 2021 rezultojnë 80 të tilla dhe për vitin 2022 rezultojnë 101 subjekte.

Në lidhje me transferimet e subjekteve nga DRT. Durrës në DRT. e tjera për vitin 2021

rezultojnë 149 të tilla dhe për vitin 2022 rezultojnë 134 subjekte.

- Për sa më sipër mban përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre

- Znj. D.T., në cilësinë e Drejtores së Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës

- Z. D.XH, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në cilësinë personit përgjegjës për respektimin e afateve ligjore të kontrollit për tatimpaguesit që janë në procedura crregjistrimi në QKB

- Z. A.M me detyrë Përgjegjës i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, në cilësinë e personit përgjegjës për respektimin e afateve ligjore të kontrollit për tatimpaguesit që janë në procedura crregjistrimi në QKB

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi Nr.8, datë 31.03.2023.

Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i dispozitave ligjore dhe nën ligjore në crregjistrimin e subjekteve
Situata:	<p>Nga auditimi konstatohet se në 7 raste (sipas aneksit nr.5.1) nga ana e DRT Durrës është tejkaluar afati 10 ditor i kthimit të përgjigjes ndaj Qendrës Kombëtare të Biznesit përsa i përket verifikimit të situatës tatimore të tatimpaguesit i cili ka aplikuar për crregjistrim që plotësonte kushtet përkatëse.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se në 208 raste (sipas aneksit nr. 5.2) janë crregjistruar subjektet nga ana e Qendrës Kombëtare të Biznesit të cilat kanë aplikuar për crregjistrim, por rezultojnë ende në proces crregjistrimi nga ana e DRT Durrës pas periudhës së auditimit, me verifikim post factum (pas crregjistrimit nga ana e QKB) si pasojë e tejkalimit të afatit 10 ditor të kthimit të përgjigjes ndaj Qendrës Kombëtare të Biznesit.</p> <p>Referuar subjekteve që kanë aplikuar për crregjistrim por që rezultojnë ende në proces crregjistrimi nga ana e DRT Durrës, konstatohet se në 48 raste (sipas aneksit nr. 5.3) janë crregjistruar nga ana e Qendrës Kombëtare të Biznesit subjektet të cilat kanë aplikuar për crregjistrim, por që rezultojnë me detyrime dhe nuk plotësonin kushtet për crregjistrim, si pasojë e tejkalimit të afatit të kthimit të përgjigjes ndaj Qendrës Kombëtare të Biznesit.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se nga 8 subjekte të crregjistruara që i përkisnin përgjegjësisë tatimore Tatim Fitimi (sipas aneksit nr. 5.4) dhe për 7 subjekte (sipas aneksit nr. 5.5) nuk është kryer kontrolli tatimor i thelluar në mjediset e subjektit, si dhe nuk është realizuar analiza e riskut për të vlerësuar nëse është e nevojshme të ushtrohet ky kontroll.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 3.3 të nenit 45 Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar" dhe me pikën 45.3 të Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 të ndryshuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar", neni 45 pika 3.3. - Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 të ndryshuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pika 45.3
Ndikimi/Efekti:	Crregjistrimi i subjekteve nga ana e Qendrës Kombëtare të Biznesit të cilat nuk plotësojnë kushtet e crregjistrimit, me pasoja në cilësinë e shërbimeve ndaj tatimpaguesit dhe në t1 ardhurat buxhetore.
Shkaku:	Tejkalimi i afatit kohor të kthimit të përgjigjes nga ana e DRT. Durrës
Rëndësia:	E lartë

Rekomandimi:	Drejtori rajonal të nxjerrë përgjegjësitë për tejkalimet e afateve kohore të komunikimit midis DRT Durrës dhe QKB-së, si dhe të përcaktojë ditët e punës të kthimit të përgjigjes midis Drejtorive përkatëse. Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të marrë masë që për subjektet që kanë aplikuar për çregjistrim që i përkasin përgjegjësisë tatimore Tatim Fitimi të realizojë analizën e riskut në mënyrë të tillë që të vlerësohet nëse është i nevojshëm një kontroll tatimor i thelluar në mjediset e subjektit.
---------------------	--

III.2.4. Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në ekzekutimin e buxhetit vjetor, për periudhën nën auditim

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Regjistri realizimeve dhe parashikimit të prokurimeve publike për vitet 2021 dhe 2022.

-Dosjet e procedurave të prokurimeve.

-Dosjet e punonjësve (akt emërimi/diploma);Listëpagesat; Urdhër shpenzimet, Borderotë, pasqyrat financiare dhe çdo informacion justifikues/vërtetues që është gjykuar i nevojshëm gjatë auditimit, vënë në dispozicion nga struktura e Financës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet që:

-Me anë të shkresës me nr. 2690 Prot të datës 15.02.2021 dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është miratuar detajimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente për vitin 2021 për Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës.Ndërkohë me anë të shkresës me nr.22026/2 Prot të datës 16.12.2022 dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është miratuar pakësimi I fondeve për shpenzimet korrente për Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës.

-Me anë të shkresës me nr. 585 Prot të datës 27.01.2022 dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është miratuar detajimi I fondeve buxhetore për shpenzimet korrente për vitet 2022-2024.Ndërkohë me anë të shkresës me nr.2696 Prot të datës 18.03.2022 dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është miratuar pakësimi i fondeve për shpenzimet korrente për Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës.Gjithashtu me anë të shkresës me nr.8729/6 Prot të datës 01.06.2022 dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është miratuar pakësimi i fondeve për shpenzimet korrente për Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës. Gjithashtu me anë të shkresës me nr.19275/4 Prot të datës 07.11.2022 dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është miratuar pakësimi I fondeve për shpenzimet korrente për Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës.

-Shpenzimet sipas llogarisë.602, në zërin “Blerje mallra e shërbime” për vitet 2021 -2022, janë si më poshtë:

-Referuar shpenzimeve sipas llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” konstatohet se përgjatë vitit 2021 janë shpenzuar 7,499,164 lekë Nga të cilat 1,010,785 lekë janë zhvilluar nëpërmjet procedurave të prokurimit(8 copë) të cilat janë audituar në masën 100%. dhe 6,488,379 lekë rezultojnë si shpenzime energjie,uji,telefoni,poste, sigurim automjetesh,takse,diete, ,shpenzime gjyqësore,shpenzime të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit publik dhe janë audituar në masën 59,7%.

Referuar shpenzimeve për pagesa “shpenzime energjie” “shpenzime poste” “shpenzime për ujë” konstatohet se urdhërshpenzimet mujore shoqërohen me faturat tatimore shitëse përkatëse

Procedura Prokurimi:

1.Shërbim “Shpenzime për shërbime të tjera operative”

Procedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për shërbime të tjera operative” është pjesë e parashikimit të regjistrimit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.1029 Prot të datës 28.01.2021. Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.102 të datës

08.07.2021 e cila likuidon faturën me nr.37/2021 të datës 18.06.2021 të shitësit “A.C.” me vlerë 120,000 lekë .Me anë të proces-verbalit të datës 12.06 2021 të firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël shërbimi është marrë në dorëzim.

2.Shërbim “Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit”

Proçedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit” është pjesë e parashikimit të regjistrit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.1029 Prot të datës 28.01.2021. Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.133 të datës 15.09.2021 e cila likuidon faturën me nr.13/2021 të datës 16.08.2021 të shitësit “L.e St..” me vlerë 119,124 lekë.Me anë të proces-verbalit të datës 16.08 2021 të firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël shërbimi është marrë në dorëzim.

3.Mall “Blerje dokumentacioni”

Proçedura e prokurimit me objekt “Blerje dokumentacioni” është pjesë e parashikimit të regjistrit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.1029 Prot të datës 28.01.2021. Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.134 të datës 15.09 .2021 e cila likuidon faturën me nr.288/2021 të datës 16.08.2021 të shitësit “L...D...” me vlerë 119,880 lekë. Me anë të proces-verbalit të datës 16.08 2021 të firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël shërbimi është marrë në dorëzim.

4.Mall “Shpenzime për pastrim,dezifektim,ngrohje dhe ndricim”

Proçedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për pastrim,dezifektim,ngrohje dhe ndricim” është pjesë e parashikimit të regjistrit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.1029 Prot të datës 28.01.2021. .Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.140 të datës 17.09.2021 e cila likuidon faturën me nr.1418/2021 të datës 18.08.2021 të shitësit “M... SHPK” me vlerë 119,958 lekë.Me anë të proces-verbalit të datës 18.08 2021 të firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël malli është marrë në dorëzim.

5.Mall “Shpenzime për mirëmbajtje për objekte ndërtimore”

Proçedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtje për objekte ndërtimore” është pjesë e parashikimit të regjistrit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.1029 Prot të datës 28.01.2021. .Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.181 të datës 26.11.2021 e cila likuidon faturën me nr.1/2021 të datës 01.11.2021 të shitësit “P..Gj.. H...” me vlerë 120,000 lekë.Me anë të proces-verbalit të datës 01.11 2021 të firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël shërbimi është marrë në dorëzim.

6.Shërbim “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës”

Proçedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës” është pjesë e parashikimit të regjistrit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.1029 Prot të datës 28.01.2021. .Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.207 të datës 20.01 .2022 e cila likuidon faturën me nr.194/2021 të datës 30.12.2021 të shitësit “B... D...” me vlerë 120,000 lekë mbi riparimin e difekteve të kondicionerëve.

7.Shërbim “Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës”

Proçedura e prokurimit me objekt “Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës” është pjesë e parashikimit të regjistrit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.1029 Prot të datës 28.01.2021. .Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.208 të datës 20.01 .2022 e cila likuidon faturën me nr.292/2021 të datës 31.12.2021 të shitësit “A...-C....” me vlerë 120,000 lekë mbi riparimin e difekteve në lidhje me fotokopjet.

8.Shërbim “Shpenzime mirëmbajtje aparatura teknike dhe vëndit të punës”

Proçedura e prokurimit me objekt “Shpenzime mirëmbajtje aparatura teknike dhe vëndit të punës” është pjesë e parashikimit të regjistrit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës

me shkresën nr.1029 Prot të datës 28.01.2021. Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.209 të datës 20.01.2022 e cila likuidon faturën me nr.289/2021 të datës 30.12.2021 të shitësit "A...-C..." me vlerë 120,000 lekë mbi riparimin e difekteve në lidhje me printerat.

-Nga auditimi konstatohet se në 2 raste përgjatë vitit 2021(më konkretisht në procedurën "Shpenzime për shërbime të tjera operative dhe Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës") nga ana e DRT. Durrës është vepruar në kundërshtim me pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" ku cilësohet:

"Përpara se të nisnin një procedurë prokurimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të studiojnë tregun, me qëllim që të përgatisin prokurimin dhe të informojnë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim.Për këtë qëllim, autoriteti ose enti kontraktor mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg".

Në 2 rastet e evidentuara më sipër,autoriteti kontraktor nuk ka realizuar një studim të tregut dhe nuk ka marrë oferta të ndryshme nga operatorët ekonomikë përpara nisjes së procedurës së prokurimit.

-Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2021 titullari i autoritetit kontraktor përgjatë vitit 2021 ka vepruar në kundërshtim me pikën 3 të nenit 56 të VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku cilësohet:

"Titullari i autoritetit/entit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në fillim të vitit kalendarik, ngre një komision të veçantë, të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh, nga të cilët njëri është kryetar".

Në vitin 2021 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është ngritur më anë të urdhërit të brëndshëm nr 12 të datës 05.05.2021,duke tejkaluar afatet e paracaktuara në VKM-në e sipërcituar.

-Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2021 nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve në kundërshtim me pikën 42 të udhëzimit Nr. 30 të datës 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" të Ministrisë të Financave ku cilësohet: *"Titullari i njesise miraton urdherin per ngritjen e komisionit per marrjen ne dorezim te aktiveve te furnizuara per sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe te dokumentacionit shoqerues."*

-Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2021 në 2 procedura prokurimi ku më konkretisht, në procedurën:1)Shërbim "Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës",2)Shërbim "Shpenzime mirëmbajtje aparatura teknike dhe vëndit të punës" të fituara nga i njëjti operator ekonomik,objekti i veprimtarisë është i ngjashëm(riparime difekt printerash dhe fotokopjesh) dhe shumica e procedurave e prokuruar është mbi 100,000 lekë,duke mos u ndodhur në kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 11 të VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku cilësohet:

"Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit".

Përsa më sipër DRT. Durrës ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 të VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe me pikën 1 të udhëzimit numër 5 të datës 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" duke mos zhvilluar procedurën e prokurimit sipas parashikimeve ligjore dhe rrjedhimisht duke mos u zbatuar konkurrenca midis operatorëve ekonomikë.

“Autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime ,kur vlera e përllogaritur është ndëremjet kufinjve nga 100,000 deri në 1,000,000 lekë në vit.

-Referuar shpenzimeve “Blerje mallra e shërbime” konstatohet se përgjatë vitit 2022 janë shpenzuar 6,021,098 lekë.Nga të cilat 1,014,000 lekë janë zhvilluar nëpërmjet procedurave të prokurimit(9 copë) të cilat janë audituar në masën 100%. dhe 5,007,098lekë rezultojnë si shpenzime energjie,uji,telefoni,poste, sigurim automjetesh,takse,shpenzime gjyqësore,shpenzime të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit publik dhe janë audituar në masën 64,5%. Referuar shpenzimeve për pagesa “shpenzime energjie” “shpenzime poste” “shpenzime për ujë” konstatohet se urdhërshpenzimet mujore shoqërohen me faturat tatimore shitëse përkatëse.

Procedura Prokurimi:

1.Shërbim “Shpenzime për shërbime të tjera operative”

Proçedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për shërbime të tjera operative” ” është pjesë e parashikimit të regjistrimit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.503/1 Prot të datës 25.01.2022..Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.192 të datës 30.12.2022 e cila likuidon faturën me nr.376/2022 të datës 18.06.2021 të shitësit “B.. D...” me vlerë 100,000 lekë mbi riparimin e difekteve të kondicionerëve. Me anë të proçes-verbalit të datës 30.12.2022 të firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël shërbimi është marrë në dorëzim.

2.Shërbim “Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit”

Proçedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit” ” është pjesë e parashikimit të regjistrimit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.503/1 Prot të datës 25.01.2022. Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.94 të datës 01.07.2022 e cila likuidon faturën me nr.34/2022 të datës 02.06.2022 të shitësit “H... 2..” me vlerë 119,640 lekë.Me anë proçes-verbal të firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël të datës 02.06.2022 shërbimi është marrë në dorëzim.

3.Mall “Blerje dokumentacioni”

Proçedura e prokurimit me objekt “Blerje dokumentacioni” është pjesë e parashikimit të regjistrimit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.503/1 Prot të datës 25.01.2022 .Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.190 të datës 30.12.2022 e cila likuidon faturën me nr.431/2022 të datës 23.12.2022 të shitësit “L...” me vlerë 119,820lekë. Me anë proçes-verbal të firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël të datës 23.12.2022 malli është marrë në dorëzim.

4.Mall “Shpenzime për pastrim,dezifektim,ngrohje dhe ndricim”

Proçedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për pastrim,dezifektim,ngrohje dhe ndricim” është pjesë e parashikimit të regjistrimit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.503/1 Prot të datës 25.01.2022. .Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.97 të datës 13.07.2022 e cila likuidon faturën me nr.4820/2022 të datës 13.06.2022 të shitësit “M...” me vlerë 119,916 lekë.Me anë të proçes-verbalit të datës 13.06.2022 të firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël malli është marrë në dorëzim.

5.Mall “Shpenzime për libra e publikime profesionale”

Proçedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për libra e publikime profesionale” është pjesë e parashikimit të regjistrimit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.503/1 Prot të datës 25.01.2022 .Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.191 të datës 30.12.2022 e cila likuidon faturën me nr.104/2022 të datës 28.12.2022 të shitësit “G.... G..” me

vlerë 95,000lekë.Me anë të fletë hyrjes firmosur të datës 23.9.12.2022 malli është marrë në dorëzim.

6.Shërbim “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës”

Proçedura e prokurimit me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës” është pjesë e parashikimit të regjistrit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.503/1 Prot të datës 25.01.2022.Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.193 të datës 30.12 .2022 e cila likuidon faturën me nr.3184/2022 të datës 29.12.2022 të shitësit “M... O...” me vlerë 120,000 lekë mbi riparimin e difekteve të kondicionerëve. Me anë të proçes-verbalit të datës 29.12 2022 të firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël malli është marrë në dorëzim.

7.Shërbim “Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës”

Proçedura e prokurimit me objekt “Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës” është pjesë e parashikimit të regjistrit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.503/1 Prot të datës 25.01.2022. .Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.195 të datës 30.12 .2022 e cila likuidon faturën me nr.704/2022 të datës 30.12.2022 të shitësit “A...-C...” me vlerë 120,000 lekë mbi riparimin e difekteve në lidhje me fotokopjet.

8.Shërbim “Furnizime dhe materiale të tjera zyre të përgjithshme”

Proçedura e prokurimit me objekt “Furnizime dhe materiale të tjera zyre të përgjithshme” është pjesë e parashikimit të regjistrit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.503/1 Prot të datës 25.01.2022 .Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.200 të datës 31.12.2022 e cila likuidon faturën me nr.125/2022 të datës 31.12.2022 të shitësit “R.R.” me vlerë 99,954 lekë mbi blerje materialesh për pastrimin e zyrës.Me anë të proçes-verbalit të datës 31.12 2022 të firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël shërbimi është marrë në dorëzim.

9.Shërbim “Shpenzime mirëmbajtje aparatura teknike”

Proçedura e prokurimit me objekt “Shpenzime mirëmbajtje aparatura teknike” është pjesë e parashikimit të regjistrit të prokurimeve të dërguar nga ana e DRT. Durrës me shkresën nr.503/1 Prot të datës 25.01.2022 .Blerja është realizuar nëpërmjet urdhër shpenzimit nr.194 të datës 30.12.2022 e cila likuidon faturën me nr.703/2022 të datës 30.12.2022 të shitësit “A... C...” me vlerë 120,000 lekë mbi riparimin e printerave.Me anë të proçes-verbalit të datës 31.12 2022 të firmosur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël shërbimi është marrë në dorëzim.

Nga auditimi konstatohet se në 4 raste përgjatë vitit 2022(më konkretisht në procedurat “Shpenzime për shërbime të tjera operative”, Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit”, “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës” dhe “Furnizime dhe materiale të tjera zyre të përgjithshme”) nga ana e DRT. Durrës është vepruar në kundërshtim me pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku cilësohet:

“Përpara se të nisin një procedurë prokurimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të studiojnë tregun, me qëllim që të përgatisin prokurimin dhe të informojnë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim.Për këtë qëllim, autoriteti ose enti kontraktor mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg”.

Në 4 rastet e evidentuara më sipër,autoriteti kontraktor nuk ka realizuar një studim të tregut dhe nuk ka marrë oferta të ndryshme nga operatorët ekonomikë përpara nisjes së procedurës së prokurimit.

-Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2022 nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve në kundërshtim me pikën 42 të udhëzimit Nr. 30 të datës 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrit të Financave ku cilësohet:

“Titullari i njesise miraton urdherin per ngritjen e komisjonit per marrjen ne dorezim te aktiveve te furnizuara per sasinë, cilësinë, llojin, plotesine e tyre dhe te dokumentacionit shoqerues.”

-Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2022 në 2 procedura prokurimi ku më konkretisht, në procedurën:1)Shërbim *“Shpenzime për shërbime të tjera operative”* 2)Shërbim *“Shpenzime mirëmbajtje aparatura teknike dhe vëndit të punës”* të fituara nga i njëjti operator ekonomik,objekti i veprimtarisë është i ngjashëm(riparime difekt printerash dhe fotokopjesh) dhe shuma e procedurave e prokuruar është mbi 100,000 lekë,duke mos u ndodhur në kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 11 të VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* ku cilësohet:

“Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit”.

Përsa më sipër DRT. Durrës ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 të VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* dhe me pikën 1 të udhëzimit numër 5 të datës 25.06.2021 *“Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”* dukë mos zhvilluar procedurën e prokurimit sipas parashikimeve ligjore dhe rrjedhimisht duke mos u zbatuar konkurrenca midis operatorëve ekonomikë.

“Autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime ,kur vlera e përlllogaritur është ndëremjet kufinjve nga 100,000 deri në 1,000,000 lekë në vit”.

-Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2022 në 2 procedura prokurimi ku më konkretisht, në procedurën:1)Shërbim *“Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës”,2)Shërbim “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës”,*objekti i veprimtarisë është i njëjtë(riparime difekt kondicionerësh) dhe shuma e procedurave e prokuruar është mbi 100,000 lekë,duke mos u ndodhur në kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 11 të VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* ku cilësohet:

“Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit”.

Përsa më sipër DRT. Durrës ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 të VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* dhe me pikën 1 të udhëzimit numër 5 të datës 25.06.2021 *“Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”* dukë mos zhvilluar procedurën e prokurimit sipas parashikimeve ligjore dhe rrjedhimisht duke mos u zbatuar konkurrenca midis operatorëve ekonomikë.

“Autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime ,kur vlera e përlllogaritur është ndëremjet kufinjve nga 100,000 deri në 1,000,000 lekë në vit”.

- Shpenzime gjyqësore dhe përmbarimore për vitin 2021 dhe 2022 janë si më poshtë:

-Përsa i përket shpenzimeve gjyqësore dhe përmbarimore për vitin 2021 janë 1,592,781 lekë.

Në bazë të vendimit nr.283 të datës 18.02.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit,është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr.723 datës 20.07.2016 e gjykatës administrative e shkallës së parë Durrës.Në vendimin e mësipërm,DRT. Durrës duhet ti kthejë palës paditëse(E. B.)shumën prej 273,413 lekë dhe shpënzimet gjyqësore në vlerën 43,300 lekë. Me anë të urdhërshpenzimit nr 210 të datës 20.01.2022 në vlerën 316,713 lekë është likuiduar detyrimi i mësipërm. Gjithashtu me anë të urdhërshpenzimit nr 203 të datës 18.01.2022 në vlerën 30,000

lekë është paguar përmbaruesi gjyqësor “E.A.” për faturën e lëshuar me nr.7/2021 të datës 24.12.2021.

Në bazë të vendimit nr.4727 të datës 24.12.2018 të gjykatës administrative të apelit Tiranë,përmbaruesi gjyqësor privat “N. B.” me anë të shkresës me nr 1125 Prot të datës 18.01.2020 njofton DRT. mbi detyrimin prej 1,246,068 lekësh si detyrime gjyqësore dhe përmbarimore(palë paditëse M.A.. SHPK”).

Me anë të urdhërshpenzimit nr 81 të datës 17.06.2021 prej 300,000 lekësh është likuiduar një pjesë e detyrimit. Gjithashtu me anë të urdhërshpenzimit nr 205 të datës 18.01.2022 prej 537.400 lekësh dhe me anë të urdhërshpenzimit nr 211 të datës 20.01.2022 prej 408,668 lekësh është likuiduar pjesa e mbetur e detyrimit.

-Përsa i përket shpenzimeve gjyqësore dhe përmbarimore për vitin 2022 janë 283,282 lekë.

Në bazë të urdhrin të ekzekutimit nr.208 të datës 02.04.2013 të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë i lënë në fuqi me vendimin gjyqësor nr.2142 datë 20.09.2012 të gjykatës së Apelit Tiranë në lidhje me detyrimin në shumën 283.282 e DRT. Durrës ndaj Shoqërisë A.. (sot .) është realizuar likuidimi me anë të urdhërshpenzimit nr 164 të datës 17.11.2022 në vlerën 283,282 lekë

-Shpenzime për transferta për buxhete familjare e individe referuar shpërblimeve për punonjësit/ish punonjësit për vitin 2021 dhe 2022 janë si më poshtë:

Përsa i përket shpenzimeve për transferta për buxhete familjare për vitin 2021 rezultojnë në vlerën 352,000 lekë. Kjo vlerë vjen si rezultat i akordimit të fondit të vecantë për vitin 2021 si ndihmë e menjëhershme me rastin e daljes në pension të 4 ish punonjësve të DRT. Durrës. Në cdo rast praktikant shoqërohen me shkresën konfirmuese të Ministrisë së Financave dhe ekonomisë për akordimin e fondit dhe në të gjitha rastet është mbajtur tatimi në burim.

Përsa i përket shpenzimeve për transferta për buxhete familjare për vitin 2022 rezultojnë në vlerën 316,748 lekë. Kjo vlerë vjen si rezultat i akordimit të fondit të vecantë për vitin 2022 si ndihmë e menjëhershme me rastin e daljes në pension të 4 ish punonjësve të DRT. Durrës dhe në një rast vjen si rezultat i akordimit të fondit të vecantë për vitin 2022 si ndihmë e menjëhershme si rezultat i fatkeqësisë për një punonjës. Në cdo rast praktikant shoqërohen me shkresën konfirmuese të Ministrisë së Financave dhe ekonomisë për akordimin e fondit dhe në të gjitha rastet është mbajtur tatimi në burim.

-Fondet buxhetore për art.600, në zërin “Paga” dhe në art.601, në zërin “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” për vitet 2021 -2022, janë si më poshtë:

DRT. Durrës	Plani Vjetor			Shpenzimet Faktike			Diferenca
	Paga	Sigurime	Totali	Paga	Sigurime	Totali	
Viti 2021	82.256.000	13.944.000	96.200.000	81.685.024	13.640.694	95.325.718	874.282
Viti 2022	78.270.000	13.070.000	91.340.000	78.269.785	13.065.257	91.335.042	4.958
Totali	160.526.000	27.014.000	187.540.000	159.954.809	26.705.951	186.660.760	879.240

Në total për vitin 2021 shpenzimet për paga art 600-601 janë planifikuar në shumën 96,200,000 lekë dhe janë shpenzuar në shumën totale 95,325,718 lekë, me një realizim prej 99%, nga të cilat: 81,685,024 lekë për paga dhe 13,640,694 për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, detajuar në Aneksin nr.5.6.

Ndërkohë shpenzimet për zërin paga në vitin 2021 janë 81.148.504 lekë,diferenca shpjegohet pasi pagat e muajit dhjetor të vitit 2020 likuidohen në muajin janar të vitit 2021 dhe ato të muajit dhjetor të vitit 2021 likuidohen në muajin janar të vitit 2022.

Shpenzime per zërin paga	Paga Dhjetor 2020	Paga Dhjetor 2021	Paga Janar Dhjetor 2021
81.685.024	6.782.832	6.246.312	81.148.504

Shpenzimet për zërin sigurimet shoqërore dhe shëndetsore në vitin 2021 janë 13.551.513 lekë, diferenca shpjegohet pasi sigurimet në muajin dhjetor të vitit 2020 likuidohen në muajin janar të vitit 2021 dhe ato të muajit dhjetor të vitit 2021 likuidohen në muajin janar të vitit 2022.

Shpenzime për zërin sigurime shoqërore dhe shëndetsore	Sigurime dhjetor 2020	Sigurime dhjetor 2021	Sigurime Janar Dhjetor 2021
13.640.694	1.132.710	1.043.529	13.551.513

Në total për vitin 2022 shpenzimet për paga art 600-601 janë planifikuar në shumën 91,340,000 lekë dhe janë shpenzuar në shumën totale 91,335,042 lekë, me një realizim prej 99%, nga të cilat: 78,269,785 lekë për paga dhe 13,065,257 për sigurime shoqërore dhe shëndetsore, detajuar në Aneksin nr.5.7.

Ndërkohë shpenzimet për zërin paga në vitin 2022 janë 78.331.551 lekë, diferenca shpjegohet pasi pagat e muajit dhjetor të vitit 2021 likuidohen në muajin janar të vitit 2022 dhe ato të muajit dhjetor të vitit 2022 likuidohen në muajin janar të vitit 2023.

Shpenzime per zërin paga	Paga Dhjetor 2021	Paga Dhjetor 2022	Paga Janar Dhjetor 2022
78.269.785	6.246.312	6.308.078	78.331.551

Shpenzimet për zërin sigurimet shoqërore dhe shëndetsore në vitin 2022 janë 13.075.810 lekë, diferenca shpjegohet pasi sigurimet në muajin dhjetor të vitit 2021 likuidohen në muajin janar të vitit 2022 dhe ato të muajit dhjetor të vitit 2022 likuidohen në muajin janar të vitit 2023.

Shpenzime për zërin sigurime shoqërore dhe shëndetsore	Sigurime dhjetor 2021	Sigurime dhjetor 2022	Sigurime Janar Dhjetor 2022
13.065.257	1.043.529	1.054.082	13.075.810

Pagat e punonjësve të sistemit të tatimeve mbështeten në VKM nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” lidhja 1; lidhja 2 dhe lidhja 6/8.

Në funksion të auditimit të respektimit të dispozitave ligjore për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetsore, etj, grupi i auditimit auditoi në bazë risku praktikat dokumentare që shoqëronin shpenzimet e kryera përpara i përket pagave në muajt Prill 2021 dhe Janar 2022.

Punonjësit në strukturë

Prej vitit 2020 e në vijim Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin Nr.2830/47 , datë 22.07.2020 të Departamentit të Administratës Publike.

Nga 88 pozicione pune në strukturë përpara i përket strukturës së vitit 2021 e në vazhdim, 79 pozicione i përkasin punonjësve, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe 9 pozicione i përkasin punonjësve, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar. Nga analiza e listëpagesave të punonjësve të DRT. Durrës u konstatua se janë llogaritur konform përcaktimeve të VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të

pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”:

- Shtesa për pozicion (lidhja 1);
- Shtesa për kushte pune (lidhja 6/8).

Grupi i auditimit auditoi pagesat e kryera nga DRT. Durrës referuar punonjësve. Nga auditimi rezultoi se në të gjitha rastet dhe për të gjitha drejtoritë, përpiloheshin listëprezencat mujore të cilat nënshkrueshin nga titullarët e drejtorive. Bashkëlidhur listëprezencës gjendeshin raportet mjeksore të cilat ishin të reflektuara edhe në listëprezencë.

Listëpagësat hartoheshin të plota me të gjithë komponentët e pagës dhe ndalesave. Listëpagesat konfirmoheshin nga NA dhe NZ i institucionit. Grupi i auditimit testoi llogaritjen e pagës në raport me nivelin e diplomës.

Për sa më sipër u konstatua si në vijim:

Marrëdhëniet e punës në DRT. Durrës rregullohen me Ligjin nr.152/2013 i ndryshuar dhe Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar

Grupi i auditimit, auditoi mbi bazë risku, dokumentacionin e administruar në dosjet e punonjësve si dhe evidencat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse. U morën në shqyrtim 7 dosje të punonjësve që rezultojnë në marrëdhënie pune për gjatë periudhës objekt auditimi për verifikim të diplomës së tyre dhe pagesave të kryera në përputhje ose jo me pagën dhe kategorinë e diplomës dhe u konstatua se nga ana e strukturës së Financës janë paguar përgjithësisht në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për vitin 2021-2022.

Në lidhje me gjetjet e trajtuara në Raportin e auditimit është dërguar observacioni me nr 30/47 datë 31.05.2023 nga Z.S.S.,Znj.D. D. dhe Znj.E.Q.. Në mënyrë të përmbledhur observacionet shprehen mbi kundërshtitë i përket mungesës së analizës së tregut përpara fillimit të procedurës së prokurimit vjen për arsye se administrata tatimore disponon të dhënat e cmimeve të shërbimeve të tatimpaguesve.Referuar procedurës së prokurimit “Materiale per funksionimin e pajisjeve të zyrës” dhe “Shpenzime mirëmbajtje aparatura teknike dhe vendit të punës” vjen si pasojë e defekteve teknike të njëpasnjëshme.Referuar procedurës “Shpenzime operative” “Shpenzime mirëmbajtje aparatura teknike të vëndit të punës” janë kryer në kushtet e emergjencës.

Qëndrimi i grupit auditues:Observacioni për sa i përket mungesës së analizës së tregut si pasojë e disponimit të cmimeve nuk merret në konsideratë,pasi operatorë të ndryshëm mund të kenë oferta të ndryshme cmimesh në periudha të ndryshme.Observacioni referuar procedurave të prokurimit të sipërcituara merret pjesërisht në konsideratë pasi nuk është mbajtur i procesverbali i prokurimeve në rastet e emergjencës.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:

- Znj. D.T, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, në cilësinë e nënpunësit autorizues.
- Znj. D.D., me detyrë specialist në sektorin e financës në cilësinë e kryetares së komisionit të prokurimit përgjatë vitit 2021 dhe 2022.
- Z. A. B. në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit përgjatë vitit 2021.
- Znj,E. Q. me detyrë specialist në zyrën e burimeve njerëzore dhe shërbimeve të brëndshme në cilësinë e anëtares të komisionit të prokurimit përgjatë vitit 2021 dhe 2022.
- Z.S. S.i me detyrë specialist në sektorin juridik në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit përgjatë vitit 2022.

Për sa më sipër është mbajtur edhe Akt-Konstatimi nr. 7 datë 31.03.2023 pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.

Titulli Gjetjes:	i Parregullsi në respektimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor të procedurave të prokurimit
Situata:	<p>-Përgjatë vitit 2021 titullari i autoritetit kontraktor ka vepruar në kundërshtim me pikën 3 të nenit 56 të VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 <i>“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”</i> ku cilësohet: <i>“Titullari i autoritetit/entit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në fillim të vitit kalendarik, ngre një komision të veçantë, të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh, nga të cilët njëri është kryetar”.</i></p> <p>Në vitin 2021 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është ngritur më anë të urdhërit të brendshëm nr 12 të datës 05.05.2021, duke tejkaluar afatet e paracktuara në VKM-në e sipërcituar.</p> <p>-Përgjatë vitit 2021 dhe 2022 nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve në kundërshtim me pikën 42 të udhëzimit Nr. 30 të datës 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</i> të Ministrit të Financave: <i>“Titullari i njesise miraton urdherin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqerues.”</i></p> <p>- Nga auditimi konstatohet se në 2 raste përgjatë vitit 2021 (më konkretisht në procedurën <i>“Shpenzime për shërbime të tjera operative dhe Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës”</i>) dhe në 4 raste përgjatë vitit 2022 (më konkretisht në procedurat <i>“Shpenzime për shërbime të tjera operative”, “Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit”, “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës”</i> dhe <i>“Furnizime dhe materiale të tjera zyre të përgjithshme”</i>) nga ana e DRT. Durrës është vepruar në kundërshtim me pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr.162/2020 <i>“Për Prokurimin Publik”</i> ku cilësohet: <i>“Përpara se të nisnin një procedurë prokurimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të studiojnë tregun, me qëllim që të përgatisin prokurimin dhe të informojnë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim. Për këtë qëllim, autoriteti ose enti kontraktor mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg”</i></p> <p>Në 6 rastet e evidentuara më sipër, autoriteti kontraktor nuk ka realizuar një studim të tregut dhe nuk ka marrë oferta të ndryshme nga operatorët ekonomikë përpara nisjes së procedurës së prokurimit.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2021 në 2 procedura prokurimi ku më konkretisht, në procedurën: 1) Shërbim <i>“Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës”</i>, 2) Shërbim <i>“Shpenzime mirëmbajtje aparatura teknike dhe vëndit të punës”</i> të fituara nga i njëjti operator ekonomik, objekti i veprimtarisë është i ngjashëm (riparime difekt printerash dhe fotokopjesh) dhe shuma e procedurave të prokuruar është mbi 100,000 lekë, dhe në 2 procedura prokurimi përgjatë vitit 2022 ku më konkretisht, në procedurën: 1) Shërbim <i>“Shpenzime për shërbime të tjera operative”</i> 2) Shërbim <i>“Shpenzime mirëmbajtje aparatura teknike dhe vëndit të punës”</i> të fituara nga i njëjti operator ekonomik, objekti i veprimtarisë është i ngjashëm (riparime difekt printerash dhe fotokopjesh) dhe shuma e</p>

	<p>procedurave e prokuruar është mbi 100,000 lekë duke mos u ndodhur në kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 11 të VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku cilësohet: <i>“Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit”</i>.</p> <p>Përsa më sipër DRT. Durrës ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 të VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe me pikën 1 të udhëzimit numër 5 të datës 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” duke mos zhvilluar procedurën e prokurimit sipas parashikimeve ligjore dhe rrjedhimisht duke mos u zbatuar konkurrenca midis operatorëve ekonomikë.</p> <p><i>“Autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime ,kur vlera e përlllogaritur është ndëremjet kufinjve nga 100,000 deri në 1,000,000 lekë në vit”</i>.</p> <p>-Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2022 në 2 procedura prokurimi ku më konkretisht, në procedurën:1)Shërbim “Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës”,2)Shërbim “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës”,objekti i veprimtarisë është i njëjtë(riparime difekt kondicionerësh) dhe shuma e procedurave e prokuruar është mbi 100,000 lekë,duke mos u ndodhur në kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 11 të VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku cilësohet: <i>“Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit”</i></p> <p>Përsa më sipër DRT. Durrës ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 të VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe me pikën 1 të udhëzimit numër 5 të datës 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” duke mos zhvilluar procedurën e prokurimit sipas parashikimeve ligjore dhe rrjedhimisht duke mos u zbatuar konkurrenca midis operatorëve ekonomikë.</p> <p><i>“Autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime ,kur vlera e përlllogaritur është ndëremjet kufinjve nga 100,000 deri në 1,000,000 lekë në vit”</i>.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Pika 1 e nenit 35; - VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 3 e nenit 56, pika 3 e nenit nr.46,pika 3 e nenit 11,neni 56 e - Udhëzimi nr 5 të datës 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike” Pika 1 dhe pika 2 e

	- Udhëzimi Nr. 30 të datës 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” e Ministrit të Financave, pika 42 të
Ndikimi/Efekti :	Mangësi procedurale që rrezikojnë përdorimin me efektivitet eficient dhe ekonomikitet të fondeve publike
Shkaku:	Mungesa e njohjes së plotë të dispozitave ligjore dhe vëmendje e munguar.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Drejtori Rajonal të marrë masa për ngritjen e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël në fillim të vitit, ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve sipas përcaktimeve ligjore, si dhe për rastet e procedurave të prokurimit në rrugë shkresore të testohet tregu në mënyrë të tillë që të merret treguesi i çmimeve të punëve/mallrave/shërbimeve. Komisioni i prokurimit të marrë masa që për procedurat e prokurimit ku objekti i veprimtarisë është i ngjashëm ose i njëjtë dhe vlera totale e prokurimit është ndërmjet kufijve nga 100,000 deri në 1,000,000 lekë në vit, të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël në mënyrë të tillë që të zbatohet konkurrenca midis operatorëve ekonomikë.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) për vitin 2021, është konstatuar se janë realizuar në masën 2,243,048 mijë lekë, me një mosrealizim prej 64,952 mijë lekë ose 3% më pak se planit i rishikuar.

Ndërsa për vitin 2022, është konstatuar se TVSH është realizuar në masën 2,491,303 mijë lekë, me një mosrealizim prej 168,697 mijë lekë, ose 93 % e planit të rishikuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme të administratës tatimore Durrës, në çështje të planifikimit dhe të realizimit kanë ndikuar negativisht në të ardhurat e buxhetit të shtetit për vitin 2021 dhe 2022.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqet 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtorja e Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhurave, të analizojë faktorët që ndikojnë në realizimin e planit të të ardhurave tatimore, sipas zërave dhe burimeve të disponueshme të tatimpaguesve që ajo administron dhe t’i paraqes ato në mënyrë të dokumentuar në DPT, për marrje në konsideratë nga ana e saj, si dhe të realizohen analiza periodike për ecurinë e realizimit të të ardhurave, në funksion të realizimit të planit të të ardhurave tatimore sipas zërave.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në 7 raste (sipas aneksit nr.5.1) nga ana e DRT Durrës është tejkalluar afati 10 ditor i kthimit të përgjigjes ndaj Qendrës Kombëtare të Biznesit përsa i përket verifikimit të situatës tatimore të tatimpaguesit i cili ka aplikuar për çregjistrim që plotësonte kushtet përkatëse.

Nga auditimi konstatohet se në 208 raste (sipas aneksit nr. 5.2) janë çregjistruar subjektet nga ana e Qendrës Kombëtare të Biznesit të cilat kanë aplikuar për çregjistrim, por rezultojnë ende në proces çregjistrimi nga ana e DRT Durrës pas periudhës së auditimit, me verifikim *post factum* (pas çregjistrimit nga ana e QKB) si pasojë e tejkallimit të afatit 10 ditor të kthimit të përgjigjes ndaj Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Referuar subjekteve që kanë aplikuar për çregjistrim por që rezultojnë ende në proces çregjistrimi nga ana e DRT Durrës, konstatohet se në 48 raste (sipas aneksit nr. 5.3) janë çregjistruar nga ana e Qendrës Kombëtare të Biznesit subjektet të cilat kanë aplikuar për çregjistrim, por që rezultojnë me detyrime dhe nuk plotësonin kushtet për çregjistrim, si pasojë e tejkalimit të afatit të kthimit të përgjigjes ndaj Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Nga auditimi konstatohet se nga 8 subjekte të çregjistruara që i përkisnin përgjegjesisë tatimore Tatim Fitimi (sipas aneksit nr. 5.4) dhe për 7 subjekte (sipas aneksit nr. 5.5) nuk është kryer kontrolli tatimor i thelluar në mjediset e subjektit, si dhe nuk është realizuar analiza e riskut për të vlerësuar nëse është e nevojshme të ushtrohet ky kontroll.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 3.3 të nenit 45 Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar" dhe me pikën 45.3 të Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 të ndryshuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3., faqet 73-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtori rajonal të nxjerrë përgjegjësitë për tejkalimet e afateve kohore të komunikimit midis DRT Durrës dhe QKB-së, si dhe të përcaktojë ditët e punës të kthimit të përgjigjes midis Drejtorive përkatëse. Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të marrë masë që për subjektet që kanë aplikuar për çregjistrim që i përkasin përgjegjesisë tatimore Tatim Fitimi të realizojë analizën e riskut në mënyrë të tillë që të vlerësohet nëse është i nevojshëm një kontroll tatimor i thelluar në mjediset e subjektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: - Në vitin 2021 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është ngritur me anë të urdhrit të brendshëm nr 12 të datës 05.05.2021, duke tejkaluar afatet e paracaktuara në pikën 3 të nenit 56 të VKM-së nr 285 të datës 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.*

- Përgjatë vitit 2021 dhe 2022 nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve në kundërshtim me pikën 42 të Udhëzimit Nr. 30 të Ministrit të Financave të datës 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

- Nga auditimi konstatohet se në 2 raste përgjatë vitit 2021 (më konkretisht në procedurën "*Shpenzime për shërbime të tjera operative dhe Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës*") dhe në 4 raste përgjatë vitit 2022 (më konkretisht në procedurat "*Shpenzime për shërbime të tjera operative*", "*Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit*", "*Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës*" dhe "*Furnizime dhe materiale të tjera zyre të përgjithshme*") nga ana e DRT Durrës nuk është realizuar një studim i tregut dhe nuk janë marrë oferta nga operatorë ekonomik, duke vepruar në kundërshtim me pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*".

Nga auditimi konstatohet se, përgjatë vitit 2021 në 2 procedura prokurimi objekti i veprimtarisë është i ngjashëm (riparime defekt printerash dhe fotokopjesh) dhe në 2 procedura prokurimi përgjatë vitit 2022 objekti i veprimtarisë është i ngjashëm (riparime defekt printerash dhe fotokopjesh) dhe shuma e procedurave e prokuruar në dy rastet është mbi 100,000 lekë duke mos përmbushur kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 11 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021.

- Po ashtu edhe përgjatë vitit 2022 në 2 procedura prokurimi objekti i veprimtarisë është i njëjtë (riparime defekt kondicionerësh) dhe shuma e procedurave e prokuruar është mbi 100,000 lekë, duke mos përmbushur kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 11 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3., faqet 73-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtori Rajonal të marrë masa për ngritjen e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël në fillim të vitit, ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve sipas përcaktimeve ligjore, si dhe për rastet e procedurave të prokurimit në rrugë shkresore të testohet tregu në mënyrë të tillë që të merret treguesi i çmimeve të punëve/mallrave/shërbimeve.

3.2 Rekomandimi: Komisioni i prokurimit të marrë masa që për procedurat e prokurimit ku objekti i veprimtarisë është i ngjashëm ose i njëjtë dhe vlera totale e prokurimit është ndërmjet kufijve nga 100,000 deri në 1,000,000 lekë në vit, të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël në mënyrë të tillë që të zbatohet konkurrenca midis operatorëve ekonomikë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre shoqëritë “T..” SHPK, G..” SHPK dhe “H...M..” SHPK” në periudha të ndryshme kohore kanë kryer transaksione huamarrje dhe huadhënie me ortakun (*kreditime dhe debitime nga llogaria e ortakut*), për llogari të këtyre shoqërive, me qëllim kryesor mbarëvajtjen normale të aktivitetit tregtar të shoqërive, sipas përshkrimeve në raportet e kontrolleve të inspektorëve tatimor. Këto pagesa nuk konfirmohen me saktësi në raportet e kontrollit tatimor, si pagesa të kryera nëpërmjet sistemit bankar dhe të pasqyruara me prova në aktet e mbajtura nga inspektorët e kontrollit. Në lidhje me këto transaksione vlerësohen veprime të cilat janë pa thelb ekonomik dhe në kundërshtim me parimin e vlerës së tregut. Këto veprime në kundërshtim me përcaktimet e germave “b”, “c”, “dh” të nenit 71, gerrat “a”, “b”, “c”, “ç” të nenit 71/2 dhe germa “ç” të neni 72 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar. Për sa më sipër nuk është kryer vlerësim alternativ i situatës financiare të shpenzimeve të interesit të pa llogaritur në PASH, si rikarakterizim të ardhurash, duke sjellë si pasojë detyrime tatimore.

Referuar kuadrit legjislativ tatimor, rezulton se ortaku dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuara janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Sipas legjislacionit tatimor si shoqëria dhe ortaku konsiderohen si “Palë të lidhura”, meqenëse ortaku ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 16, datë 18.6.2014 “Për transferimin e çmimit”, gjë që sjell se çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t’u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut (Arm’s Length). Megjithëse nuk ka të përcaktuar saktë dhe qartë mënyrën e procedimit në legjislacionin tatimor të fushës së llogaritjes së interesave dhe detyrimeve tatimore të rilogaritur në rastet e huadhënies nga llogaria e ortakut drejt llogarisë së shoqërisë ose e anasjelltas, referuar Kodit Civil i miratuar me ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar, nenet 1050-1055, Kreu XIX “Huaja”, cilësohet se huamarrësi duhet t’i paguajë huadhënësit një interes në rastet kur ekziston një marrëveshjeve ndërmjet palëve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqet 25-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: DRT Durrës t’i propozojë Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve hartimin e një akti administrativ për një metodologji të qartë dhe të saktë nënligjore për analizimin e llogarisë së ortakut, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.

B. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHETIT

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i DRT Durrës u konstatua se Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e qarkullimit sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat e TTHF dhe TF për tatimpaguesit, nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra, në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 71, konkretisht:

a) Për subjekte biznes i vogël pa TVSH u konstatuan se për vitin 2021 janë 147 subjekte me qarkullim sipas kasës me vlerë 226,919,895 lekë më tepër se sa të ardhurat e deklaruara në TTHF dhe

b) Për bizneset e vogla me TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TVSH-s, ku u konstatua se për vitin 2021, janë 18 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklaratat në FDP në vlerën 20,496,001 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën **8,198,400 lekë**.

c) Për BM u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës, ku u konstatuan se, për vitin 2021 janë 9 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë se sa deklaratat në FDP në vlerën 88,619,795 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën **62,033,856 lekë**.

Nga sa më sipër, vlerësohen paraprakisht të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit gjithsej në shumën 70,232,256 lekë, nga të cilat 35,116,128 lekë detyrime tatimore dhe 35,116,128 lekë gjobë tatimore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqet 25-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: DRT Durrës, të analizojë situatën e Sektorit të Kontrollit nga Zyra, dhe nëpërmjet saj të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të evidentuara paraprakisht të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën gjithsej prej 70,232,256 lekë, nga të cilat 35,116,128 lekë detyrime tatimore dhe 35,116,128 lekë gjobë tatimore për kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i DRT Durrës u konstatua se Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për bizneset që nuk kanë paguar këstet e Tatim Fitimit sipas afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore.

Janë konstatuar 287 raste në vlerën 69,132,771 lekë, për të cilat duhej të vendosej gjoba TF në masën 10 % të saj në vlerën 6,913,277 lekë (69,132,771 *10 %), sipas kërkesave të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar, neni 114/1.

Nga sa më sipër, konstatohen të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit të vlerësuara gjithsej në shumën 6,913,277 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqet 25-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: DRT Durrës, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, të vendos penalitetet përkatëse, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara

paraprakisht në vlerën prej **6,913,277** lekë gjobë për mos pagimin në afat të kësteve të tatimit mbi fitimin.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i 40 raporteve të kontrollit tatimor, në 11 subjekte nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur procedurat e kontrollit, mbi analizimin e situatës financiare dhe deklarimeve të subjektit, sipas përcaktimeve në *Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr.192 datë 12.08.2020* më konkretisht:

1. Për subjektin “E...” për vitin 2019 rezulton se, sasia në dalje nga magazina e lëndës polietilen prej 243,522 kg nuk rakordon me sasinë e shitur të polietilenit prej 238,523 kg, me një diferencë prej 4,999 kg polietilen të pa deklaruar në shitje me një çmim mesatar shitjeje prej 198.13 lekë/kg. Nga ana e inspektorit të kontrollit, nuk është analizuar dhe trajtuar kjo diferencë, por ka dalë në përfundimin se nga lëvizja materiale e lëndës së parë polietilen nuk ka diferenca materiale. Diferencat e mësipërme në shumën prej 990,452 lekë (4,999 kg * 198.13 lekë/kg), të trajtuara nga grupi i auditimit sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, neni 124, rezultojnë:

*Detyrimi për TVSH-në $990,452 * 20\% = 198,092$ lekë*

Gjobë 100% $198,092 = 198,092$ lekë.

*Detyrimi për Tatim Fitimin $990,452 * 15\% = 148,568$ lekë*

Gjobë 100% $148,568 = 148,568$ lekë.

Për këtë rast, efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit vlerësohet se është në shumën 693,320 lekë.

Nga analiza e kryer nga ana e inspektorit të kontrollit, shitjet e realizuara sipas klientëve dhe llojit të produktit për vitin 2017 rezulton se sasia në dalje nga magazina e lëndës polietilen prej 96,528 kg nuk rakordon me sasinë e shitur të polietilenit prej 99,732 kg, me një diferencë prej 3,204 kg polietilen të deklaruar në shitje, por të pa deklaruar si dalje nga magazina me një çmim mesatar shitjeje prej 188.22 lekë/kg. Nga ana e inspektorit të kontrollit, nuk është analizuar dhe trajtuar kjo diferencë, por është dalë në përfundimin se nga lëvizja materiale e lëndës së parë polietilen nuk ka diferenca materiale.

Diferencat e mësipërme në shumën prej 603,602 lekë (3,204 kg * 188.22 lekë/kg), të trajtuara nga grupi i auditimit sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, neni 124 rezultojnë:

*Detyrimi për TVSH-në $603,602 * 20\% = 120,612$ lekë*

Gjobë 100% $120,612 = 120,612$ lekë.

*Detyrimi për Tatim Fitimin $603,602 * 15\% = 90,540$ lekë*

Gjobë 100% $90,540 = 90,540$ lekë.

Për këtë rast efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 422,304 lekë.

Nga verifikimi i llogarisë shpenzime amortizimi për periudhën 2017 rezulton se subjekti ka amortizuar aktivet materiale nën normën e lejuar për efekte fiskale në kundërshtim ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ” Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 22, pika 3, pika 5.

Për vitin 2017, rezulton se subjekti nuk ka pasqyruar shpenzimet për amortizimin e aktiveve materiale në shumën 1,520,272 lekë, e cila duke u indeksuar me normën e fitimit 1.2% të shoqërisë për periudhën 2017 shkon në vlerën 1,538,515 lekë.

Në zbatim të ligjit 9920 datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, germa “b”, neni 72, germa “a” dhe neni 115, pika 1, janë llogaritur detyrimet përkatëse, të cilat rezultojnë:

Tatim Fitimi	1,538,515 x 15 %	=	230,777 lekë
Gjobe TF.....	230,777 lekë x 0.06% x 365 dite	=	50,540 lekë
TVSH	1,538,515 x 20 %	=	307,703 lekë
Gjobe TVSH	307,703 lekë x 0.06% x 365 dite	=	<u>67,387 lekë</u>
Shuma.....		=	656,407 lekë

Pra, paraprakisht vlerësohen të ardhura të munguara gjithsej 1,772,031 lekë, nga të cilat detyrime tatimore 1,096,292 lekë dhe 675,739 lekë gjobë tatimore.

2. Nga verifikimi i dosjes së kontrollit të subjektit “B...” SHPK rezulton se grupi i auditimit pasi analizoi dokumentacionin e paraqitur sqaron se leja e ndërtimit e paraqitur e lëshuar nga Bashkia Durrës me nr. 575 datë 23.07.2019 është në emër të një individi dhe jo në emër të shoqërisë “B... SHPK”e cila ka kërkuar rimbursimin. Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 20 “Rregulla të përgjithshme”, pikës 4. Referuar bazës ligjore të sipërcituar nga ana e grupit të auditimit gjatë shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se në lejen e ndërtimit të miratuar nga ana e Bashkisë Durrës, është përcaktuar se leja e ndërtimit i referohet zhvilluesit të objektit si person i cili ka aplikuar me kartë identiteti, fakt i cili tregon në mënyrë të qartë se kemi të bëjmë me një individ i cili ka përfituar lejen e ndërtimit dhe jo me një subjekt të tatueshëm. Sqarojmë se individi dhe subjekti i tatueshëm “B... SHPK” janë dy entitete juridikisht të ndryshme, dhe për rrjedhojë me të drejta dhe detyrime tatimore të ndryshme nga njëra tjetra. Në këtë kuptim individi nuk mund të jetë në asnjë moment person i tatueshëm për efekt të TVSH-së dhe ti lind e drejta e rimbursimit të saj. Nga ana e inspektorit nuk është vepruar në përputhje me legjisllacionin tatimor duke mos analizuar në asnjë rast në raportin e kontrollit dhe duke mos cituar lejen e ndërtimit. Gjithashtu nuk është verifikuar që në fazën e parë të kontrollit të dhënat e lejes së ndërtimit dhe ekzistenca e kushtit nëse kemi të bëjmë me një person të tatueshëm ose jo.

Gjithashtu nuk ka një analizë të detajuar të situacioneve pjesore dhe përfundimtare për punimet e ndërtimit, si dhe nuk është verifikuar leja e ndërtimit, preventivi i punimeve për të faktuar kreditimin e TVSH -së së lindur nga blerjet e materialeve me qëllim realizimin e rikonstruksionit të godinës. Si përfundim, për rimbursimin në vlerën 10,748,989 lekë të konfirmuar nga inspektori në raportin e kontrollit, bazuar në informacionet e paraqitura në dosjen e kontrollit, subjektit i lindin detyrime në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 115, pika 3, nga grupi i auditimit janë llogaritur detyrimet përkatëse;

Shuma e kërkuar për rimbursim: 10,748,989 lekë
 Penalitet 20%: 2,149,797 lekë
Total Detyrimi: 12,898,786 lekë

Pra, vlerësohen paraprakisht 10,748,989 lekë detyrime tatimore dhe 2,149,797 lekë gjobë tatimore.

3. Nga auditimi i raportit të kontrollit të subjektit “K...M” SHPK, kosto e blerjes së mallrave është 5,469,650 lekë, ndërkohë vlera e shitjes është 3,664,000 lekë. Në zbatim të ligjit 9920 datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, germa

“b”, neni 72, germa “a” dhe neni 115, pika 1, janë llogaritur detyrimet përkatëse, të cilat rezultojnë si më poshtë:

Kosto 5,469,650 lekë * 10% (vlerë të shtuar) = 6,016,615 lekë

Diferenca 6,016,615 lekë - 3,664,000 lekë = 2,352,615 lekë

Detyrimi për TVSH-në $2,352,615 * 20\% = 470,523$ lekë

Gjobë $470,523 * 0.06\% * 365$ ditë = 103,044 lekë.

Detyrimi për Tatim Fitimin $2,352,615 * 15\% = 352,892$ lekë

Gjobë $148,568 * 0.06\% * 365$ ditë = 77,283 lekë.

Pra, vlerësohen paraprakisht të ardhura të munguara gjithsej 1,003,742 lekë, nga të cilat 823,415 lekë detyrime tatimore dhe 180,327 lekë gjobë tatimore.

4. Nga auditimi rezulton se për subjektin “D...” SHPK Subjekti ka deklaruar shpenzime të cilat duhet të klasifikohen si shpenzime të pazbritshme pasi nuk i shërbejnë aktivitetit dhe rezultojnë shpenzime të panjohura për blerjen e autoveturës bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar”, neni 21.

Detyrimi për Tatim Fitimin $2,750,559 * 15\% = 412,583$ lekë

Gjobë $412,583 * 0.06\% * 365$ ditë = 90,355 lekë.

Konstatohet se në zërin n). shpenzimet për paga shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, nuk janë kaluar nëpërmjet sistemit bankar.

Shpenzime për paga shpërblime për vitin 2020 janë në shumën 2,087,208 lekë.

Shpenzime për paga shpërblime për vitin 2021 janë në shumën 3,247,509 lekë.

Total shpenzime për pagat janë në shumën 5,334,717 lekë.

Detyrimi për Tatim Fitimin $5,334,717 * 15\% = 800,207$ lekë

Gjobë $412,583 * 0.06\% * 365$ ditë = 172,844 lekë.

Pra, vlerësohen paraprakisht 1,475 mijë lekë detyrime tatimore, nga të cilat 1,213 mijë lekë për Tatim Fitimin dhe 264 mijë lekë gjobë tatimore.

5. Nga auditimi i raportit të kontrollit, të subjektit “A...” SHPK konstatohet se në zërin "Konsum për vete" të vitit 2019 janë regjistruar bileta udhëtimi në vlerën 1,107,833 lekë, si dhe janë përfshirë shpenzimet e bëra për udhëtime për qëllime të biznesit, për të hapur treg të ri dhe për takime me furnitorë për furnizime. Në këtë zë është përfshirë edhe udhëtimi për pjesëmarrje në panairin e organizuar nga H.....Gjermani. Furnitori i këtij shërbimi është Shoqëria L.I.

Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, neni 21 dhe sipas përlogaritjeve rezulton:

Detyrimi për Tatim Fitimin $784,065 * 15\% = 117,609$ lekë

Gjobë $117,609 * 0.06\% * 365$ ditë = 25,756 lekë.

Pra, vlerësohen paraprakisht gjithsej 143,365 lekë detyrime tatimore, nga të cilët 117,609 lekë detyrime tatimore për Tatim Fitimin dhe 25,756 lekë gjobë tatimore.

6. Nga auditimi i praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik) të subjektit “V..T.” SHPK konstatohet se:

- Nuk janë analizuar normativat e harxhimit të karburantit sipas km të përshkruara dhe normativave për 100/km ato analizohen me kontrollin për tatimin mbi fitimin.

Nuk është kryer analiza e harxhimit të karburantit dhe bilanci material për naftën e përdorur për të gjithë periudhën e kontrollit sipas km të përshkruara dhe normativave për 100/km sipas kartës

teknologjike të mjeteve të kompanisë, harxhimi i karburantit në raport të rrugëve të kryera nga ana e subjektit për periudhën e kontrolluar.

Subjekti ka kryer blerje të cilat nuk i shërbejnë aktivitetit për të cilat nuk duhet të kreditohet TVSH në vlerën 435,545 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar”, neni 21, pasi ky mjet nuk i shërben aktivitetit direkt por është për përdorim vetjak për nevojat e përfaqësuesit ligjor të subjektit dhe si i tillë nuk duhet kredituar TVSH-ja.

Për veprimet e mësipërme në bazë të ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008, neni 115, për këtë diferencë që për vitin 2021 është 2,173,723 lekë penalitetet si më poshtë:

TVSH : 435,545 lekë

Gjobë TVSH (20%): 87,109 lekë

Total Detyrimi për 2021: 522,654 lekë

Pra, vlerësohen paraprakisht 522,654 lekë detyrime tatimore, nga të cilat 435,545 lekë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe 87,109 lekë gjobë tatimore.

7. Nga auditimi i praktikës/dokumentacionit zyrtar (fizik) të subjektit “G...” SHPK, konstatohet se nga kontrolli mbi tatim fitimin për vitin 2021, shpenzimet për qira janë deklaruar 280,000 lekë nga 770,000 lekë që është vlera e kontratës.

Për këtë diferencë për vitin 2021 prej 490,000 lekë llogariten penalitetet si më poshtë:

TF 15%: 73,500 lekë

Gjobë TF (21.9%): 15,876 lekë

Total Detyrimi për 2021: 89,376 lekë

Për vitin 2019 Kreditorë të tjerë në vlerën 3,400,000 lekë përfshijnë vlerën e kontributit të ortakut me vendim asambleje për likuiditetet në arkë, për pagesa dhe shpenzime rritjen e fondit të kompanisë.

Për vitin 2020 kreditorë të tjerë janë në vlerë 5,550,000 lekë, ku nuk janë analizuar dhe nuk është përgatitur informacioni *RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë)* në lidhje me shumatat të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “, neni 5, pika 1 dhe 2.

Pra, vlerësohen paraprakisht gjithsej 89,376 lekë detyrime, nga të cilët 73,500 lekë detyrime tatimore për Tatim Fitimin dhe 15,876 lekë gjobë tatimore.

8. Nga auditimi të subjektit ”A...” SHPK, për vitin 2020 në zërin blerje nga furnitorë vendas për investime është njohur si shpenzim për blerje e një autoveture Toyota në vlerën e tatueshme 4,341,800 lekë dhe TVSH në vlerën 868,360 lekë, e cila nuk i shërben aktivitetit të subjektit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 21, pasi ky mjet nuk i shërben aktivitetit direkt, por është për përdorim vetjak për nevojat e përfaqësuesit ligjor të subjektit dhe si i tillë nuk duhet kredituar TVSH-ja.

Për veprimet e mësipërme në bazë të ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008, neni 115, për vitin 2020: për 4,341,800 lekë penalitetet si më poshtë:

TF 15%: 651,270 lekë

Gjobë TF (21.9%): 142,628 lekë

TVSH : 868,360 lekë

Gjobë TVSH (20%): 190,170 lekë

Total Detyrimi për 2020: 1,852,428 lekë

Pra, vlerësohen paraprakisht gjithsej 1,852,428 lekë detyrime, nga të cilët 1,519,630 lekë detyrime tatimore dhe 332,798 lekë gjobë tatimore.

9. Nga verifikimi i dosjes së kontrollit të subjektit "T...." SHPK, rezulton se subjekti operon në fushën e përpunimit të materialeve plastike në formë primare, ku kryen importe të lëndës së parë nga jashtë (e tipit lëndë e parë plastike PE dhe lëndë e parë plastike PVC). Nga të dhënat e paraqitura në RPK të mbajtur nga Inspektori i Kontrollit citohet se për prodhimin e gatshëm përdoret lënda e parë e marrë nga magazina e cila futet në proces si dhe shoqëria ka hartuar skedën teknologjike sipas të cilës humbjet teknologjike llogariten 7%, por kartelat teknologjike janë të pa depozituara në organet tatimore, për rrjedhojë nisur nga fakti që mungojnë kartat teknologjike humbjet e deklaruar nga subjekti janë të pa dokumentuara.

Në faqen nr. 13 të RPK, është analizuar nga ana e Inspektorit bilanci material i shoqërisë për vitin 2020, 2021 dhe periudhën janar- mars 2022, për lëndët e para PE/kg, PVC/kg, Karbonat/kg, ngjyrues dhe stabilizant. Nga verifikimi i bilancit material për vitin 2021 rezulton se për lëndën e parë PE/kg gjendja në fund të inventarit paraqitet në vlerën 50,326,323 lekë me kosto/njësi 84 lekë/kg dhe sasi 602,278 kg.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për vitin 2021 edhe pse sasia e gjendjes së lëndës së parë PE është dyfishuar në raport me vitin 2020 ka një ulje drastike të koston për njësi prej 84 lekë/kg, për rrjedhojë ka një situatë të nënvlerësimit të gjendjes kontabël të inventarëve të shoqërisë e cila analizohet duke ju referuar për analogji edhe vitit 2020.

Në gjendjen në fund të paraqitur në vitin 2020 kosto për njësi e lëndës së parë PE është 109 lekë/kg e cila vjen si rezultat i metodës FIFO, ku regjistrohet kosto për njësi sipas hyrjes së vitit në këtë rast në vlerën 109 lekë/kg.

Nga analiza e kryer nga ana e Grupit të Auditimit për vitin 2021, në RPK nuk është analizuar nga ana e inspektorit gjendja në fund e lëndës së parë PE, si dhe regjistrimi i koston për njësi që është bërë nga ana e shoqërisë. Për rrjedhojë nuk është përdorur pesha specifike midis sasive dhe kosto/njësi në çelje të vitit si dhe kosto/njësi e hyrjeve të vitit, duke kryer regjistrimin e saktë kontabël të kosto/njësi në fund të vitit, si më poshtë:

Pesha specifike sasi/kosto për njësi për hyrjet e vitit: sasi hyrje 2,160,215 kg / (sasi çelje 398,524 kg + sasi hyrje 2,160,215 kg) = 0.844 %;

Pesha specifike sasi/ kosto për njësi për çeljet e vitit: $1 - 0.844 = 0.155$;

Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për hyrjet e vitit: $0.844\% * 158 \text{ lekë/kg} = 133.3915 \text{ lekë/kg}$;

Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për çeljet e vitit: $0.156\% * 109 \text{ lekë/kg} = 16.97677 \text{ lekë/kg}$;

Shuma e të dyjave do të duhej të ishte regjistrimi i kosto/njësi në fund të vitit ushtrimor: $(133.39 \text{ lekë/kg} + 16.98 \text{ lekë/kg}) = 150.37 \text{ lekë/kg}$.

Për sa më sipër nga ana e subjektit, si dhe në RPK kosto/njësi në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 84 lekë/kg e pa analizuar dhe e pa argumentuar, për rrjedhojë kemi ka një diferencë të kosto/njësi në vlerën $(150.37 \text{ lekë/kg} - 84 \text{ lekë/kg}) = 66.3 \text{ lekë/kg}$

Nga analiza e kryer më sipër rezulton një nënvlerësim të inventarit kontabël në fund të vitit 2021 për lëndën e parë plastike PE me diferencë në çmim prej 66.3 lekë/kg, detyrimet si më poshtë:

*Sipas RPK, gjendja në 31.12.2021 për lëndë e parë PE/kg Sasi 602,278 kg * 84 lekë/kg = 50,326,323 lekë, vlera kontabël*

Sipas Grupit të Auditimit, sasi 602,278 kg * 150.37 lekë/kg = 90,563,484 lekë, vlera kontabël e korrektuar

Nga diferenca e konstatuar si pasojë e nënvlerësimit të inventarëve të shoqërisë është kryer nga Grupi i Auditimit rikarakterizimi i situatës, bazuar në Ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”, germa (b), si dhe bazuar në nenin 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit” është kryer rivlerësimi sipas të cilit janë përlllogaritur detyrimet dhe gjobat e mësipërme në zbatim të nenit 115 “*Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore*”.

Diferenca si pasojë e nënvlerësimit të inventarit rezulton në shumën (90,563,484 lekë – 50,326,323 lekë) = 40,237,161 lekë

Për këtë diferencë për vitin 2021 prej 40,237,161 lekë edhe penalitetet si më poshtë:

TF 15%:	6,035,574 lekë
Gjobë TF (21.9%):	1,321,791 lekë
TVSH 20%:	8,047,432 lekë
Gjobë TVSH (21.9%):	1,762,388 lekë

Total Detyrimi për 2021: 17,167,185 lekë

Pra, vlerësohen paraprakisht 17,167,185 lekë gjithsej detyrime nga të cilët 14,083,006 lekë detyrime tatimore dhe 3,084,179 lekë gjobë tatimore.

10. Nga verifikimi i dosjes së kontrollit të subjektit “A.....” SHPK, rezulton se artikulli “*Transformator tensioni*” me vlerë kontabël prej 14,152,754 lekë përbën peshën kryesore të inventarit kontabël të shoqërisë konkretisht në masën 71%. Për rrjedhojë u krye një analizë e thelluar e bilancit material në lidhje me kartelën inventarit “*Transformator tensioni*”.

Nga auditimi rezulton se për këtë artikull është kryer dalje gjatë vitit ushtrimor 2016 nga ana e shoqërisë për 196 copë me çmim 154,935 lekë dhe vlerë kontabël 30,367,276 lekë. Çmimi i aplikuar në dalje paraqitur në bilancin material është dukshëm më i ulët se kosto/njësi paraqitur të hyrjet e vitit prej 167,380 lekë si dhe kosto/njësi paraqitur të çeljet e vitit prej 156,823 lekë.

Nga ana e inspektorit në RPK nuk është kryer një analizë e thelluar dhe e qartë mbi aplikimin e shoqërisë të çmimit për daljet e vitit të paraqitur në bilancin material të shoqërisë, ku rezulton më i ulët për artikullin kryesor të inventarit kontabël. Për rrjedhojë nga ana e inspektorit duhej të ishte kryer një test analitik mbi çmimet e aplikuara nga shoqëria nëse janë paraqitur saktë dhe të mos jenë nën kosto.

Nga ana e Grupit të Auditimit është përdorur metoda FIFO, për të përlllogaritur çmimin që duhej të aplikohet nga subjekti për artikullin “*Transformator tensioni*”, konkretisht si më poshtë:

Diferenca në çmim: Kosto/njësi hyrjet e vitit 167,380 lekë – çmim dalje në Bilanc Material 154,935 lekë = 12,445 lekë;

Marzhi i fitimit për vitin 2016: 23%;

Çmimi i rivlerësuar: (12,445 lekë * 23%) = 15,307 lekë;

Diferenca në vlerë: (196 copë * 15,307 lekë/copë) = 3,000,241 lekë.

Inspektori i kontrollit nuk ka bërë rivlerësimin e të ardhurave në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71.

Për diferencën e konstatuar për vitin 2016 prej 3,000,241 lekë penalitetet si më poshtë:

TF 15%:	450,036 lekë
Gjobë TF (0.06%/365):	98,558 lekë
TVSH 20%:	600,048 lekë
Gjobë TVSH (0.06%/365):	131,411 lekë

Total Detyrimi për 2016: 1,280,053 lekë

Në RPK të mbajtur nga ana e Inspektorit është hartuar bilanci material i vitit ushtrimor 2017, ku janë cilësuar artikujt e shoqërisë, gjendje në fillim, hyrjet e vitit, daljet e vitit si dhe gjendja në fund të periudhës me sasi, kosto/njësi dhe vlerat kontabël.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se artikulli “*Transformator tensioni*” me vlerë kontabël prej 11,309,207 lekë përbën peshën kryesore të inventarit kontabël të shoqërisë konkretisht në masën 40%. Për rrjedhojë u krye një analizë e thelluar e bilancit material në lidhje me kartelën inventarit “*Transformator tensioni*”.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për vitin 2017 rezulton se kosto/njësi prej 124,277 lekë është dukshëm më e ulët se kosto/njësi në çelje prej 196,566 lekë si dhe kosto/njësi në hyrjet e vitit prej 142/752 lekë, për rrjedhojë kemi ka një situatë të nënvlerësimit të gjendjes kontabël të inventarëve të shoqërisë.

Nga analiza e kryer nga ana e Grupit të Auditimit për vitin 2017, në RPK nuk është analizuar nga ana e inspektorit gjendja në fund e artikullit “*Transformator tensioni*” si dhe regjistrimi i koston për njësi që është bërë nga ana e shoqërisë. Për rrjedhojë nuk është përdorur pesha specifike midis sasive dhe kosto/njësi në çelje të vitit si dhe kosto/njësi e hyrjeve të vitit, duke kryer regjistrimin e saktë kontabël të kosto/njësi në fund të vitit, konkretisht si më poshtë:

Pesha specifike sasi/kosto për njësi për hyrjet e vitit: $\text{sasi hyrje } 302 / (\text{sasi çelje } 72 + \text{sasi hyrje } 302) = 0.81\%$;

Pesha specifike sasi/ kosto për njësi për çeljet e vitit: $1 - 0.81 = 0.19 \%$;

Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për hyrjet e vitit: $0.81 * 142,752 \text{ lekë/copë} = 115,270 \text{ lekë/copë}$;

Çmimi i ponderuar bazuar në peshën specifike për çeljet e vitit: $0.19 * 196,566 \text{ lekë/copë} = 37,842 \text{ lekë/copë}$;

Shuma e të dyjave do të duhej të ishte regjistrimi i kosto/njësi në fund të vitit ushtrimor: $(115,270 \text{ lekë/copë} + 37,842 \text{ lekë/copë}) = 153,112 \text{ lekë/copë}$.

Për sa më sipër nga ana e subjektit si dhe në RPK kosto/njësi në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën 124,277 lekë/copë e pa analizuar dhe e pa argumentuar, për rrjedhojë kemi një diferencë të kosto/njësi në vlerën $(153,112 \text{ lekë/copë} - 124,277 \text{ lekë/copë}) = 28,835 \text{ lekë/copë}$.

Nga analiza e kryer më sipër rezulton se ka një nënvlerësim të inventarit kontabël në fund të vitit 2017 për artikullin “*Transformator tensioni*” me diferencë në çmim prej 28,835 lekë/copë, ku edhe detyrimet si më poshtë:

Sipas RPK, gjendja në 31.12.2017 për artikullin Transformator Tension Sasi 91 copë * 124,277 lekë/copë = 11,309,207 lekë, vlera kontabël.

Sipas Grupit të Auditimit Sasi 91 copë * 28,835 lekë/copë = 2,623,978 lekë, vlera kontabël e korrektuar.

Nga diferenca e konstatuar si pasojë e nënvlerësimit të inventarëve të shoqërisë është kryer nga Grupi i Auditimit rikarakterizimi i situatës, bazuar në Ligjin 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, germa (b) si dhe bazuar në nenin 72 është kryer rivlerësimi sipas të cilit janë përlllogaritur detyrimet dhe gjobat e mëposhtme në zbatim të nenit 115 pika 1.

Diferenca si pasojë e nënvlerësimit të inventarit rezulton në shumën $(90,563,484 \text{ lekë} - 50,326,323 \text{ lekë}) = 2,623,978 \text{ lekë}$.

Për diferencën e konstatuar për vitin 2017 në shumën prej 2,623,978 lekë penalitetet si më poshtë:

TF 15%: 393,597 lekë

Gjobë TF (21.9%): 86,198 lekë
TVSH 20%: 524,796 lekë
Gjobë TVSH (21.9%): 114,930 lekë

Total Detyrimi për 2017: 1,119,521 lekë

Pra, vlerësohen paraprakisht gjithsej 2,399,574 lekë, nga të cilët 1,968,477 lekë detyrime tatimore dhe 431,097 lekë gjobë tatimore.

11. Nga verifikimi i dosjes së kontrollit të Personit fizik “M.K” operon në fushën e Hotelerisë dhe Strukturave të ngjashme, ku ka kërkuar rimbursimin e TVSH-së për periudhën 05/2019 – 12/2020 në vlerën 14,059,317 lekë. Nga ana e Grupit të Auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts në lidhje me personin fizik “M.K” ku ka rezultuar se: 1. Leje ndërtimi me nr. 1233, datë 19.06.2019 për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, nga ana e Bashkisë Kavajë, i është dhënë kjo leje ndërtimi për zhvilluesin M.K me **NID/F...H**, të cilit i lejohet ndërtimi i objektit për ndryshim projekti gjatë ndërtimit në objektin Hotel 5 kate + papafingo + bodrum sipas kushteve:

Sipërfaqe e parcelës e zënë nga parkimi: 249.8 m²

Sipërfaqe totale e ndërtimit: 2317.7 m²

Afati i lejes është i vlefshëm për një periudhë 25 mujore nga data e fillimit të punimeve referuar grafikut të punimeve.

2. Leje ndërtimi me nr. 1978, datë 12.10.2020 për objektin pishinë në funksion të hotelit, nga ana e Bashkisë Kavajë, i është dhënë kjo leje ndërtimi për zhvilluesin M.K me **NID/F...H**, të cilit i lejohet ndërtimi i pishinë në funksion të hotelit sipas kushteve:

Sipërfaqe e truallit: 500 m²

Sipërfaqe e ndërtimit gjurma: 250 m²

Afati i lejes është i vlefshëm për një periudhë 12 mujore nga data e fillimit të punimeve referuar grafikut të punimeve.

Nga të dhënat e cituara më sipër rezulton se nga lejet e ndërtimit të dhëna nga Bashkia Kavajë janë miratuar punimet për zhvilluesin M.K si individ me NID, dhe jo si person fizik me NIPT, për rrjedhojë zhvilluesit M.K nuk i lind e drejta e kreditimit të TVSH-së për shkak se nuk jemi në kushtet e një personi të tatueshëm. Nga lejet e ndërtimit të miratuara nga ana e Bashkisë Kavajë për të qenë në kushtet e një personi të tatueshëm duhej të ishin në favor të zhvilluesit të paraqitur me NIPT dhe i regjistruar në organet tatimore.

Në RPK, e mbajtur nga Inspektori nuk janë analizuar lejet e ndërtimit si dhe të ishin verifikuar zhvilluesi i miratuar në këto leje ndërtimi nëse është person i tatueshëm dhe më pas të procedohej me kërkesën për rimbursim të paraqitur nga zhvilluesi M.K.

Kreditimi i TVSH i saktësuar nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është në përputhje me Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 20 “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes”, pika 3 “Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim”, ku citohet se: *-pika 4.*

Për rrjedhojë e gjithë shuma e kërkuar prej 14,059,317 lekë për rimbursim nuk duhej proceduar nga Inspektori në RPK, subjektit i lindin detyrime në zbatim të pikës 3, të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë llogaritur detyrimet përkatëse.

Shuma e kërkuar për rimbursim: 14,059,317 lekë

TVSH 20%: 2,811,863 lekë

Total Detyrimi: 16,871,180 lekë

Pra, vlerësohen paraprakisht 14,059 mijë lekë detyrime tatimore dhe 2,812 mijë lekë gjobë tatimore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2., faqet 25-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, referuar dosjeve përkatëse të kontrollit, për të cilat janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën gjithsej prej 56,196,310 lekë, nga të cilët detyrime tatimore 46,138,570 lekë dhe 10,057,740 lekë gjobë tatimore për plotësim të pasaktë të deklaratës tatimore.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2023

D. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa “b”, “c” dhe “ç”; në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandojmë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në cilësinë e organit epror, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

I. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil”, për 18 punonjës, si më poshtë:

1. Znj. D.T, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës,

- Për mangësitë e evidentuara në kontrollin e tatimor në vend, referuar Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192 datë 12.08.2020, neni 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”, pikat 3, 10, 11 dhe, 18.

2. Z. D.XH, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në Vend, si dhe Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit Tatimor, (sipas rasteve përkatëse),

- për mos kryerjen në mënyrën e duhur të vlerësimit të cilësisë së raporteve të kontrollit tatimor në vend, referuar Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192 datë 12.08.2020, neni 57 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor”, pika 2, 7, neni 58 “Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të sektorit të kontrollit në vend”, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7 dhe 8.

3. Z. D.D, me detyrë Inspektor i Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 115, pika 3, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të

ardhurat” i ndryshuar, neni 21, për 2 raste të konstatuar me efekte negative në të ardhurat tatimore në vlerën prej 10,866 mijë lekë detyrime tatimore dhe 2,176 mijë lekë gjobë tatimore për plotësim të pasaktë të deklaratës tatimore.

4. Z. Sh.P, me detyrë Inspektor i Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, neni 72, neni 115, për 2 raste të konstatuar me efekte negative në të ardhurat tatimore në vlerën prej 15,179 mijë lekë detyrime tatimore dhe 3,760 mijë lekë gjobë tatimore për plotësim të pasaktë të deklaratës tatimore.

5. Z. K.R, me detyrë inspektor i Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, neni 72, neni 115, për 1 rast të konstatuar me efekte negative në të ardhurat tatimore në vlerën prej 1,968 mijë lekë detyrime tatimore dhe 431 mijë lekë gjobë tatimore për plotësim të pasaktë të deklaratës tatimore.

6. Z. E.SH, me detyrë Inspektor i Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 115, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, neni 21, për 1 rast të konstatuar me efekte negative në të ardhurat tatimore në vlerën prej 1,520 mijë lekë detyrime tatimore dhe 333 mijë lekë gjobë tatimore për plotësim të pasaktë të deklaratës tatimore.

7. Znj. Sh.K, me detyrë inspektor i Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71, neni 72, për 1 rast të konstatuar me efekte negative në të ardhurat tatimore në vlerën prej 823 mijë lekë detyrime tatimore dhe 180 mijë lekë gjobë tatimore për plotësim të pasaktë të deklaratës tatimore.

8. Z. A.D, me detyrë inspektor i Kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor,

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor, të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, pika 1 e nenit 59 si dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 115, pika 3, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, neni 21, për 2 raste të konstatuar me efekte negative në të ardhurat

tatimore në vlerën prej 15,272 mijë lekë detyrime tatimore dhe 3,075 mijë lekë gjobë tatimore për plotësim të pasaktë të deklaratës tatimore.

9. Z. A.M , në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit,

- *Për moszbatim të detyrave funksionale në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr.192, datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave, të nenit 60, me efekte negative në të ardhurat tatimore në vlerën prej 35,116 mijë lekë detyrime tatimore dhe 42,029 mijë lekë gjobë tatimore për mos pagim të këstit të Tatim Fitimit në afat si dhe diferenca sipas kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TF.*

10. Z. A.C , në cilësinë e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit,

